



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 15 DHE 19 MARS 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. I 19. MARTA 2013. GODINE**

**MARS - MART
2013**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike për muajin janar 2013, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,
2. Debat parlamentar për rastin “Kiçina”, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Lladrovci, i mbështetur nga deputetët nënshkrues.

Dnevni red

1. Parlamentarna debata u vezi fakturisanja potrošnje električne energije za januar mesec 2013, prema zahtevu Parlamentarne grupe Demokratskog saveza Kosova,
2. Parlamentarna debata o slučaju “Kičina”, prema zahtevu poslanika Ramiz Lladrovci, podržanog od poslanika potpisnika.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit Qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, fjalën e ka kërkuar Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!
Unë e kam fjalën për rend të ditës. Do t'i kisha lutur të gjitha grupet parlamentare që pika e dytë të kalojë në pikën e parë të rendit të ditës, sepse është një iniciativë e nënshkruar nga 85 deputetë nënshkrues dhe kisha pasur dëshirë që të kem mirëkuptim nga të gjithë deputetët që ta votojnë ndërrimin e rendit të ditës. Pra, pika e dytë e rendit të ditës të kalojë në pikën e parë të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Na duhet prononcimi i shefave të grupeve parlamentare. Mirë, po fillojmë me grupin e PDK-së, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah kërkesën e zoti Lladrovci, që të bëhet ky ndryshim në radhitjen e pikave të rendit të ditës.

KRYETARI: Veç unë jam i obliguar të ju them që kur e kemi bërë rendin e ditës, jemi pajtuar të gjithë. Po, megjithatë, tani e kemi mocionin. Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!
Ne kërkojmë që rendi i ditës, i propozuar nga Kryesia, të jetë ky që është dhe të procedojmë sipas pikave të rendit të ditës. Dhe, nuk e përkrahim një mocion të tillë, që u paraqit tani.

KRYETARI: Radha është e Grupit Parlamentar të "Vetëvendosjes". Visar Ymeri, e do fjalën?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!
Ne mendojmë, natyrisht, që të dy këto debate janë shumë të rëndësishme, por nëse ka pajtim prej deputetëve, nuk kemi asgjë kundër që të ndryshohet renditja e tyre, mirëpo me kusht që të dyja të mbahen sot.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Konsiderojmë se të dy pikat janë të rëndësishme. Por, megjithatë, kërkesa e bërë shumë më herët për pikën e dytë do të ishte mirë që të kalojë në pikën e parë, për shkak se edhe do të ishte konsumuar koha më herët për këtë pikë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se edhe ju vetë e theksuat që në mbledhjen e Kryesisë janë vendosur siç janë vendosur këto pika të rendit të ditës, atëherë mbetet përgjegjësi e deputetëve sesi duan të procedojnë.

KRYETARI: Në emër të SLS-së, Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Mi podržavamo predlog našeg kolege iz PDK-a da druga tačka bude prva tačka dnevnog reda.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6”, Shinik e ka fjalën.

SHINIK: Sayın Başkan,

Başkanlık Kurulunda aldığımız bir karar var, ancak 6+ Parlamenter grubu olarak Ramiz Lladrovi'nin teklifini kabul ediyoruz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Mirë. Atëherë, e hedhim në votim kërkesën e deputetit Ramiz Lladrovci për ndërrimin e pikave të rendit të ditës.

Të pranishëm janë 90 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 58 vota për, 27 kundër, 1 abstenim, pikë e parë e rendit të ditës kalon debati parlamentar për rastin “Kiçina”, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Lladrovci, i mbështetur nga deputetët nënshkrues.

Deputeti Ramiz Lladrovci, i mbështetur nga deputetët nënshkrues, në bazë të nenit 15, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, e ka parashtruar kërkesën për debat parlamentar lidhur me rastin “Kiçina”.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, më 11 mars 2013, ka vendosur që këtë pikë ta radhisë në mbledhjen e sotme.

E ftoj deputetin Ramiz Lladrovci që në cilësinë e propozuesit ta marrë fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se puna e Gjyqësorit është e ndarë nga puna e Ligjvënësist.

Ne në nismën e sotme nuk synojmë në asnjë mënyrë që të ndërhyjmë në punët e drejtësisë, por është e drejtë jona e patjetërsueshme që ta japim kontributin dhe angazhimin tonë real për t'i verifikuar shkeljet që mund të jenë bërë në kuadër të këtij procesi.

Ekzistojnë dyshime të bazuara se vendimi i çështjes “Kiçina” paraqet shkelje të rënda procedurale dhe shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut për një gjykim të drejtë dhe të pavarur, sepse kemi dyshime bazë se vendimet janë marrë me anë të shkeljeve procedurale.

Organet hetuese kanë përdorur presion mbi dëshmitarët. Organet hetuese kanë përdorur mashtrime dhe premtime në këmbim të dhënies së deklaratave në favor të akuzës. Organet hetuese, as gjykatat, nuk i vlerësuan dëshmitë, që u shkojnë në favor të akuzuarve.

Gjykata nuk i pranoi alibitë e ankuesve, e as të dëshmitarëve akuzues. Gjykata nuk dha arsyetim se pse nuk u besoi dëshmitarëve për alibinë e të gjykuarve dhe të dëshmitarit akuzues. Ndaj të akuzuarve nuk është ushtruar një gjykim i drejtë në lidhje me akuzat për vepra penale, në përputhje me nenet 6.1 të KEDNJ, neni 5, pika 2, pika 3; dhe pika 1, pika 2 dhe pika 3, i KPPK-së; neni 1, 14.1 i PNDCP-së. Nuk është respektuar parimi i prezumimit të pafajësisë, siç garantohet nga neni 6.2 i KEDNJ-së; neni 14.2 tërësia e parimeve, parimi 36, si dhe neni 3, paragrafi 1 dhe 2 i KPPK-së.

Neni 31 i Kushtetutës së Kosovës thotë: “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, thotë: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë, si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij, të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.

Në rastin “Kiçina” dyshohet se është bërë gjykim jo i drejtë dhe i paanshëm, për shkak se vendimi është mbështetur në prova të papranueshme dhe është prezumuar apo harxhuar pafajësia. Është thuhet një parim universal, se një pohim është provë në një rast, nëse është marrë në mënyrë të vullnetshme dhe me respektimin e plotë të të drejtave të të dyshuarit.

Por, në këtë rast nuk është dashur të përdoret parimi universal kundër atij që e ka bërë atë nëpërmjet dhunës, presionit, premtimeve, kërcënimit apo mashtrimit.

Është evident ushtrimi i presionit ndaj dëshmitarëve. “Të gjithë të akuzuarit, të dyshuarit Arsim dhe Burim Ramadani, Arben e Jeton Kiçina, bazohen kryesisht në deklaratën e

dhënë të Blerim Kiçinës më 4 korrik 2002, në stacionin numër një të Policisë, gjithashtu incizuar me video, dhe më 7 korrik 2002, para gjyqtarit hetues”. Burim Kiçina e ka tërhequr rrëfimin e tij në seancën dëgjimore më 11 tetor 2002, para gjyqtarit hetues. Hetimet e mëtejshme, seancat e shumta dëgjimore të dëshmitarëve, shikimi i vendit të ngjarjes dhe seancat dëgjimore të të dyshuarve, as nuk janë në kundërshtim me rrëfimin e Blerim Kiçinës, as nuk e provojnë në thelb rrëfimin.

Lidhur me rrëfimin e Blerim Kiçinës, ne kemi dyshime të bazuara se ishte shpikur nga oficerët e Shërbimit Policor të Kosovës, zoti Fadil Syleviq dhe zonjës Myrvete Pafqeli, të cilët i vunë në lajthitje edhe hetuesit ndërkombëtarë, duke i bindur ata se i kishin zbuluar autorët e vrasjes. Për këtë fabrikim të dhunshëm të deklaratës së Blerim Kiçinës, tregon vetë ai, kur në seancat gjyqësore ua kujton dëshmitarëve se në këtë rast ishin policët hetues ndërkombëtarë, kushtet nën të cilat i ishte marrë deklarata, duke aluduar në presionin e bërë nga zoti Fadil Syleviq: “Lërmani mua, se tash unë e bëj haxhi Blerimin!”. Ndoshta motivi i sjelljes brutale të zotit Fadil Syleviq ishte se ai ishte koleg i viktimës Hamzë Hajra në policinë e Serbisë. Ky fakt do të duhej të shërbente që ai të mos ishte pjesë e ekipit të hetimeve.

Por, të nderuar deputetë, aludimi i Blerim Kiçinës ma rrit dyshimin bazë se ky oficer policie, derisa po punonte për policinë serbe, më 14 prill 1998, e arrestoi humanistin e madh, doktor Hafir Shalën, derisa po udhëtonte së bashku me Shaban Nezirajn dhe Hetem Sinanin. I njëjti deshi ta bëjë “hoxhë” edhe doktor Hafir Shalën, para pesëmbëdhjetë vjetësh, kur e mbajti nën arrest, por s’arriti, sepse e mbyti në torturë, e më pas e zhdukuri trupin e tij.

I njëjti e ndërroi emrin e tij në librin e protokollit të pranimit në Stacionin e Policisë, nga siç duhej të ishte - Hafir Isuf Shala, në Hafize Isuf Shala, dhe më kot e kërkuan organizata të shumta internacionale për të drejtat dhe liritë e njeriut, sepse ata e gjenin vetëm emrin e Hafizes, e jo të Hafirit.

Ai më pas i liroi bashkudhëtarët e doktorit Hafir Shala, Shaban Neziraj dhe Hetem Sinani, duke i kërcënuar, se po e hapën gojën do t’u gjejë i njëjti fat si doktorin. Këta dy dëshmitarë, që për çdo ditë po mplaken duke pritur, që edhe pas 15 vjetësh t’i thërrasë drejtësia ndërkombëtare, që ta dëshmojnë këtë fakt para saj dhe ta zbardhin rastin, duke besuar se do ta gjejnë edhe trupin e mikut të tyre bashkudhëtar.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të drejtësisë ndërkombëtare,

Zoti Fadil Syleviq e përdori këtë gjykim edhe për t’i mbuluar me alibinë e krimit të tij të 14 prillit 1998, kur deklaroi në seancën e gjyqit se ishte në familjen e Skënder Halilajt.

Blerim Kiçina, më 4 korrik 2002, është marrë në pyetje në një lokacion të izoluar prej 9 metrash katror, në kulmin e vapës, nga 6 policë njëkohësisht, si dhe përkthyesit, duke iu ekspozuar, përveç presionit të policëve, edhe tymosjes së duhanit nga shumica e tyre, si dhe pa praninë e avokatit mbrojtës dhe pa qenë i njoftuar për të drejtat e tij. Ata thanë se

ia kanë kujtuar të drejtat e tij, por nuk ekziston një procesverbal i shkruar, siç e kërkon ligji.

Pra, deklarata e tij u mor nën ndikimin e kushteve ekstreme, johumane dhe të një presioni konstant. Pra, mbi këtë bazë paraqitet dëshmia e dyshimit, ose më saktë mungesa e provës, “in dubio pro reo”. Dhe, mbi këtë bazë të dyshimit, Prokuroria ngriti akuzën kundër Skënder Halilajt, Burim e Arsim Ramadanit; Arben, Florim e Jeton Kiçinës dhe të tjerëve.

Bazuar në nenet 157, paragraf 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, deklaratat e të bashkakuzuarit nuk mund të shërbejnë si provë për ta vërtetuar fajin e të akuzuarit. Provë e papranueshme e nenit 152, paragrafi 1 dhe neni 155, paragrafi 1, pika 3 të KPPK-së në lidhje me intervistën e Blerim Kiçinës, më 4 korrik 2002, pa praninë e avokatit mbrojtës, si dhe më 7 korrik 2002, para gjyqtarit hetues. Shkeljet e të së drejtës elementare themelore të njeriut nga neni 5.1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, humbja e provave në lokalet e organit hetues në Policinë e UNMIK-ut, e cila do t'i nixirte të pafajshëm Burim e Arsim Ramadanin, Arben e Jeton Kiçinën paraqet shkelje të procedurës penale.

Procesverbali i 7 korrikut 2002 i Blerim Kiçinës paraqet shkelje për një proces të drejtë bazuar në nenet 6 dhe nenet 2 dhe 4 të Protokollit të 7 të KEDNJ-së, neni 14 pika 1 të Konventës dhe Kushtet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia vazhdo fjalën!

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Aktgjykimi ishte në kundërshtim me nenet 364, pika 8 të LPPRFJ-së, sepse e mbështeti atë në provat e papranueshme, neni 153, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 i KPPK-së.

Deklarata e 7 korrikut është e papranueshme për shkak të mosrespektimit të së drejtës së kontradititetit, e cila është e drejtë e garantuar e çdo të akuzuari. Mosrespektimi i çdonjërit nga këto elemente e bën provën juridikisht të pavlefshme.

Në aktgjykimin AP-393/2006 të datës 21 maj dhe 26 qershor të vitit 2008, Gjykata Supreme, shkalla e dytë, aktgjykimi ankimor është ndryshuar, kur Skënder Halilaj si shtytës kryesor i veprës penale dhe miku i zotit Syleviq, sipas këtij të fundit, si në akuzë, u lirua i pafajshëm. Të pafajshëm u liruan edhe Florim Kiçina, Zeqir Kiçina, Agim Gjulani, Bekim Morina, Adem Kiçina dhe Muharrem Xhemaili.

Shkalla e dytë eliminoi mbi 98% të deklaratës së Blerimit, me ç'rast u liruan 7 të akuzuar të tjerë, pikërisht mbi bazë të kësaj deklarate, përfshirë edhe të akuzuarin e parë si shtytës, Skënder Halilaj, kinse i kishte paguar Burim e Arsim Ramadanin dhe Adem Kiçinën, mbi të cilën u mbështet i gjithë motivi i kësaj akuze.

Janë evidente në këto raste gjyqësore se mungojnë provat e vendit të ngjarjes, se në vendin e ngjarjes nuk doli prokurori, e as gjyqtari hetues. Ato prova të mbledhura, në të cilat duhej të jepej saktësisht koha e fillimit dhe mbarimit të këqyrjes së veprës, sendet dhe gjurmët e marra, procesverbali, ku duhej të nënshkruhej nga pjesëtarët e grupit hetimor, ose nga i pandehuri, dëshmitari që ka parë ose zbuluar ngjarjen, apo i dyshuari, mungojnë.

Nuk u ekzaminua telefoni i viktimës së zotit Hajra, edhe pse u kërkua nga avokatët. Nuk u ekzaminua arma e viktimës zotit Hajra, edhe pse u kërkua nga avokatët. Nuk u ekzaminuan dy gëzhojat, që polici hetues ndërkombëtar i gjeti në veturën e viktimës, pothuajse dy muaj më pas. Nuk u ekzaminua arma automatike A-47, të cilën ia dha një polic i SHPK-së një polici ndërkombëtar, që iu konfiskua më vonë.

Mungon sqarimi nga ekspertët për obduksionin e viktimave, në të cilin saktësisht do të përcaktohej lartësia e gjuajtjeve dhe pozicioni i gjuajtësve, me të cilët do të verifikoheshin përputhshmëria e deklaratave të të akuzuarve, e sidomos të bashkakuzuarit Blerim Kiçina.

Gjykata nuk ka dhënë asnjë sqarim se nga obduksioni sa plumba janë gjetur në trupat e viktimave.

Gjykata nuk pranoi t'i ekzaminojë videokasetat, që ta verifikojë deklaratën e Blerim Kiçinës, pasi ai deklaroi se policët e mësuan se çka të deklaronte dhe dyshohet se ata e kishin prerë xhirimin për ndonjë sqarim. Ata e kishin përgatitur një deklaratë në A-4, e cila shihej në tavolinë.

Gjykata nuk pranoi t'i verifikonte thirrjet telefonike të viktimës, edhe pas kërkesës së mbrojtjes. Gjurmët e gishtërinjve në makinën e viktimës ishin marrë dhe ato u zhdukën. ADN-në e siguruar menjëherë pas krimit, Policia e kishte marrë 'strisho' nga Arben e Florim Kiçina, më pas gjithashtu kishte marrë 'strishot' edhe nga shenjat e gishtërinjve të Arsim e Burim Ramadanit, dhe ato u humbën.

Në vendin e ngjarjes u gjetën 26 gëzhoja të kalibrit 7,62x39mm dhe u supozua se ato janë qëlluar prej 2 armëve të ndryshme. Armët e krimit mungojnë. Ndërsa u dënuan se kishin shtënë që të tre: Burimi, Arsimi e Arbeni. Sipas asaj deklarate të Blerim Kiçinës, ata kishin zbratur nga dy karikatorë dhe në ndihmë u kishte ardhur Blerimi vetë, duke ua gjuajtur edhe karikatorët tjerë, si dhe duke ua mbajtur kinse armët.

Por, këtë deklaratë ai e kishte tërhequr para konfirmimit të aktakuzës dhe kishte treguar për presionet fizike dhe psikike, madje edhe për mashtrimin që ata do ta dërgonin në Angli, bashkë me familjen.

Blerim Kiçina ka qenë për shumë kohë i sëmurë në spitalin e Burgut të Dubravës, por edhe dosja e tij ka humbur. Presioni ndaj dëshmitarëve u vërejt edhe ndaj të tjerëve dhe ata që nuk iu bindën për një fabrikim të një akuze të trilluar, u akuzuan për bashkëpunim dhe ndihmë dhënë vrasësve, për t'u liruar në shkallën e dytë.

Të njëjtat presione u përdorën edhe ndaj disa personave, që nuk deshën të thoshin gënjeshtër të përgatitura nga polici i SHPK-së, zoti Fadil Syleviq, zonja Myrvete Pafqeli, e më vonë edhe nga polici Sami Hasani. Jeton Kiçina erdhi nga Suedia vullnetarisht dhe u arrestua në sallën e gjyqit, vetëm se do të dëshmonte të kundërtën e Blerim Kiçinës. Agim Gjulani: “Policia gjatë 72 orëve më tha se do të shkosh në Angli, apo kudo që dëshiron, në rast se dëshmon kundër Burim Ramadanit”. Pasi nuk pranoi të dëshmojë, atë e akuzuan dhe e shpallën fajtor, ndërsa polici tjetër, Adem Kiçina, pasi e dha deklaratën dhe dëshmoi se Burim e Arsim Ramadani; Arben Kiçina e të tjerë, ishin në çajtores duke pirë birra, kur ai e kishte marrë lajmin se në Baicë ka ndodhur një incident. Edhe Adem Kiçina, pasi nuk pranoi ta ndryshonte deklaratën, u akuzua dhe u dënua gjithashtu me grupin e policëve me nga 4 vjet burg, kinse u ndihmoi atyre për t’u liruar i pafajshëm nga shkalla e dytë, si dhe dy policë tjerë.

Edhe Muharrem Xhemaili iu nënshtrua këtij presioni dhe pasi nuk pranoi ta thoshte një deklaram të rremë, u akuzua për dhënie të ndihmës për kryerje të vrasjes dhe u shpall fajtor, duke u dënua edhe ky me 4 vjet burgim, për t’u liruar në shkallën e dytë.

Sami Hasani, polic, në deklaratën e parë e tha të vërtetën, se të gjithë ata ishin në Glogoc, në çajtores, kur ata e morën lajmin. Ndërsa, pas presionit të policisë pranoi ta ndryshojë deklaratën dhe e shpëtoi vëllanë e tij, Fetah Hasani, nga arrestimi i sigurt, pasi ai ishte pjesë e grupit të ditëlindjes dhe me këtë rast ata e graduan. Fetah Hasani dhe Sami Hasani, më 27 gusht 2001 ishin dëshmitarë, ndërsa më 10 dhe 11 korrik, Sami Hasani, polic, të pandehur.

Në këtë veprim dhe me angazhimin tonë si deputetë mund të japim një kontribut më shumë për një drejtësi të plotë nga një gjykim, që në thelbin e tij është i trajtuar keq dhe me shkelje të mëdha procedurale dhe të të drejtave e lirive të njeriut.

Të nderuar deputetë,

Nisur nga shkaqet dhe arsyet e lartpërmendura, kërkoj që t’i qasemi me seriozitet më të madh trajtimit të këtij rasti, duke e formuar një komision ad hoc, i cili do ta kishte mandatin që t’i shqyrtojë rrethanat e reja të paraqitura për këtë rast dhe dyshimet e bazuara për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, andaj sot, në këtë rast, politika nuk po ndërhyr në Gjyqësor, apo në drejtësi, por institucioni ligjvënës po kujdeset që ta depolitizojë drejtësinë kosovare, së paku në një rast, siç është rasti “Kiçina”.

Dhe, krejt në fund, në emër të 85 deputetëve nënshkrues, ju ftoj të debatojmë dhe ta sjellim një përfundim të përbashkët, duke e formuar komisionin ad hoc, i përbërë nga të gjithë përfaqësuesit e partive politike në Kuvend dhe nga institucionet tjera të hetuesisë dhe të Gjyqësorit në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Askush s’e do fjalën në emër të grupit. Mirë, po e lini Ramizin. Në emër të Lidhjes Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,
Çështja që po e diskutojmë sot është një çështje shumë delikate dhe vullneti për ta trajtuar me urgjencë nga pjesa më e madhe e deputetëve po bën për t'u çuditur kur të njëjtit nuk kanë dëshirë të flasin për këtë çështje.

Mendoj se si Grup Parlamentar ne duhet të besojmë në disa parime themelore, parimin e ndarjes së pushtetit dhe institucioneve, ku në këtë rast institucionet politike, siç është Kuvendi, nuk mund të ndërhyjë në institucionet e pavarura, siç është sistemi i drejtësisë dhe i gjykatave, megjithëse dje ndërhyri në Bankën Qendrore të Kosovës, e para.

Dhe, e dyta, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike beson fuqishëm në prezumimin e pafajësisë, kur çdokush konsiderohet i pafajshëm, përderisa me vendim të formës së prerë të gjykatës vërtetohet e kundërta.

Dhe, në këtë rast, ne po ashtu besojmë se në qoftë se dikush është dënuar në mënyrë të padrejtë, patjetër se sistemi i drejtësisë duhet të merret me ta, por jo Kuvendi. Kuvendi nuk ka kapacitete dhe mundësi që t'i gjykojë vendimet e gjykatave, vendimet e gjykatave të formës së prerë. Mendoj se është ndërtuar precedenti dhe po shihet rruga institucionale se si duhet të ndiqet kjo rrugë dhe si Grup Parlamentar ne nuk mendoj se duhet ta përkrahim një iniciativë të tillë, sepse kjo iniciativë është ndërhyrje direkte në pavarësinë e Gjyqësorit.

Në qoftë se do të hapet një rrugë dhe të krijohet një precedent i ndërhyrjes në pavarësinë e Gjyqësorit, kjo do të jetë shumë e rrezikshme për të ardhmen.

Ne mund t'i shprehim shqetësimet tona në raste të veçanta konkrete, të cilat janë dhe kanë marrë forma të prera si vendime nëpër sistemin e drejtësisë, mirëpo ne nuk mund t'i gjykojmë. Ne nuk mund të gjykojmë, nuk i dimë faktet, nuk i dimë rrethanat. Ne kemi vullnet që t'i konsiderojmë të gjithë të pafajshëm, mirëpo gjykata e ka vërtetuar se i ka dënuar këta njerëz. Mund të janë të pafajshëm, unë nuk po i gjykoj si fajtorë, mirëpo sistemi i drejtësisë duhet t'i shpallë të pafajshëm. Nuk mund ne. Ne nuk mund të bëjmë kurrgjë, nuk kemi hapësirë ligjore dhe kushtetuese që të ndërhyjmë në sistemin e gjykatave.

Prandaj, si Grup Parlamentar ne nuk mund ta përkrahim një iniciativë të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", deputetja Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Rasti "Kiçina" tashmë është i njohur për të gjithë ne si rasti më flagrant i shkeljes së të drejtave të njeriut, ligjeve dhe procedurave ligjore, rast ky që me një vendim të padrejtë ka sjellë pasoja të dëmshme për personat që po vuajnë padrejtësisht. Si të tillë, e kemi parë me parregullsitë që e kanë shoqëruar këtë proces të stërzgatur.

Gjithçka në këtë rast ka filluar me deklaratën e rrejshme të të miturit Blerim Kiçinës, më 4 korrik 2002. Ai është incizuar dhe deklarata e tij është shpallur e vlefshme dhe ka rezultuar me arrestimin e 12 personave, duke i akuzuar për vrasjen e familjes Hajra, e cila kishte ndodhur në mesnatën e datës 20 gusht 2001.

Por, më pas, kjo deklaratë është shpallur si e pavlefshme nga Paneli i Kolegjit Ndërkombëtar, duke e shpallur Blerim Kiçinën, nga dëshmitar i Prokurorisë, në të akuzuar për deklaratë të rrejshme, të cilin e dënuan më pas me 10 vjet burgim, edhe pse Kodi Penal i Kosovës e parasheh dënimin për deklaratë të rrejshme jo më shumë se 5 vjet, po njëkohësisht incizimi po vazhdonte të përdorej për të burgosurit e tjerë si dëshmi, edhe pse ishte shpallur i pavlefshëm, duke lënë anash deklaratat e 55 dëshmitarëve, të cilët e vërtetonin pafajësinë e të akuzuarve dhe e përgënjeshtroan Blerim Kiçinën, duke aplikuar kështu standarde dhe duke i përdorur provat sipas nevojës.

Nga 11 të akuzuarit për këtë rast, 5 nga ta u liruan në shkallën e parë si të pafajshëm, 3 të tjerë u liruan në shkallën e dytë si të pafajshëm, më 12 korrik të vitit 2008, duke përfshirë këtu edhe të akuzuarin kryesor, Skender Halilaj, edhe pse asnjëherë nuk iu përmend asnjë kompensim material ligjor si palë e dëmtuar, që kishin vuajtur padrejtësisht burgimin.

Ndërsa me një vendim të shkallës së tretë nga Gjykata Supreme, të datës 20 maj 2008, me nga 30 vjet u dënuan Burim dhe Arsim Ramadani e Arben Kiçina.

Shkeljet e mëtutjeshme që e kanë përcjellë këtë rast janë të mëdha, shkelje këto esenciale të dispozitave të procedurës penale. Këto shkelje janë, si vijon:

- të akuzuarit nuk janë njoftuar asnjëherë me shkrim për arrestimin, edhe kur ka pasur kohë për një gjë të tillë;

- masa e paraburgimit, e cila ka qenë më e gjatë se 3 vjet dhe vazhdimi i saj çdo dy muaj deri në 7 vjet paraburgim është shkelje e të drejtave të njeriut, e cila masë më së shumti mund të zgjasë 6 muaj dhe atë me vendim nga Gjykata Supreme, në raste të çështjeve të ndërlikuara;

- mospërfillja e afateve dhe seancave në gjithsej 109 seanca;

Sipas dispozitave ligjore, neni 6, par. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vazhdimi i paraburgimit dhe vonimi i fillimit të procesit gjyqësor 9 muaj pas përfundimit të fazës së hetimeve konsiderohet si shkelje drastike e të drejtave të njeriut, e me këtë edhe të akuzuarve.

Në bazë të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane, “çdo proces i rregullt gjyqësor duhet të fillojë dhe të përfundojë pa zvarritje brenda një afati të arsyeshëm kohor”, dhe Kodit të Procedurës Penale, neni 5, paragrafi 2, “gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo shpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë”. Pra, vonesat që kanë ndodhur në këtë rast janë të papranueshme dhe jashtë çdo dispozite ligjore.

Po ashtu, nuk janë përfillur afatet për dorëzimin e aktgjykimit të UNMIK-ut, i nxjerrë në prill 2005, që do të duhej të bëhej 15 ditë deri 45 ditë pas vendimit, ndërsa kjo ka ndodhur më 7 prill të vitit 2006, pra që vjen një vit më pas.

Mosrespektimi i dorëzimit të transkriptit të aktgjykimit sipas normave juridike prej 15 deri 30 ditë, është shkelje e procedurave ligjore.

d) mosadministrimi i provave materiale fizike, humbja e të gjitha provave që janë gjetur në vendin e krimit, kënaçet e pijeve, gëzhhojat, parafina e gishtërinjve, ADN-ja etj., duke përfshirë këtu po ashtu edhe kartelën shëndetësore të Blerim Kiçinës.

Si u shpallën ata të fajshëm, nëse kanë humbur provat, kur sipas Konventës Evropiane dihet që “çdo i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht” dhe në bazë të neni 8 të KPPK, paragrafi 2, “gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtimin gjyqësor”, e që me këtë rast është shkelur edhe neni 153, paragrafi 2, ku thuhet: “Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme”, dhe neni 46, paragrafi 3, ku thuhet: “Gjykata ka të drejtë ta vlerësojë me ndërgjegje secilën pjesë të provave materiale individualisht dhe në lidhje me provat tjera materiale, dhe në bazë të këtij vlerësimi t’i japë formë një konkluzioni nëse faktet janë vërtetuar”. Si u bë që humbën provat materiale, të cilat kanë qenë në mbrojtje dhe kujdes të hetuesisë ndërkombëtare? Kjo nuk është rastësi. Madje, kjo është shkelje e rëndë në vete.

Humbjen e provave, Gjykata dhe Prokuroria do të duhej ta inicionin si çështje. Kjo është vepër penale dhe e dënueshme sipas Kodit të Procedurës penale, neni 305, paragrafi 1, 2 dhe 3, ku parashihet “burgim prej 10 vjetësh për personat që shmangin zbulimin e veprës penale nëpërmjet fshehjes së mjeteve, provave a në çfarëdo mënyre tjetër që ndikon në zbardhjen e rastit”.

Dhe, si bëhet që një aktgjykim i nxjerrë nga Kolegji i Veçantë Penal, i udhëhequr nga gjyqtari italian Emilo Gatt, të jetë i bazuar në supozime, pa fakte dhe prova, të mos ketë ekzistimin e motivit, të jetë paragjykses dhe i pabazuar në ligj, i njëanshëm dhe kontradiktor.

Tek sa kjo Qeveri vazhdon ta lavdërojë demokracinë që po lulëzon në Kosovë, ky rast e dëshmon të kundërtën dhe duket qartë se drejtësia këtu është shumë e rrezikuar.

Nëse drejtësia ka kritere, atëherë vendimet le të jenë të drejta dhe në emër të drejtësisë të gjykohen ata që vërtet e kanë kryer krimin dhe të mos vazhdojmë të jemi servilë të ndërkombëtarëve, por të veprojmë në mbrojtjen e të drejtave më elementare të qytetarëve tanë.

Pra, sundimi i dobët i ligjit do të thotë qasje jo e duhur në drejtësi dhe pa një pavarësi absolute të pushtetit të drejtësisë nga bota e politikës, e cila e ngadalëson apo shpejton në vendimmarrjen e tij, nuk mund të ketë shtet ligjor dhe drejtësi të vërtetë, sepse një vendim i ndikuar është në vetvete një premisë padrejtësie për nesër. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht ne nuk po ndërhyjmë në drejtësi, por jemi shumë të interesuar që t'i mbrojmë të drejtat e njeriut.

Sot e kemi para vetes një rast unikat në përvojën e re demokratike të Kosovës. Thirrja e këtij debati nuk mund të konsiderohet as për së afërmi ndërhyrje në drejtësi, por përkundrazi tendenca e këtij debati është ta ndihmojmë drejtësinë.

Në rastin në fjalë shihet qartë se ka devijim dhe ndëshkim të pabazuar mbi disa djem, të cilët në të gjitha etapat ishin në fronte të para dhe mbështetës të të gjitha përpjekjeve drejt lirisë.

Ajo që ka ndodhur në rastin “Hajra” gjithsesi që është e dënueshme, por jo që në emër të drejtësisë të viktimizohen njerëz të pafajshëm, duke i zhdukur provat e vërteta dhe duke krijuar prova artificiale, duke krijuar dëshmitarë të mitur dhe të joshur nga premtimet, të intervistuar madje edhe pa praninë e prindit, gjë që është gjithashtu e kundërligjshme. E kjo nuk ndodhi vetëm nga UNMIK-u, kjo u krye edhe me ndihmën e disa individëve që thirreshin në emër të ligjit, duke abuzuar me ligjin dhe duke shkaktuar vuajtje të pafund të djemve më të mirë të Drenicës.

Sot ky Kuvend, me të drejtë e ka hapur një debat rreth këtij rasti, duke i mbrojtur të drejtat e njeriut, të cilat janë shkelur tash e sa vite dhe në të shumtën e rasteve duke viktimizuar djemtë më të mirë.

E përsëris, kjo në asnjë mënyrë nuk është ndërhyrje në drejtësi, por përkundrazi do të jetë një mbështetje shumë e madhe për vendosjen e drejtësisë në vend. Kjo praktikë nuk guxon të bie ndesh me ligjet në Kosovë, por nga ajo që u pa deri më tani, sidomos nga gatishmëria e shumë deputetëve këtu, dëshmon qartë që interesimi për t'i parë në hollësi detajet në rastin “Kiçina” është shumë i madh.

Shpresoj që komisionin ad hoc, që do të formohet në këtë seancë, do ta mirëpres edhe ministri i Drejtësisë, i cili nuk është në sallë, por i cili është gjithashtu shumë mirë i informuar me rastin.

Krejt në fund, shpresoj që ky komision do të jetë shpresa e fundit dhe përpjekja vendimtare për ta zbardhur të vërtetën e plotë në rastin “Kiçina”. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë me radhë, si janë paraqitur deputetët. Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar ministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë debat parlamentar angazhohem pjesë për sensibilizmin e të gjithë faktorëve vendimmarrës për çështje të tilla, si rasti në fjalë, pra rasti “Kiçina” .

Në radhë të parë, duhet të dimë se mos kemi të bëjmë me shkelje të të drejtave të njeriut, duke iu referuar konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Pa pretenduar në ndërhyrje në punët e drejtësisë, por duke parë nga retrospektiva, jo gjithherë drejtësia na ka bindur se ka vepruar në formë profesionale të pavarur, pa paragjykim, aq më keq nuk ka arritur as në opinion kredibilitetin e kërkuar të një institucioni të besuar, ashtu siç kërkohet edhe me ligjet në fuqi.

Sistemi i drejtësisë në të gjitha rastet është konsideruar si i korruptuar dhe jo gjithherë në funksion të drejtësisë. Është krijuar ideja se ka pasur edhe drejtësi selektive, duke shfaqur edhe tendenca të bërjes së numrave. Në anën tjetër, ka pasur një hezitim shumë të madh dhe të papranuar në vënien e drejtësisë në vend për shumë krime të rënda që kanë ndodhur gjatë luftës kundër popullit shqiptar.

Na duhet një ndërgjegjësim i madh si shoqëri, në radhë të parë institucionet e vendit, me theks të veçantë ato të drejtësisë se institucione të tilla duhet të jenë të besuara, të pavarura dhe profesionale, si parakusht për një të ardhme të ndritur për vendin tonë në fushën e sundimit të rendit e ligjit.

Duke qenë bashkëqytetar i të burgosurve të rastit “Kiçina”, solidarizohem dhe i mbështes fuqishëm të gjithë ata që janë kërkues të drejtësisë së vërtetë. Është krijuar një perceptim i opinionit, duke e parë këtë proces nga jashtë me ato seancat maratonike me kontradikta të mëdha të atij procesi, me mënyrën si janë trajtuar të akuzuarit, me deklaratimet e vazhduara në të gjitha mediet tona se janë dënuar pa pasur fakte, bile është thënë se ato edhe janë zhdukur qëllimshëm.

E kanë bërë gjithë këtë proces një rast me shumë paqartësi dhe do të ishte mirë të dihej më shumë për ligjshmërinë dhe transparencën e vetë rastit, gjithherë brenda kornizave të sistemit të drejtësisë.

Në atë kohë, vendi ka qenë në një tranzicion të thellë, kur sistemi i drejtësisë ka qenë shumë larg asaj të dëshiruarës, prandaj mendoj se do t’i bënte nder vetë drejtësisë së vërtetë që bazohet në prova dhe fakte që ky rast të rishikohet përsëri.

Në vitet e para pas luftës, gjykatësit dhe prokurorët mendoj se e kanë pasur vështirë ta njihnin si duhet realitetin në një vend që sa po kishte dalë nga lufta, ku përgjegjësia ka qenë në shkallë shumë të ulët dhe janë marrë shumë hapa të rëndë me shumë hipoteza e paragjykim në Kosovën e pasluftës.

Konceptet e ndryshme të punës me sisteme të ndryshme dhe të pakoordinuara mirë ka shkaktuar çrregullim total në atë kohë në sistemin e drejtësisë në vendin tonë.

Nga vitet e kaluara, jemi dëshmitarë të disa rasteve, kur drejtësia ka dështuar në misionin e saj të vërtetë, kur janë burgosur shumë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, janë mbajtur kohë të gjatë nëpër burgje, më pas janë liruar si të pafajshëm, pa u shqetësuar kush për lirinë e humbur të tyre me vite të tëra.

Të njëjtin fat e kishin edhe disa të tjerë, të cilët ishin burgosur pikërisht për rastin “Kiçina”. Ata janë mbajtur në burg me vite, e më pas janë liruar dhe askush nuk ka dhënë asnjë llogari për ta.

Rasti në fjalë është bërë barrë për të burgosurit, për familjarët e tyre, edhe për qytetarët, edhe për ne si institucione, se a po shkelen të drejtat e liritë e njeriut dhe a ka drejtësi të vërtetë këtu.

Nga këtu u bëj thirrje organeve të hetuesisë dhe të Prokurorisë që të merren me rastin, ta rishikojnë atë me qëllimin e vetëm që të triumfojë drejtësia e vërtetë, çka do të na siguronte një të ardhme më të ngritur si vend. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Nuk ka burg në Kosovë që nuk ka luftëtarë të UÇK-së për çështje të motivuara politikisht në procese të ndryshme të padrejta të periudhës së luftës apo të pasluftës.

Pas çarmatosjes kolektive të UÇK-së, në vitin 1999, nisin akuzat, fajësimet dhe dënimet individuale për shumë luftëtarë.

Qëllimi dhe vlera e UÇK-së ishin në shpërputhje me karakterin dhe objektivat e administrimit ndërkombëtar, andaj këtë kontrast e paguan më së shumti ish-ushtarët që u mbajtën për vite të tëra padrejtësisht në burg.

Këtu duhet theksuar dy çështje, e para që prej vitit 1999, ajo që ishte krim për popullin shqiptar dhe UÇK-në, në veçanti, nuk ishte njësoj krim për administrimin ndërkombëtar dhe gjykatat e UNMIK-ut, dhe anasjelltas. Ajo që ishte krim për ata, nuk ishte krim për ne.

Pra, ekziston kjo shpërputhje politike fundamentale ndërmjet vullnetit të popullit, i cili u sublimua me luftën e UÇK-së, në njërën anë, dhe administrimit ndërkombëtar, i cili përpiqej vetëm për një stabilitet afatshkurtër politik, në anën tjetër.

Me pretekstin e krimeve, të cilat nuk i kishin kryer, shumë luftëtarë u mbajtën në burg më shumë për atë që do të mund të bënin, pra për avancimin e çështjes kombëtare drejt lirisë, pavarësisë, sovranitetit të Kosovës. Pra, përshtypja ime dhe prej përvojës sime kur kam qenë në burg në vitin 2007, 5 muaj në disa burgje dhe 5 muaj në arrest shtëpiak, dhe prej takimeve të shumta që i kam pasur edhe me luftëtarët e UÇK-së në ato burgje, është se në fakt ata nuk mbaheshin shumë për atë që kishin bërë, sa për atë që mund të bënin. Gjithë ata të cilët nuk u disiplinuan politikisht, të gjithë ata të cilët nuk ia mbanin ison regjimit

ekzistues, konsideroheshin të rrezikshëm dhe me pretekstin e disa krimeve nga e kaluara, që në fakt nuk i kishin bërë, mbaheshin të izoluar.

Kësisoj, burgimi i shumë luftëtarëve të UÇK-së, më parë se sa dënim, paraqet izolim.

Në Kosovën e pasluftës, besoj të gjithë pajtohemi, nuk kemi pasur as gjyqësi të pavarur dhe as gjyqësi të paanshme. Ne mund të flasim tash në një rrafsh formalist se si janë tri shtylla të pushtetit të ndara, e kështu me radhë, por as në aspektin nominal, e as në atë praktik, kjo nuk ekziston. Një herë UNMIK- dhe tash EULEX-i kanë fuqi ekzekutive mbi Gjyqësorin. Baza e EULEX-it, të gjithë e dimë, është dokumenti i veprimit të përbashkët, i datës 4 shkurt të vitit 2008, i cili publikohet në gazetën zyrtare, më 16 shkurt 2008. Pra, vetëm një ditë para se të shpallet pavarësia. Dhe, është shumë e vlefshme të theksohet pika 3h e këtij dokumenti, që nuk ia kufizon fuqitë EULEX-it as në sferat dhe as në kohën e atyre fuqive. Pra, ata kanë të drejtë për çdo çështje, çdo herë, ta marrin atë çështje në duart e tyre, në mënyrë arbitrare, ndërkohë që kanë edhe imunitet prej ligjit në Kosovë, por po ashtu e kanë edhe mbështetjen e plotë të protektoratit politik ndërkombëtar në Kosovë, i cili mund të jetë transformuar, por assesi nuk është eliminuar pas shpalljes së pavarësisë.

Prej gjithë asaj çfarë kam lexuar, dëgjuar, qoftë privatisht, qoftë publikisht, nëpër media të informimit, në dokumentet që janë publikuar për rastin “Kiçina”, mendoj se të gjithë jemi dakord se bëhet fjalë për së pari shkeljen parimore që është bërë ndaj tyre si luftëtarë të UÇK-së, të cilët, në vend që pas luftës çlirimtare thjesht të integrohen në shoqërinë tonë, me të gjitha meritat që u takojnë, ata kanë filluar ta paguajnë dënimin e rëndë për krimin e pakryer.

Dhe, në gazetën “Vetëvendosje”, të datës 28 janar 2008, është një shkrim i Shqiptar Osekut, me titull “Kush do t’i mbikëqyrë mbikëqyrësit?”, të cilin ua sugjeroj që ta lexoni të gjithë, sepse qysh atëherë janë dhënë hollësitë, edhe të shkeljeve të drejtësisë, në përgjithësi, edhe ato procedurale në veçanti, gjatë këtij procesi.

Nëse ne themi që tash nuk do të ndërhyjmë në sistemin gjyqësor, në sistemin e drejtësisë, sepse ai do të jetë i pavarur, duhet ta kemi parasysh që mosndërhyrja jonë do të jetë mosndërhyrje në ndërhyrjen që tashmë është kryer. Pra, nuk mund të mos ndërhysh në sistemin gjyqësor, sepse ai na qenka i pavarur, duke qenë se nuk është, aty mund ta privosh veten nga ndërhyrja në ndërhyrjen që tashmë ka ndodhur.

Dhe, për derisa ndërhyrja që ka ndodhur është materiale, kjo e ashtuquajtur ndërhyrja jonë si legjislativ është veçse deklarative.

Gjithsesi, sulmi mbi familjen Hajra ka qenë krim, dhe ai është dënuar nga të gjithë dhe duhet të dënohen kryerësit e atij krimi, duhet të akuzohen dhe gjykohen, porse vështirë është ta gjesh dikë në Kosovë që beson se ky krim është krim i Kiçinëve.

Shpresoj se komisioni, i cili do të formohet, do t'i bëjë studimet dhe analizat e nevojshme për t'i ndihmuar drejtësisë së vërtetë, sepse e kam bindjen e fuqishme që ky proces i padrejtë në fakt ka nevojë për një proces. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Sot po e trajtojmë një temë që mendoj se është thelbësore për funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe unë më shumë do të merrem me fenomenin drejtësi, sesa me rastin, sepse ky është njëri nga rastet dhe nëse i pyetni qytetarët e Kosovës, nëse i pyetni edhe deputetët se a funksionon drejtësia në Kosovë dhe a ka drejtësi në Kosovë, unë jam i bindur se do të thonë 'jo'. Dhe do të thonë 'jo' për arsye se shumë nga rastet të cilat janë trajtuar që nga paslufta kanë treguar se kanë qenë të motivuara politikisht, kanë qenë të përgatitura me tendencë dhe janë dëmtuar njerëzit, të cilët kanë familje, kanë dinjitet, e kanë një shoqëri në të cilën kanë kontribuar dhe në fund, edhe kur janë liruar të pafajshëm, asnjë satisfaksion për ta nuk ka pasur.

Po e them këtë për arsye se nuk mund ta kuptoj kur flitet për një temë kaq të rëndësishme, për një rast që është i veçantë, e ministri i Drejtësisë nuk është këtu i pranishëm që t'i dëgjojë deputetët se çfarë pikëpamje kanë rreth rastit në fjalë.

Njëra nga çështjet themelore që dua ta theksoj është se kushdo që vjen në Kosovë, çfarëdo misioni, në vend se të angazhohet për momentin kur vendoset dhe e ka për obligim ta kryejë detyrën e vet, gjen lëndë të gatshme nga sirtarët, të mbyllura më herët, të konsumuara, të shpenzuara, të trajtuara dhe të mbyllura dhe përsëri fillon me të njëjtat për ta arsyetuar funksionimin e vet.

Deri kur në Kosovë më do t'i përdorim njerëzit për eksperiment, do t'i përdorim duke i trajtuar jo si njerëz, jo si qenie të cilat kanë nevojë për dinjitet, por përkundrazi ta bëjmë drejtësinë të tillë që të mos ketë më besim kurrkush kur thirret para prokurorit ose gjykatësit, ose nivelit të drejtësisë.

Vërtet është për të të ardhur keq, sepse dimë raste konkrete, të cilat kanë ndodhur në Kosovë. Nga dy-tri herë njerëzit janë shpallur të pafajshëm dhe përsëri dikush merret me ta. Cila gjykatë është më superiore se tjetra? Lirohet, ta marrim shembull, Fatmir Limaj nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë, nga një gjykatë shumë kredibile, për të njëjtin rast përsëri kur kthehet në Kosovë, në vend se ta gëzojë lirinë e vet me familjen e vet për atë çka ka merituar, merret e trajtohet për të njëjtën temë, me të njëjtit dëshmitarë, me të njëjtat përralla dhe në njëfarë mënyre po e degradojmë krejt atë që kemi synuar ta arrijmë.

E përmenda vetëm si një rast. Rasti i dytë është Afrim Zeqiri, ta marrim shembull. Merret njeri, futet në burg, mbahet për kohë të gjatë, maltretohet. Të gjitha i bëhen me një

gjendje ekonomike të vështirë dhe pas krejt peripecive shpallet i pafajshëm. Tash gjoja po ia bëj një dëmshpërblim.

I përmenda vetëm këto dy raste për të treguar se shumica e rasteve kanë ndodhur kështu dhe përfundimisht ne do të pajtohemi, jo që të ndërhyjmë në drejtësi, po ta kuptojnë të gjithë ata që e kanë marrë rolin e zbatimit të ligjit të dinë ta zbatojnë atë dhe të japin përgjegjësi për zbatimin e ligjit.

Nuk mund më të tolerohet kjo mënyrë e sjelljes në Kosovë, që gjithmonë të devalvohet një sistem, i cili është krijuar në të vërtetë për t'i ruajtur vlerat, për t'i avancuar vlerat, për t'u thirrur në standardet edhe të vendit, por edhe ato ndërkombëtare, dhe nuk e kuptoj se si është e mundur që vërtet sillemi kështu.

Nuk mund të themi nuk ndërhyjmë në çështjen e kësaj, çështjen e asaj, e po e dimë krejt, të gjithë po e dimë që është keq. Në diçka që e ke krijuar si institucion dhe Kuvendi i Kosovës ka krijuar agjenci, ka krijuar borde, ka krijuar institucione, gjykata e tjera, sepse ka deleguar njerëz dhe të thuhet 'mos ndërhyjni', 'na e keni dhënë mandatin', 'ne bëjmë çka duam tash me drejtësinë në Kosovë'!

Ka nevojë që jo të ndërhyhet, por të krijohet përgjegjësi e lartë dhe ai që nuk e zbaton drejtësinë ashtu si duhet, ai që nuk e zbaton ligjin ashtu si duhet, duhet të ndërmerren masa ndaj tij, sepse tani viktimë po mbeten veç qytetarët, nuk po mbeten ata që po i viktimizojnë të tjerët. Dhe, në këtë rast, kemi viktimizim të qytetarëve të Kosovës, duke u thirrur edhe në rastin konkret.

Dhe, jam i bindur që po të duam, edhe si Kuvend, edhe si institucione të vendit, të cilat janë krijuar me shumë mund, djersë e gjak, ne do të mund ta bëjmë një sistem ligjor ashtu si duhet në Kosovë, një gjyqësi dhe një drejtësi ku besojnë qytetarët dhe të mos lejojmë më që fati i njerëzve të varet nga një individ, qoftë për ambicie politike, qoftë për do teke të veta, që dikë do ta dëmtojë në jetën e tij.

Prandaj, këtë debat e shoh si të frytshëm dhe vërtet e përkrah komisionin, i cili duhet të krijohet dhe ta trajtojë këtë temë në mënyrë që drejtësia të fillojë të funksionojë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Justina Pula-Shiroka.

JUSTINA PULA-SHIROKA: I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Edhe unë, sikur shumë deputetë të tjerë të nderuar, i jam bashkëngjitur iniciativës së zotni Lladrovci për trajtimin e rastit "Kiçina" në Kuvendin e Kosovës.

Ky proces gjyqësor që nga fillimi, pastaj me rastin e nxjerrjes së aktgjykimeve dhe, edhe tani kur po flasim, ka qenë i përcjellë me perceptime publike për shkelje të natyrave të ndryshme në të gjitha nivelet e procedimit, si aktgjykime të mbështetura në prova të

papranueshme, si aktgjykime të dhëna në mungesë të provave materiale, si aktgjykime të dhëna mbi bazën e presioneve ndaj dëshmitarëve.

Nisur nga kjo, në rastin “Kiçina” ekzistojnë dyshime të bazuara se janë bërë shkelje të të drejtave të njeriut dhe parimeve themelore të një gjykimi të drejtë. Me qartë, gjykimet e dhëna në rastin, janë të formës përfundimtare, janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e rregullta ankimuese për rastin.

Në këtë kuadër, shtrohet çështja se në çfarë drejtimi do të shkojë tani ky rast, për të cilin potencialisht janë mbyllur të gjitha rrugët ligjore momentale sa i përket aspektit të ankimit.

Nisur nga kjo, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të procedojë me themelimin e komisionit ad hoc për verifikimin e dyshimeve për shkeljet në rastin “Kiçina”. Në formimin e komisionit ad hoc nuk synojmë në asnjë mënyrë që të ndërhyjmë në punën e Gjyqësorit, por është e drejtë jo e patjetërsueshme që ta japim kontributin dhe angazhimin tonë për t’i verifikuar shkeljet që mund të jenë bërë dhe për të cilat ekzistojnë dyshime në kuadër të këtij procesi.

Komisioni ad hoc rastin do ta trajtonte në prizmin e hetimeve të dyshimeve të bazuara të shkeljes së të drejtave të njeriut në rastin “Kiçina”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ky debat sot besoj që është i kuptueshëm prej të gjithëve, e do të duhej edhe të kuptohet që është jo ndërhyrje në drejtësi, por ndërhyrje në padrejtësi dhe nëse është ndërhyrje, atëherë është ndërhyrje në padrejtësi, e nëse është gabim ndërhyrja në padrejtësi le ta diskutojmë.

Por, njëkohësisht, edhe do të duhej të merrej ky debat si anim në anën e drejtësisë, pra në mbrojtje të drejtësisë.

Njëkohësisht, duke qenë në mbrojtje të drejtësisë, ne jemi edhe në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, e sidomos kur në emër të drejtësisë shkelen këto të drejta dhe liri të njeriut.

Fillimisht, ajo që do të duhej dhe duhet ta bëjmë gjithmonë është një gjë që rasti “Hajra” është njëri ndër krimet më të mëdha që kanë ndodhur në kohën e pasluftës. Pra, nuk besoj që dikush e diskuton këtë. Është një krim shumë i rëndë dhe është një krim, i cili e ka terrorizuar opinionin. Pra, si të tillë, ne do të duhej ta dënonim. Besoj se secili prej jush e dënon dhe do ta dënojë, ashtu siç e ka dënuar opinionin rastin si rast, rastin si njërin ndër krimet më të tmerrshme.

Por, në mungesë të fakteve, në mungesë të gjetjes së fajtorëve, ne nuk do të duhej kurrë të prananim që të pafajshmit ta paguanin çmimin e fajtorit.

UNMIK-u, edhe këtë rast, por edhe rastet tjera të ngjashme, siç është rasti “Kiçina” pra, pastaj edhe rasti i 10 shkurtit, ka vazhduar të ushtrojë padrejtësi të vazhdueshme ndaj popullit të Kosovës, e në veçanti ndaj shqiptarëve të fokusuar ndaj ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Por, ajo çfarë do të duhej ta bënin institucionet e drejtësisë së Kosovës do të duhej të ishte ndërhyrje në këtë padrejtësi, para se ne të ndërhyjm si Parlament. Pra, të ndërhyjnë në këtë padrejtësi duke e vënë drejtësinë në vend, por institucionet e Kosovës, në këtë rast institucionet e drejtësisë, edhe duke përfshirë institucionet politike të Kosovës, e vazhduan atë çfarë bëri UNMIK-u, po e vazhdojnë padrejtësinë që e bëri UNMIK-u ndaj shqiptarëve edhe në rastin “Kiçina” .

Ato që i tha deputeti Lladrovci më herët janë të gjitha ato që i tha, ndoshta do të duhej të ishin më shumë si gjetje të komisionit hetimor parlamentar në fund, ndoshta të gjitha janë të sakta, ndoshta edhe mund të jenë e të mos jenë të gjitha të sakta, nuk dua t'i paragjykoj, por të gjitha ato që u thanë ndoshta do të duhej të ishin si gjetjet e një komisioni hetimor parlamentar, të cilin do ta përkrahim dhe të cilin do ta formonte ky Parlament.

Dhe, ky komision normalisht që nuk është as gjyq, as prokurori, as panel gjyqësor, përveçse një komision, i cili do të dijë më shumë në interesin e qytetarëve, do të dijë më shumë për drejtësinë, respektivisht padrejtësinë.

Por, ajo që dihet tashmë nga të gjithë, që është evidente dhe që është fakt, është se më shumë se një dekadë po vazhdon një padrejtësi, së paku gjykuar nga unë dhe nga shumë të tjerë këtu, duke përfshirë edhe diskutimet e deputetëve, duke përfshirë edhe kërkuesin e këtij debati. Pra, ne dyshojmë në një padrejtësi, e cila ka ndodhur tash më shumë se një dekadë. E në këtë dekadë janë më shumë se një shekull dënim për vëllezërit Kiçina dhe Ramadani.

Për momentin, më falni, por nuk dua ta di se cila është procedura, cila është e drejta, cila është e shtrembra, cilat janë procedurat dhe kompetencat e Parlamentit, a ka Kuvendi të drejtë të debatojë apo të mos debatojë për këtë çështje, por ajo që dua ta di unë është se këta njerëz që janë në burg janë të fajshëm, apo të pafajshëm. Drejtësia apo e ashtuquajtura drejtësi nuk e ka vërtetuar një gjë të tillë, për shkak se këta njerëz janë të dënuar pa prova, pa fakte, pa dëshmitarë.

Ajo që dua ta di edhe unë si njëri nga bashkëluftëtarët e atyre djemve është që dua të di se a janë vrasës vëllezërit Kiçina dhe Ramadani, apo është vrasëse drejtësia në Kosovë. Nuk janë të dyja palët tash të pafajshme në këtë rast. Ajo çka është vërtetuar që nuk është i fajshëm deri tash është vërtetuar se vëllezërit Burim e Arsim Ramadani dhe vëllezërit Kiçina nuk janë të fajshëm deri më tani, së paku nga ajo që na ka afruar drejtësia, respektivisht padrejtësia në Kosovë tani.

Së paku sot do të duhej të ishte ministri i Drejtësisë, ta dëgjonte këtë ndërhyrje të Kuvendit në drejtësinë, por sidoqoftë edhe ministri i Drejtësisë, edhe drejtësia, në

përgjithësi, në Kosovë nuk do të duhej t'i frikësohej këtij debati, përkundrazi do të duhej ta merrte këtë debat si një mundësi më shumë për ta vënë drejtësinë në vend dhe si ndihmë që po i bën Legjislativi drejtësisë në këtë rast dhe assesi si ndërhyrje në drejtësi.

Normalisht atë që do të duhej ta donim ne dhe atë që dua unë është që vrasësit të ishin para drejtësisë. Vrasësit e këtij rasti shumë të tmerrshëm të dënoheshin për punën që e kanë bërë, por aq sa i dua vrasësit para drejtësisë, i dua të pafajshmit të lirë.

Prandaj, edhe sot, ky është motivi që unë ju drejtohem juve. Unë personalisht, e theksoj, besoj shumë se janë të pafajshëm Arsimi, Burimi, Blerimi, Jetoni dhe Arbeni. Por, këtë besim timin do të duhej që drejtësia të ma vërtetonte, do të duhej që drejtësia në Kosovë ta nxirrte edhe një herë në pah që në këtë vend ndoshta duket diku një dritë në fund të tunelit dhe mund të ketë drejtësi për këtë vend.

Kërkoj drejtësi dhe kjo nuk është ndërhyrje në drejtësi. Kërkojmë fakte dhe kjo nuk është ndërhyrje në drejtësi. I kërkojmë vrasësit dhe kjo nuk është ndërhyrje në drejtësi. Nëse është ndërhyrje, atëherë është ndërhyrje në padrejtësi dhe në këtë padrejtësi do të duhej të ndërhynim edhe më herët, duhet të ndërhyjmë edhe sot dhe këtë faj për ndërhyrje në padrejtësi do ta merrja me kënaqësi.

Në fund, kërkoj që Parlamenti i Kosovës, pas këtij debati, ta formonte një komision hetimor parlamentar për t'i parë edhe një herë procedurat, për ta parë edhe një herë punën e drejtësisë, e jo për të ndërhyrë në drejtësi. Atë që ne e duam më së shumti, është drejtësia, pra ajo që më së shumti u nevojitet sot vëllezërve Ramadani dhe Kiçina është pikërisht drejtësia.

Ne shumica prej këtyre mund të jemi prindër. 10 minuta po të na vonohen fëmijët nga shkolla, ne shqetësohemi. Ata ka 10 vjet që nuk janë në shtëpitë e tyre, e tragjike dhe e tmerrshme është sikur 10 vjet t'u mohohet e drejta e tyre, duke qenë njëkohësisht edhe të pafajshëm. Nëse janë të fajshëm, le t'i dënojnë, nëse janë të pafajshëm le t'i kthejmë në shtëpi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit kryetar!

Përsëndetje për të gjithë,

Kolegë deputetë,

Dhe, më lejoni që të konstatoj pozicionin tim si deputet dhe mendoj edhe të kolegëve të mi, që jemi në pozicion që të zgjedhim a të jemi prokurorë, apo të jemi gjyqtarë, apo avokatë. Asnjë pozicion të tillë nuk kisha mund ta marr për vete dhe në këtë aspekt ju kërkoj falje të gjithë ju nënshkruesve të kërkesës për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës dhe për mua shumë më e qëlluar do të ishte sikur të bisedonim për drejtësinë, në përgjithësi, në Kosovë.

Në kuadër të kësaj, ju kisha garantuar që kishim mund të gjejmë me qindra raste, kur në vend të drejtësisë e kemi pasur padrejtësinë.

Absolutisht konsideroj se ne, edhe nëse bisedojmë në media dhe në televizion, nëse ka dhënë ndokush ndonjë deklaratë, sikur gjithë mund të interpretohet që është ndërhyrje në drejtësi, e nëse bisedon një institucion kaq serioz, siç pretendojmë që është Parlamenti, për një çështje juridike, unë mendoj se objektivisht do të shkruhej në anale të historisë, sepse kemi biseduar për një temë që s'kemi pasur të drejtë të bisedojmë. Secilin deputet që e pyet, a je për drejtësi, të gjithë kishin votuar pro drejtësisë, por të bisedohet për raste të veçanta, mendoj që kemi rrëshqitur nga pozicioni kushtetues, pozicioni i ndarjes së pushteteve sipas Kushtetutës së Kosovës.

Tash për drejtësinë do të ishte më së miri të zbulohen vrasësit e vërtetë të asaj familjeje, pastaj të mund flasim për këtë rast si rast i shkëljes së rëndë të të drejtave të njeriut. Por, gjithsesi konsideroj që kemi gabuar që kemi hyrë në këtë debat dhe unë e mbaj të drejtën e abstenimit, sepse nuk e marr asnjë rol, as të avokatit, as të prokurorit, as të gjyqtarit. Nuk e kam atë të drejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Berat Buzhala e ka radhën për fjalë.

BERAT BUZHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e shoh një keqkuptim rreth ndarjes së pushteteve në debatet që po bëhen. Pushtetet, siç e kemi mësuar edhe në shkollë dhe siç na kanë thënë edhe këtu, janë Legjislativi, Ekzekutivi dhe Gjyqësori, e ne çdo ditë të zotit flasim për Ekzekutivin. Pra, pushtetet janë të ndara, që ne të mos marrim vendime në emër të pushteteve të ndara, pra ne nuk kemi të drejtë t'i anulojmë vendimet e gjykatave. Ne nuk kemi të drejtë të marrim vendime në emër të ekzekutivit, por kemi të drejtë të flasim për punët e secilit. Ne jemi, madje e kemi detyrë të flasim për punët e gjyqësorit, për punët e ekzekutivit, sepse kjo është detyra e jonë, nuk guxojmë të përzihemi në vendimmarrje, mirëpo të ngritim shqetësime e kemi obligim.

Tash rreth çështjes për çka po diskutojmë. Ky rast ishte fillimisht rasti Hajra, u vra një familje në mënyrën më brutale të mundshme edhe ishte një lajm i zi për Kosovën, Kosovën e pasluftës, sepse u vranë fëmijë, u vra familja, pa marrë parasysh motivet që kanë mund të jenë prapa këtij krimi. Mandej ky rast u bë rasti “Kiçina”, sepse prej një krimi ndodhi një padrejtësi edhe një familje tjetër tash disa djem të ri u sakrifikuan për hir të zbardhjes së të vërtetës. Pas rastit “Kiçina”, tash ne mund ta injorojmë, mirëpo ky rast po shndërrohet në rastin “Syleviq”.

Pra, rastin “Kiçina” e ka prodhuar Fadil Syleviqi, të cilin unë personalisht nuk e njoh. Ne mund të pretendojmë ta injorojmë ndonjë elefant edhe të diskutojmë për nuancat e drejtësisë, mirëpo jo. Ato çka i tha kolegu Ramiz Lladrovci, më ato nuk mund të futen në thes, ato nuk munden, tash ne të pretendojmë se nuk kemi dëgjuar kurrëgjë, na e kemi dëgjuar kolegun Lladrovi duke folur për një person i cili dyshohet për krime notere, pra është një person me emrin Fadil Syleviq, i cili qenka përgjegjës për krime para luftës, për krime pas luftës dhe për krime gjatë luftës. Si u bë q ai person, pra rastin “Kiçina” është pjellë e tij, nga ajo që u ngrit këtu si shqetësim, si u bë pra që ai person pas luftës të ngritët aq larg në hierarkisë e Policisë së Kosovës? Pra ku ishim ne të gjithë këtu që e

lejuam atë njeri i cili paska kryer krime, kjo është njëjtë për ne, është ngjashëm sikur një kolaboracionist i Izraelit që ka bashkëpunuar me SS-in, tash të jetë në radhën e Policisë të Izraelit, nuk ndodh kjo.

Një ditë e pata një rast, po shkoja në Gërmi edhe për pak me shkeli një veturë edhe bërtita thashë - a ka more policë në këtë vend edhe një polic tha, kishte qenë afër meje tha: “ka policë, po më qojnë në standarde e më heqin”, pra a ka, ku janë ato standarde për Fadil Syleviqin, ku është Prokuroria? Këto që u thanë në këtë foltore, Prokuroria me ligj e ka obligim sendet që thuhet në foltore, të merren për bazë për inicimin e hetimeve, jo vetëm këtu, këtu domosdoshmërisht edhe shkrimet në gazeta edhe shkrimet, pra të gjitha janë fakte për, ose janë bazë e mjaftueshme që policia t’i fillojë hetimet edhe Prokuroria. Në rastin e Fadil Syleviqit, do të duhej tash na pa humbur kohë, pra të formohej ai Komision, të thirret Ministri i Drejtësisë edhe ta diskutojmë çështjen që a kemi në mesin e Policisë tonë një njeri që ka kryer krime, para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës? Pra, ne mundemi tash të diskutojmë tash për nuanca, mundemi të diskutojmë në parim për rastin, mirëpo këtu parim nuk ka, sepse po dihet që një njeri ka detyruar dhunshëm dëshmitarët edhe Gjykata vepron vetëm mbi dëshmitarët, jo mbi opinionet tona.

Nëse Fadil Syleviqi i ka përpunuar ata dëshmitarë dhe i ka detyruar ata që të përgjigjen asisoj, Gjykata nuk mundet të marrë vendime tjera. Mirëpo, një drejtësi nuk mund të vihet në vend me një padrejtësi, pra në këtë rast duhet të kthehet rasti prej fillimit, ta shohin kush është Fadil Syleviqi, se si është ngritur ai në pozita, kush janë ata kolaboracionist për të cilët aq shumë flasim këtu dhe ta dimë pra ta bëjmë edhe lustrimin e këtyre kolaboracionistëve që janë në pozita publike edhe në këtë mënyrë ta zbardhim edhe rastin “Kiçina”. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Me vetë faktin që rasti është komprometuar, si i tillë e komprometon krejt procesin. Flasim për një rast i cili u gjet fajtor në rastin e humbjen të një familjeje, një familje e cila është zënë në pritë, një familje e cila ka pasur fëmijë dhe një familje e cila ka marrë dënim kapital pa gjyqësor. Unë e di që ka këtu besimtarë të kësaj pune që me prita dhe pagjyqësor, kryhen do punë më shpejtë, por nuk i bën nderë as fletushkat, as dhënia e epitetit, në këtë rast të dënuarve, të luftëtarit, s’ ka të bëjë me luftëtar as s’ ka të bëjë me epitetet tjera, ka të bëjë me dy djem të rinj, ka të bëjë me dy vëllezër edhe një djalë i ri që iu ka lidhur thesi, ia kanë lënë kufomat në gardh, siç thotë populli edhe problemi më i madh është që vrasësit janë jashtë.

Problemi më i madh është që drejtësia nuk mundet të flejë rahat përderisa ata që e kanë bërë, se dikush e ka bërë atë rast, ata janë jashtë. Njerëzit mbahen me dënime kapitale brenda duke ditur se vrasësit janë jashtë, ky është problemi kryesor dhe kjo është ndërhyrje, kjo është toleranca që kërkon ndërhyrje, sepse nuk mundet të jetë kurrkush i rehatshëm përderisa beson që vëllezërit Kiçina po mbahen me dënim kapital brenda, ndërsa vrasësit janë jashtë.

Tash, krejt vrasjet tjera në pritë, krejt vrasjet tjera me porosi dhe vrasjet tjera që lidhen me dhunë politike dhe të motivuara politikisht, duhet të zbardhen.

U gjet një rast ndoshta, sepse në atë kohë i është dhënë prioritet, por unë jam njëri prej deputetëve që e kam nënshkruar petitionin me bindje të plotë që rasti duhet të zbardhet, të gjendet rruga për t'u zbardhur rasti gjithqysh, sepse problemi më i madh është se nuk ka pushuar drejtësia përderisa nuk është gjetur apo nuk është zbardhur rasti deri në fund. Pafajësia e tyre lidhet me besimin në mungesën e provave. Prej fillimit ka pasur problem, rasti është përcjell, është politizuar, mbrojtja iu është dhënë duke ua dhënë epitetin se luftëtarët janë zgjedhur të dënohen dhe të dy anët e kësaj medaljeje kanë qenë realisht ato që s' u kanë ndihmuar vëllezërve Kiçina, në asnjë rast, as ata që i kanë zgjedhur për t'i quar në burg as ta që janë munduar t'i mbrojnë, sepse në të dyja anët është ngarkuar kerri aq shumë, sa djemtë sot e asaj dite janë atje.

Po flasim për drejtësinë që është problemi kryesor. Kërthiza e krejt problemeve në Kosovës, është sundimi i ligjit. Ne kemi problem brenda vetit me funksionimin e shtetit, me integrim evropian, me integrim euroatlantik edhe me gjithçka tjetër, sepse Kosova është ambient ku nuk sundon ligji dhe me vetë faktin që shtylla e gjyqësorit lidhet me këtë problem, tregon qartë që njëri prej njollave kryere komprometuese vëllezërit Kiçina ia japin drejtësisë dhe gjyqësorit.

Atëherë apeli ynë është që organet kushtetuese të merren me këto probleme, sepse disa herë rastet janë kthyer në rigjykim në Kosovë. Unë nuk bëj apel tjetër pos që të zbardhet rasti dhe të gjenden vrasësit e vërtetë në mënyrë që të lirohen njerëzit e pafajshëm, sepse të mbahen 30 vjet në burg, të dënohen 30 vjet, të mbahen në burg kaq gjatë vërtet nuk ka mundësi të kompensohet, sepse është një jetë dhe një jetë e tërë po shkon në këtë rast. Apeli im është që vërtet të gjenden vrasësit e vërtetë dhe të lirohen djemtë nga kjo akuzë edhe ky dënim kapital, sepse unë besoj në këtë rast që duhet të zbardhet dhe duhet të zgjidhet drejt.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju njoftoj se janë paraqitur nëntë veta dhe të gjithë janë nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike. Fjalën e ka Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Është një temë shumë e rëndë, është një temë shumë senzitive. Ka një gamë trajtimesh që e kërkon me përgatitje gjithfarë dhe me kompetenca të ndryshme. Njerëz kompetent që duhet ta trajtojnë këtë lëndë e kanë thënë fjalët e tyre përfundimtare, por megjithatë që është trajtuar në publik dhe nga ajo që dëgjuam këtu, lë të dyshohet që kjo lëndë është trajtuar me kompetencë dhe është vendosur drejt.

Duke qenë njëri ta ata shumë qytetarët e Kosovës që e kanë përjetuar padrejtësitë e sistemit të drejtësisë dhe i vendimeve në emër të popullit dhe në emër të drejtësisë ashtu siç kam përjetuar edhe unë tri herë, dhe duke pasur një përvojë të gjatë nëpër burgje të ndryshme, me protagonistë të dënuar pa faj dhe pa argumente juridike, jashtëzakonisht

me provokon kjo temë dhe jashtëzakonisht më prek kjo lëndë dhe jashtëzakonisht më dhimbsen këta të rinj, sepse së pari më imponohet dyshimi se ata janë dënuar pa të drejtë.

Nuk brengosem shumë se vrasësit e vërtetë janë jashtë, për ata le të brengosen institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë, por ajo që më brengos mua, është fakti se aty është bërë një hetim i dyshimtë, i njëanshëm, me njerëz me ngarkesa dhe jo kompetent dhe në një kohë ende pa u konsoliduar sistemi i sigurisë dhe i drejtësisë, ishin përpjekje të para në të cilat sisteme dhe në të cilat institucione ishin akomoduar dhe ishin infiltruar edhe protagonistë të cilët kanë qenë kolaboracionist dhe në shërbim të sistemit të padrejtësisë dhe të pasigurisë para luftës, në shërbim të antiluftës dhe në shërbim të antijetës dhe antisistemit të ri të vlerave që po krijoheshin.

Pas përfundimit të Luftës së UÇK-së, filloi krijimi i vendit të ri politik, juridik si dhe krijimi i ri i sistemit të vlerave të përgjithshme. Objektiv në këtë kohë i goditjeve, ishin ushtarët e UÇK-së nga protagonistë të ndryshëm të cilët kanë qenë në shërbim të fshehtë, në shërbime të fshehta të Beogradit dhe me shkathtësi profesionale të cilët janë shkolluar, janë akomoduar dhe kanë depërtuar në sistemin e drejtësisë dhe të sigurisë së UNMIK-ut, i cili ishte në krijim edhe nga profesionalistë të cilët ishin shkolluar në universitete prestigjioze të Evropës dhe Amerikës. Por, natyrisht që ata do të duhej të jenë lajthitur edhe nga një super-profesionalist i profesionit të vet sikur ky tipi Syleviq, edhe ajo mjerëvetja e saj që neve kurrë nuk kemi njohur më herët derisa u bënë të famshëm me veprat e tyre kundër këtij vendi dhe kundër këtij populli. Sa herë të përmenden shkelja e të drejtave të njeriut, kurrë në asnjë vend, në asnjë pozitë politike, shoqërore që unë mund të kem, nuk mund të jem indiferent dhe as nuk mund të rri i qetë, sepse e di shumë mirë që në emër të drejtësisë shkeljen të drejtat e njeriut. Për këto kam parë sa e sa djem të rinj që kamë bërë jetë me ta madje edhe me fakte absurde sikur qysh me ka ndodhur në Goli Otok, të takoj të dënuar që kanë dashur për t'i helmuar kazanët e ushqimit nëpër ushtri, t'i marrin armatimin, tanket, të dalin në Itali, ta kalojnë detin dhe të futen në Shqipëri për ta çliruar Kosovën. Tekstualisht, më besoni që janë të shkruara këtu dhe janë ngritur aktakuza, janë nxjerrë aktgjykime në emër të popullit dhe të drejtësisë.

Sa herë që të ketë procese të dyshimta dhe të përmenden deklarata ashtu siç i dëgjuam në këtë rast edhe nga kolegu Ramiz Lladrovci, me të cilin jemi sensibilizuar krejt grupi dhe i kemi ndarë detyrat dhe rolet këtu në këtë temë që ai të bëjë një përshkrim të gjerë, Fadili të bëjë një sintezë të atyre shkurtimisht dhe përmbledhtazi dhe profesoresha e nderuar të nxjerrë sintezën dhe konkluzionet profesionale që i duhen qasjes së këtij procesi dhe pastaj ne të tjerët të japim kontributin tonë dhe të qetësojmë ndërgjegjen qytetare.

Sa herë të përmenden deklaratat të nxjerra me dhunë unë menjëherë në kujtesën time sjell dhjetëra, qindra dhe mijëra të rinj të cilët janë detyruar nga dhuna të deklarojnë edhe gjëra absurde të cilat as nuk i përthekonte mendja, as s'mund t'i pranonte logjika e shëndoshë dhe as një kohën, hapësirën nuk përputheshin kurrsesi. Tani kur bëhet fjalë për një të ri të mitur, të cilin e kanë detyruar të bëjë një, të nënshkruaj e jo të bëjë, të nënshkruaj një deklaratë të rrejshëm, unë menjëherë krijoj bindjen që kjo mund të jetë shumë e vërtetë, sepse gjërat e tilla, mekanizmi i dhunës dhe izolimi në vetmi dhe

përdorja e metodave dhe mjeteve të cilat janë të padurueshme për fizikun e njeriut, mund të imponojnë një nënshkrim edhe pa e lexuar tekstin se çfarë po nënshkruan.

Arkitektët të cilët e kanë bërë, e kanë konstruktuar këtë proces, natyrisht se kanë qenë me përvojë në këtë punë dhe natyrisht se e kanë njohur edhe shkallën e dhunë deri ku mund të durojë njeriu. Rasti i ndodhur më 20 gusht 2001 ka qenë shumë tragjik dhe i dhimbshëm. Pavarësisht që kjo dhimbje është manifestuar në forma dhe në mënyra të ndryshme, ne edhe tani ndiejmë keqardhje që ky rast ka ndodhur edhe për arsyen se autorët e këtij rasti nuk janë sjell para drejtësisë. Kjo duhet të jetë brengë e drejtësisë së vërtetë dhe i protagonistëve me pedigree, me përvojë dhe me eksperiencë juridike që tani janë në sistemin e drejtësisë. Dëgjova për prova edhe për argumente që i ka përdorur gjykata dhe për të gjitha ato që është dashur t'i sheshojë dhe t'i vërtetoj ekspertiza e mirëfilltë e cila nuk i ka bërë as me kohë dhe len dyshimin që nuk janë të faktuara as tani.

Në praktikën gjyqësore, në gjithë rruzullin dhe me ato shtete ku janë shembulli më i mirë i drejtësisë, ka raste për vuajtje të dentarëve pa u vërtetuar provat dhe faktet dhe janë nxjerrë, janë ngritur aktakuzat dhe janë nxjerrë aktgjykime, gjatë vuajtjes së dënimit, pas dhjetëra viteve, sepse ka pasur dhe kemi raste edhe dënime me vdekje, pas dhjetëra viteve është vërtetuar nga ekspertiza profesionale që ata të dënuar nuk janë autorët e vrasjeve makabre dhe për këto raste, është njoftuar i gjithë opinioni botëror, kështu edhe ne në gjuhën shqipe kemi pasur raste të tilla që i kemi lexuar dhe natyrisht që t'i inkurajojnë të thimthojnë nuk të lënë të qetë, natyrisht se të motivojnë edhe për raste të dyshimta të dënuara që kanë formën e prerë në sistemin e drejtësisë, të ngre dyshime, t'i trajtojnë në publik, madje të mos ketë mungesë kur ajo edhe në këtë foltore të trajtohen.

Baza mbi të cilën është konstruktuar aktakuza dhe më pas është nxjerrë aktgjykimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Më vjen mirë që sot në Kuvend po debatohet për një rast shumë eklatant në drejtësinë e Kosovës, pas luftës dhe që konsiderohet një nga rastet më të ndjeshme që ka të bëjë me gjyqësorin në Kosovë.

Dua fillimisht të mbështes iniciativën e marr nga deputeti Lladrovci, të cilën e mbështetëm edhe 80 deputetë tjerë dhe kisha dashur që sot mbështetje të së vërtetës për rastin “Kiçina”, të dalin të gjithë deputetët e këtij parlamenti pa dallim, sepse konsideroj që nuk do të jetë ndërhyrje në drejtësi nëse kërkohet që e drejta të zbardhet dhe vërteta të dalë në shesh. Në këtë rast, në rastin “Kiçina”, prezantohen dy anë të tmerrshme të medaljes, në rastin e parë vrasja makabre e familjes Hajra, dhe në rastin e dytë padrejtësia ndaj një grupi të rinjsh të pafajshëm ish- ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët po mbahen që 13 vjet në burg. Besoj që të gjithë këtu duan që të dënohet çfarëdo

krimi dhe krimin në rastin Hajra gjithashtu, por të gjithë këtu po ashtu duam që të zbardhet drejtësia dhe të merren në konsideratë faktet për zbulimin e plotë të këtij rasti.

Janë plotë prova të trupit gjykues të cilat asnjëherë s'i mori në konsideratë dhe që do të mund të qonin deri te e vërteta në rastin "Kiçina" si pasojë e kësaj mospërfilljeje të fakteve, pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe sot e kësaj dite po vuajnë dënimin prapa grilave.

Po ashtu siç na është e njohur nga lënda e këtij rasti dhe nga publikimet e shumta në media, në krejt këto vitet e fundit rezultatet e shumë provave gjatë këtij procesi gjyqësor ose janë zhdukur ose janë injoruar ose nuk janë publikuar kurrë. Kjo është bërë me të vetmin qëllim që të fshihet e vërteta e autorësisë së krimit mbi familjen Hajra dhe të mbahen padrejtësisht pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare në pranga.

Të nderuar deputetë,

Është e vërtetë që ka ndodhur një krim i rëndë ndaj familjes Hajra, por është edhe një fakt, por as edhe një fakt i vetëm nuk dëshmon se njerëzit që mbahen në burg janë autorët e vërtetë të këtij krimi. Andaj sot duhet ta mbështesim këtë iniciativë për të adresuar edhe një herë në gjykatore krejt këtë rast, për të shoshitur mirë dhe për ta zbardhur të vërtetën një herë e përgjithmonë. Kriminelët duan me çdo kusht të dalin para drejtësisë, të dalin kriminelët e vërtetë dhe jo të inskenuar. Askush nuk ka të drejtë të trillojë e aq më shumë ta mëveshë autorësinë e kësaj vepre të shëmtuar te disa djem që me nder e bënë luftën për lirinë e Kosovës të cilën ne e gëzojmë sot.

Kur ata u akuzuan dhe hynë në burg ishin të rinj të moshës mesatare 21 dhe 22 vjeç, prandaj është e padrejtë që t'u mohohet e drejta e jetës në liri këtyre njerëzve kur dënohen pa asnjë fakt dhe pa asnjë argument. Kuvendi i Kosovës edhe pse me vonesë më vjen mirë që sot po e trajton këtë temë, prandaj do të kisha dashur që të mbështesim fuqimisht edhe një herë them formimin e një Komisioni ad hoc dhe të shqyrtohet edhe një herë ky rast që vetëm e vetëm drejtësia të bjerë në vend dhe këta djem të cilët padrejtësisht po mbahen në burg të lirohen dhe ta gëzojnë lirinë për të cilën kanë kontribuar aq shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si të zgjedhur me votën e qytetarëve të Kosovës, jemi të mandatuar që të mbrojmë në përputhje me përgjegjësinë që e kemi secilin qytetar të Republikës së Kosovës, nga shkëlja e të drejtave të tyre, nga kushdo qoftë që mund t'u vijë apo t'u ndodhë kjo shkëlje.

Edhe më drastik tingëllon fakti kur këto të drejta u shkelen pikërisht nga ana e organeve që janë të thirrura të garantojnë rendin dhe sjellin drejtësi. Në rastin "Kiçina", konsideroj se ka ende hapësirë të flasim për shkeljet e mundshme të drejtave të njeriut. Jemi të vetëdijshëm që është një rast shumë i ndeshem dhe kompleks, mirëpo vënia e drejtësisë

në vend është shumë më me rëndësi, si për familjet e implikuara në rast, ashtu edhe për institucionet tona.

Vrasja e rëndë që ka ndodhur më 20 gusht 2001, ka pasuar me një gjykim të disa djemve të rinj, të cilët në kohën kur ka ndodhur krimi, po festonin ditëlindjen e njërit prej miqve të tyre, Burim Ramadanit, atëherë 21 vjeçar.

Gjykata ndërtoi në skenar mbi një dëshmitar që më vonë u shpall si i pa saktë. Dëshmia e Blerim Kiçinës, fillimisht e pranuar nga Gjykata, më pas u hodh krejt poshtë po nga Gjykata. Fakte të tjera nuk pati, por procesi u përmyll me dënim me 105 vjet burg për të gjithë të akuzuarit e këtij rasti. Prandaj, ne duhet ta japim kontributin tonë që drejtësia ta marrë pamjen e vërtetë dhe të plotë të saj. Kush ka të drejtë që para syve tanë të inskenojë proceset të tilla kaq të dhimbshme dhe të pakuptimta si në të kaluarën, si në procesin totalitar ku fajësia dhe faktet janë fabrikuar në kuzhina të caktuara propagandistike politike?

Konsideroj se asnjë gjykatë nuk dua t'i japë vetes të drejtë që të sajojë fakte, të trillojë zhvillime dhe në sy të krejt botës të ndërtojë një proces të paqenë. Rastin i vrasjes së familjes Hajra është krim i shëmtuar. Aty pësuan edhe fëmijë, autorët e vërtetë duhet të gjykohen dhe të dënohen, por askush nuk ka të drejtë që në pamundësi që të gjejë aktorët e vërtetë, autorësinë e krimit pa fakte bindëse t'ua hedhë disa djemve të rinj dhe të ndershëm. Drejtësia nuk vendoset duke bërë padrejtësi ndaj dikujt tjetër, ajo ndërtohet duke gjetur shkakun real, faktin real. Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, kërkoj ta mbështesim iniciativën për rishikimin e rastit “Kiçina” duke marrë në konsiderim faktet e reja që hedhin dyshime në shkelje të procedurave gjatë hetimeve dhe konstruimit të rastit në mënyrë që të korrigjohen gabimet më të rënda që bëri drejtësia para rreth 11 vjetësh.

Sot mund të dëshmohe mi si shtet i vërtetë vetëm nëse në radhë të parë vendosin të bëjnë drejtësi të vërtetë. Procesi gjyqësor në rastin “Kiçina”, mendoj se nuk duhet konsideruar si i mbyllur, sepse djemtë të cilët luftuan për lirinë e Kosovës, sot dergjen burgjeve pa e shijuar frytin e kontributit të tyre për këtë liri, ndërsa dikush ka mundur t'ua kurdisë faktet. Ne duhet të jemi fuqishëm në anën e së drejtës, në anën e fakteve, të provave dhe të vërtetës që në rastin “Kiçina”, u zhdukën bashkë me një dosje të tërë dhe çekani përfundimtar ndau gati për rreth një shekull burg me argumente të dyshimta ndaj disa djemve që luftuan për t'ia hequr burgun disashekullor shoqërisë sonë.

Krejt në fund, mendoj se duhet të gjendet një mundësi në suaza të ligjeve në fuqi që të rishikohet rasti për shkeljet e mundshme të drejtave të njeriut në rastin “Kiçina”, i cili do të mundësonte qartësimin e këtij rasti duke marrë në konsiderim faktet e reja dhe mundësinë e gjetjes së shkeljeve procedurale gjatë këtij rasti. Kjo nuk duhet të merret kurrsesi si ndërhyrje në drejtësi, por si gjetje të së vërtetës që nënkupton edhe ngritjen e besimit në organet e drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara koleg deputetë,
Të nderuar kolegë dhe ju qytetarë të Republikës së Kosovës,
Meqë jam edhe nënshkruese e nismës së deputetit Lladrovci për një debat të organizuar për rastin “Kiçina”, mendoj ia vlen të thuhet disa fjalë, megjithëse fjalimin tim do ta dorëzoj në Sekretarinë e Kuvendit, do ta lexoj vetëm një pjesë të shkurtër dhe meqë edhe angazhimi ynë dhe detyrë jona si deputetë të këtij Parlamenti është që ta mbrojmë ligjin dhe të drejtën, mendoj se ne sot po e bëjmë të njëjtën gjë kur edhe po diskutojmë për rastin më të ndjeshëm për rastin “Kiçina”. Do të ë thotë fakti se nisma e deputetit Lladrovci është e nënshkruar nga 85 deputetë, dëshmon mirëfilli se ne si përfaqësues të popullit nuk mund të jemi indiferent në rastet kur ndodh shkelja e të drejtave të njeriut siç ka ndodhur edhe shkelja me rastin Kiçina, rast ky që sfidojë në mënyrën më të rëndë edhe vetë organet e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Nëse ne sot po diskutojmë do të thotë por rasatin “Kiçina”, nuk mendojmë se po bëjmë keq, por më tepër në këtë seancë apo më mirë të themi në fjalimet e deputetëve, ne sot vetëm sa kemi kontribuar për të sjellë fakte dhe dëshmi të reja, të cilat madje do të mund të i hyjë në punë edhe organeve të drejtësisë. Si deputete e këtij Parlamenti kërkoj edhe një herë që ky rast të zbardhet, pasi që mbrojtja e të drejtave të njeriut është edhe fundament i këtij Parlamenti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Pa dyshim që rastet që ne po i diskutojmë e kanë shqetësuar mjaft opinionin dhe shumë qytetarë të Kosovës kanë kërkuar që ky rast të diskutohet. Ne e kemi një petition të 52 mijë qytetarëve të Kosovës, i dorëzuar Kuvendit të Kosovës, i cili është diskutuar në Komisionin përkatës të Parlamentit për Peticione dhe Parashtresa. Dhe ky shqetësim i opinionit duhet të merret parasysh edhe nga Kuvendi, i cili e ka për detyrë që t’i marrë parasysh kërkesat dhe petitionet e qytetarëve.

Unë nuk do të lëshohem fort në analizën e këtij rasti, i cili në mënyrë evidente po tregon parregullsi, por do t’i ngre disa çështje tjera shqetësuese që bëhen në procese gjyqësore, ku kemi shkelje të të drejtave të njeriut, primeve kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Dua ta përmend faktin që Gjykata Kushtetuese deri më tani ka anuluar mbi 200 vendime të gjykatave të rregullta pikërisht për shkeljen e të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutë, për gjykim të drejtë dhe gjykim të paanshëm.

Dua ta përmend edhe raportin e fundit të Avokatit të Popullit - Ombudspersonit, i cili, duke iu referua shkeljes së të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë fokusohet në shkeljen e të drejtave të njeriut në procese gjyqësore, shkeljen e garancive kushtetuese për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Nuk ka dilemë që në Kosovë, në periudhën e pasluftës ka pasur gjykime me motive politike dhe ka pasur një tendencë të krijimit të ekuilibrit të viktimës dhe të krimeve që

janë bërë në Kosovë, dhe këto raste kanë qenë edhe në gjyqësinë vendore, edhe në gjyqësinë ndërkombëtare, dhe kemi raste, të cilat janë trajtuar si raste të shkeljes së të drejtës ndërkombëtare, por me aktgjykime të formës së prerë janë treguar si të pabaza. Është rasti Limaj, rasti Haradinaj dhe raste të tjera dhe kemi edhe raste të gjyqësisë vendore ku shkelen të drejtat kushtetuese, të garantuara për qytetarët. Po e marr këtu vetëm si pretekst rastin Limaj, i cili dy herë është liruar me aktgjykim për të njëjtën çështje dhe tani i mohohet e drejta e tij kushtetuese për të qenë bashkë me ne për ta realizuar një të drejtë të cilën ia kanë besuar qytetarët.

Thjesht, dukuria e mosrespektimit të drejtave kushtetuese është gjithëpërfshirëse në Kosovë, por është jashtëzakonisht shqetësuese nëse ndodh në sistemin gjyqësor, sepse gjykatat parimisht duhet t'i mbrojnë të drejtat e njeriut dhe duhet të ofrojnë garanci për realizimin e të drejtave të njeriut, kështu që ne duhet ta trajtojmë si çështje shumë shqetësuese, sepse edhe në raportet ndërkombëtare shkelja e të drejtave të njeriut është një element mjaft shqetësues që nganjëherë ndikon edhe në progresin e Kosovës drejtë integritimeve evropiane.

E në mënyrë të veçantë kushtetuese, në qoftë se këto shkelje janë sistematike në procese gjyqësore, në qoftë se qytetarëve u mohohen të drejtat kushtetuese për gjykim të drejtë. Kështu që edhe në rastin që ne po e diskutojmë duhet shikuar a ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, a ka pasur konstatim të së vërtetës materiale. Ne e dimë që nuk mund të ndikojmë në një proces gjyqësor në qoftë se janë shterur mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme, sepse sistemi gjyqësor ofron mundësi të apelimit edhe me ankesa, edhe me mjete të jashtëzakonshme.

Unë e di që në rastin konkret janë shteruar këto mjete, por një diskutim parlamentar për respektimin e të drejtave të njeriut në procese gjyqësore është më se i domosdoshme, sepse e përmenda që 200 aktgjykime të formës së prerë të gjykatave të rregullta janë anuluar pikërisht me arsyetimin se në to është gjetur shkelja e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë, shkelja e të drejtës për mbrojtje, shkelja e parimit të së vërtetës materiale dhe mendoj se ky diskutim duhet t'i nxjerrë këto konkluzione që ne ta bëjmë një analizë gjithëpërfshirëse të realizimit të të drejtave, pikërisht të garantuara dhe me standardet ndërkombëtare për një gjykim të pavarur, të drejtë dhe objektiv. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Mendoj se kjo temë që po diskutohet sot është dashur të diskutohet shumë më herët në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për një çështje që ka të bëjë me shkelje në fushën e drejtësisë.

Pa dashur të interferoj në drejtësi, por me bindjen që sot po e ndihmojmë drejtësinë e vërtetë në Kosovë, konsideroj se të gjithë deputetët e këtij Kuvendi duhet të rezonojnë

drejt dhe të flasin të pavarur, në mënyrë që ta korrigjojmë një shkelje, ndër më të rëndat në Kosovën e pasluftës.

Drama e njohur si rasti “Kiçina” ende vazhdon të ndodhë para syve tanë. Prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë, duke i shkelur të gjitha ligjet dhe duke i injoruar faktet e vërteta, kurdisën një proces gjyqësor që u kushtoi me rreth dy dekada burg disa të rinjve shqiptarë. Pesë prej tyre ende vazhdojnë ta vuajnë burgun, edhe pse provat kur s’u morën parasysh.

Natyrisht se të gjithë ne e dënojmë çfarëdo krimi, por askush nga ne besoj nuk qëndron në anën e shpifjes dhe intrigës, në mënyrë që disa djem të pafajshëm të vuajnë ende burgun për një vepër që, sipas provave, kurrë në jetën e tyre nuk e kanë bërë.

Vrasja e Hamzë Hajrës dhe familjes së tij ishte një ndër krimet më të shëmtuara, por shëmti mbi shëmtinë është ikja e një trupi gjykues nga provat e vërteta që dëshmonin pafajësinë e plotë të djemve që sot padrejtësisht po qëndrojnë në burg.

Të nderuar deputetë,
Të gjitha argumentet e demantojnë dëshmitarin e vetëm dhe nyjën e krejt këtij procesi gjyqësor, por asnjë nga këto nuk u morën parasysh.

Blerim Kiçinës fillimisht i bënë premtime e pastaj presion për ta konstruktuar krejt këtë proces gjyqësor. Sot, ky dëshmitar është i akuzuar dhe i dënuar.

Si rezultat i krejt kësaj kurdisjeje dhe këtij montimi disa të rinj mbahen padrejtësisht në burg. Unë mendoj që drejtësia kosovare tash duhet të flasë realisht dhe ta rishqyrtojë këtë proces.

Shihet qartë gënjeshtër në të cilën u ndërtua procesi. Nyja e krejt kësaj është e gjallë. Është Blerim Kiçina. Andaj, rasti duhet të korrigjohet dhe në këtë duhet të besojmë të gjithë ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit nënkryetar!

Përsëritje ministra,

Të nderuar kolegë deputetë, deputete dhe ju të pranishëm,

Më lejoni t’i përsëritet 50 mijë qytetarë të Kosovës, të cilët e kanë nënshkruar peticionin për rastin “Kiçina”. Më lejoni ta përsëritet në këtë rast edhe familjen Kiçina, duke shpresuar se drejtësia do të vihet në vend.

Çka do që t’i shtoj asaj që u diskutua këtu, ndoshta do të dalë e përsëritur, por sidoqoftë ndiej obligim moral, edhe profesional, edhe për shkak të besimit të qytetarëve, që jemi këtu, t’i them disa fjalë.

Jam e bindur se debati sot në Parlament nuk është ndërhyrje në drejtësi, përkundrazi ne jemi ata që na kanë besuar qytetarët e Kosovës dhe jemi t'i diskutojmë të gjitha shqetësimet e tyre, e nuk janë pak më shumë se 50 mijë qytetarë që e kanë nënshkruar peticionin dhe, mbi të gjitha, atë shqetësim të tyre e kanë verifikuar me firmën e vet mbi 80 deputetë të Parlamentit të Kosovës që kanë kërkuar që të debatohet kjo çështje në Kuvend.

Qëllimi i debatit është që t'i ndihmohet drejtësisë. Ky është mendimi im.

E para që dëshiroj ta them këtu është se jam e bindur se ata djem janë të pafajshëm. E them këtë që mirëkuptohem që të mos merret si ndërhyrje në drejtësi, ngase e kam pasur rastin dhe fatin t'i njoh për së afërmi çlirimtarët e Kosovës, ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në kushtet më të vështira, nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe qytetarët tanë.

E ajo që është shumë e rëndësishme t'i shtohet kësaj në besimin e pafajësinë e tyre është se në Kodin Etik të ushtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk ka qenë asnjëherë e paraparë dhe nuk ka ndodhur të shtihet në gra dhe në fëmijë. Madje, mbi të gjitha, në traditën tonë shqiptare asnjëherë nuk ka ndodhur që të shtihet në gra dhe në fëmijë, dhe krejt kjo çon në atë se këta nuk janë vrasësit. Vrasjen e ka konstruktuar sigurisht dikush tjetër për të lënë pasojë të vazhdueshme te ne si popull dhe si qytetarë, por edhe si institucione, që t'i vendosin para sfidave të mëdha, siç është në këtë rast, një sfidë jashtëzakonisht e madhe edhe për drejtësinë në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk dëshiroj të hyjë në elaborimin e rastit se si ka ndodhur, mirëpo faktet flasin edhe për një laik që nënkupton shumë nga dokumentet e shkruara të drejtësisë duhet ta dijë këtë gjë, se 55 dëshmitarë, të cilët nuk merren parasysh, 109 seanca të stërzgjatura në këtë proces dhe humbja e provave janë elemente shumë të rëndësishme që çojnë deri te ajo se njerëzit e pafajshëm janë duke qëndruar në burg.

Kështu që ne si deputetë kemi obligim që në mungesë të gjetjes së fajtorit të mos lejojmë që të rrëshqitet në padrejtësi. Organet e drejtësisë ta vënë alarmin edhe një herë dhe ta rishqyrtojnë edhe një herë këtë rast.

Madje, motoja e drejtësisë është - "asnjë i pafajshëm në burg", ose sentenca romake - "më mirë 100 të fajshëm në liri, se një i pafajshëm në burg".

Diskutimin tim më të gjerë edhe unë do ta dorëzoj në Sekretarinë e Kuvendit.

Edhe një herë do ta falënderoj kolegun deputetin Ramiz Ladrovci, i cili ka punuar jashtëzakonisht në këtë drejtim dhe ka dhënë kontribut që të silltet ky debat në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Përsëri po e bëjmë një debat pak a shumë të pazakonshëm. Nuk është e zakonshme që çështje të tilla të marrin aq kohë në funksionimin parlamentar.

Megjithatë, është diçka që po imponohet, një debat delikat që mund të rrëshqasë edhe në pozicione në të cilat nuk do të duhej të binim, që të përzihemi në ndarjen e drejtësisë, sepse nuk na takon.

Por, është një debat i imponuar, një debat i vonuar, sepse po flasim për diçka që ka ndodhur para 10 vjetësh dhe gjatë gjithë kohës ka qenë një bindje se është një padrejtësi e madhe dhe çuditërisht nuk pati një reagim adekuat institucional nga ata që do të duhej ta vinin në rrugën e zgjidhjes. Do të ishte shkarje nëse do të fokusoheshim në vetë rastin. Prandaj, unë e çmoj që deputetët kryesisht u fokusuan në fenomenin në mungesën e drejtësisë, në abuzimin me drejtësinë dhe mendoj që për këtë qasje kemi të drejtë dhe mendoj madje që jemi të thirrur. Është çështje e sistemit, e rendit kushtetues, gjë që u bisedua edhe dje. Po i thjeshtëzojmë nganjëherë çështjet, edhe kur flasim për ndarjen e pushteteve.

Krijohet një farë përshtypje, meqë pushtetet janë të ndara, atëherë pushtetet mund të bëjnë ç'të duan. Edhe Qeveria është pushtet i ndarë - Ekzekutivi, por nuk do të thotë që duhet ta injorojë Kuvendin. Edhe Gjyqësori e ka pavarësinë e vet dhe pushtetet tjera nuk duhet përzihen në ndarjen e drejtësisë, por sa i përket zbatimit të ligjeve, ky Kuvend i bën ligjet. Sa i përket pastaj zbatimit të drejtësisë, do të thotë ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë, ky Kuvend nuk mund ta privojë vetveten nga kompetenca për ta mbikëqyrur, për ta kontrolluar dhe për të ndërtuar raporte adekuate të funksionimit dhe të bashkërendimi. Nëse qëndrojmë në këtë nivel, mendoj që nuk bëjmë asnjë shkarje dhe kjo është edhe thirrja ime.

Megjithatë, rasti është bërë si thuash se për të biseduar për fenomenin dhe kjo e justifikon nevojën që ne të debatojmë gjerësisht për drejtësinë.

Zonja e zotërinj,

Është segmenti më i pareformuar te ne, më i patransformuar. Nuk ka pasur në sistemin tonë të drejtësisë një proces të lustracionit, të cilit i janë nënshtruar të gjitha vendet dhe ka pasur më shumë nevojë se sa gjithkund tjetër. Nuk ka pasur një proces të verifikimit. Dje u bë një pyetje parlamentare, po përgjigjja nuk ishte adekuate. Të gjitha vendet e kanë bërë, këtu te ne është improvizuar një farë vetëverifikimi. Nuk ka vetëverifikim. Megjithatë, kjo duhet të bëhet me transparencë edhe me angazhim të atyre që ka qenë viktimë të shkeljeve të shumta në sistemin e drejtësisë.

Padrejtësitë më të mëdha janë bërë pikërisht në emër të drejtësisë, në emër të ligjit dhe shpesh sforcimi i tyre ka krijuar edhe situata që mund të dalin jashtë pastaj zbatimit të ligjit. Mund ta marrin drejtësinë në duar dhe ata që s'do të duhej ta merrnin, s'do duhej të guxonin ta merrnin, por prandaj është shteti që t'i vë në rrugën e zgjidhjes institucionale problemet shoqërore dhe të mos lejojë pastaj të dalin jashtë suazave normale.

A mund të jemi indiferentë ndaj kësaj anomalie që ndodh në sistemin tonë të drejtësisë? Mendoj që jo. Nuk kemi të drejtë. Indiferenca në raste të tilla është bashkëpjesëmarrje dhe mendoj që edhe këtë faj nuk do të duhej ta merrnim.

Unë nuk dua prandaj të flas për rastin. Është i dhimbshëm nga ta marrësh, nuk dua as ta kufizoj vetëm në një palë viktime. Aty ka shumë palë viktime. Viktimë është vetë drejtësia. Viktimë është imazhi i Kosovës. Viktimë ndoshta është edhe kjo gjendje peng që mban peng familje të tëra, një opinion i terë dhe ajo që po e shquaj vetëm si një dilemë: E çka nëse ky rast është pjesë e luftës speciale, me të cilën Kosova është përballur aq gjatë dhe si askush tjetër? Çka nëse ai akt është bërë për t'u zhdukur gjurmët nga bashkëpunëtorët e të ndjerit, se e dimë si ka qenë e kaluara e tij. Dhe, pastaj nëpërmjet njerëzve që janë infiltruar në sistemin e drejtësisë viktimizohen disa të pafajshëm, armiqësohen familjet, na lihet kopili, si thuash te dera, edhe që njerëzit të armiqësohen në dimensione të ndryshe e të tjera, dhe sistemi i drejtësisë e legjitimon, shoqëria kosovare vihet në situatë të pamundshme për ta korrigjuar, e raste të tilla, zonja e zotërinj, kemi jo një, por shumë. Pse? Sepse, rruga e ndërtimit të sundimit të ligjit te ne ka qenë e pazakonshme. Respekt atyre që kanë punuar me përkushtim, pavarësisht nga begraundi i tyre. Respekt edhe atyre që na kanë ndihmuar. Na kanë ndihmuar shumë miqtë ndërkombëtarë, por s'mund të harrojmë që aty-këtu ka pasur edhe anomali të shumta në vazhdimësi, të cilat nuk kemi mundur t'i adresojmë siç duhet. Madje, edhe nga prania ndërkombëtare.

Dhe, ky rast që po e diskutojmë në masë të madhe është përgjegjësi e asaj pjese të drejtësisë që është menaxhuar nga gjyqtarët ndërkombëtarë, e kjo ndonjëherë është bërë me disa argatë vendorë, që është e çuditshme, kanë qenë të favorizuar në gjithë këtë proces. Ndoshta për shkak të prirjes së tyre lajkatare servile dhe nuk ndodh veç në drejtësi. Ka ndodhur në të gjitha fushat dhe nuk e kemi theksuar sa e si duhet.

Megjithatë, bindja e përgjithshme është se është ndarë keq drejtësia në atë rast, siç është ndarë në shumë raste tjera. Këtu u përmend, ta zëmë rasti "Limaj". Ishte rasti "Zeqiraj". Mua më ka ndodhur të shoh vetë aktvendime të studentëve, të cilët janë dënuar pa asnjë investigim, pa asnjë anketim. Thjesht, 'ke qenë në protestë?', 'po', 'pendohesh?' thotë 'jo, sepse kam qenë në drejtën time'. 'Një muaj burg'. Tjetrit, 'ke qenë në protestë?'. 'Po'. 'Pendohesh?'. 'Jo'. 'Je i lirë'. S'ka asnjë referencë në ligj, s'ka asnjë arsyetim. Thjesht, ndarja arbitrare e drejtësisë.

Është zonja e zotërinj recidiv i mendësisë së kaluar, të cilën ne nuk e kemi hequr nga sistemi ynë i drejtësisë dhe mendoj që në një rast tjetër do të duhej diskutuar për këtë.

Po të kthehemi te rasti. Rasti nuk mund të zgjidhet me debat. Nuk mund të zgjidhet për mendimin tim as me protesta. I çmoj përpjekjet, i respektoj angazhimet; s'mund të jemi indiferentë, s'jam as unë indiferent. Por rasti është megjithatë ligjor dhe duhet të gjendet rrugë ligjore për zgjidhjen e tij. Unë nuk kam tani zgjidhje çfarë duhet të jetë. Duhet ta sjellë një jurist, por nuk e shoh të pamundshme që sistemi ynë i drejtësisë të gjejë mënyrë që së paku ta rikthejë në rigjykim, meqë është një shqetësim i gjerë shoqëror dhe nuk ndodhë vetëm te ne kjo që po na akuzojnë ndonjëherë si përzierje në drejtësi.

A ishte në Amerikë rasti “Simson”. Ishte një opinion i tërë që u ngrit në komb. Në të gjitha vendet pothuaj se ka ndodhur. Pse të mos ndodhë edhe te, kur ka bindje se po shkelet drejtësia. Por, zgjidhja, megjithatë, duhet të jetë në rrugë ligjore dhe, për mendimin tim, do të duhej ta zgjidhet paneli i UNMIK-ut dhe i misioneve ndërkombëtare që e ka mbikëqyrur aq sa e ka mbikëqyrë drejtësinë ndërkombëtare në Kosovë. Këtu edhe ka qenë defekti kryesor. Respekt për punën e mirë që e kanë bërë, por ata kanë funksionuar pa kontroll demokratik, pa mbikëqyrje, pa llogaridhënie, e për pasojë edhe kanë qenë arbitrare dhe shpesh janë bërë peng i influencimeve të ndryshme politike brenda nesh.

Dhe, tani, Kosova është e hendikepuar në këtë plan si e tillë, si Kosovë, si tërësi. Kosova është vendi i vetëm, qytetarët e së cilës nuk mund t’i realizojnë të drejtat e tyre në nivele evropiane dhe këtu desha ta vë theksin, ndoshta edhe ta orientoj vëmendjen tonë edhe në qasjen, si të thuash, në këtë rast dhe në raste të ngjashme. Do të duhej të shpërthehej kjo bllokadë dhe disa përpjekje janë bërë

Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare e ka dhënë një shteg, si të thuash e ka hapur një shteg që edhe qytetarët e Kosovës t’i shfrytëzojnë instrumentet evropiane të të drejtave të njeriut dhe të të drejtave fundamentale.

Mendoj që në këtë drejtim do të duhej shfrytëzuar më shumë edhe lehtësimi i institucioneve tonë që i kemi, siç është Avokati i Popullit, të cilat në shumë edhe kanë bërë punë të mira shumë të mira dhe që nuk janë afirmuar sa duhet. Ndoshta edhe këto raste do të duheshin adresuar atje në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Gjykatën Evropiane edhe të segmenteve tjera, nëse konsiderohet më e përshtatshme, dhe në këtë mënyrë të sigurohet, jo që të imponohet ndarja...

(Ndërprerje nga regjia)

(Mbledhjen e merr nën drejtim kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Me gjithë respektin për të gjithë nënshkruesit e propozimit për të debatuar lidhur me rastin “Kiçina”, si dhe respektin për 52 mijë qytetarë të theksuar në propozim, unë mendoj që ne si deputetë të Kuvendit duhet të angazhohemi dhe ta japim kontributin tonë maksimal në respektimin dhe pacenueshmërinë e Kushtetutës të Republikës së Kosovës, mbi bazën e së cilës është themeluar edhe ky Kuvend, por edhe jemi zgjedhur ne si deputetë dhe veprojmë në kuadër të Kuvendit.

Në rastin konkret, unë mendoj se ne duhet ta kemi parasysh nenin 102 të Kushtetutës së Kosovës, respektivisht paragrafët 2 deri në 5 të saj. Sipas këtij neni, pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik, i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në

gjykatë. Madje, në këtë nen theksohet se gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit.

Kurse në paragrafin 5 garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, si dhe e drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Duke pasur parasysh këto dispozita të Kushtetutës sonë, mendoj se çdo qytetar i Kosovës, pavarësisht llojit të procedurës gjyqësore, ka të drejtë në shfrytëzimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike, me qëllim të atakimit të çdo vendimi të gjykatës, që pala e konsideron si të padrejtë.

Në anën tjetër, Kushtetuta jonë garanton që pushteti ynë gjyqësor është i pavarur. Andaj, ne si deputetë nuk është mirë që të debatojmë, e aq më keq të formojmë komisione parlamentare, që do të merreshin me çështje të caktuara gjyqësore, pavarësisht se për çfarë lënde bëhet fjalë.

Pa u lëshuar fare në vendimin e gjykatës, të cilin jam i bindur se shumica e deputetëve në këtë seancë, por edhe të atyre që e kanë nënshkruar, përfshirë këtu edhe mua, nuk e kemi parë fare. Unë mendoj se palët e përfshira në lëndë mund të këshillohen për shfrytëzimin e të gjitha mjeteve juridike, të garantuara me ligje dhe Kushtetutë, por assesi nuk bën që të krijojmë precedent, duke formuar komision, i cili do të merrej me këtë çështje.

Madje-madje, edhe vetë ky debat në këtë seancë dhe natyra e tij nuk është i pranueshëm për vendet demokratike, respektivisht për vendet ku sundon ligji, sepse konsiderohet se është ndërhyrje e politikës, apo ndërhyrje e një shtylle të pushtetit në shtyllën tjetër, së cilës gjithkund në botë i garantohet pavarësia, e ajo është shtylla e pushtetit gjyqësor.

Unë i përmenda vendet e demokracisë dhe vendet ku sundon ligji, i bindur se edhe atje gjykatat bëjnë lëshime, apo gabime të caktuara, qoftë në mungesë të provave, qoftë për shkak të vlerësimit të gabuar të provave, qoftë për shkak të shtrembërimit apo manipulimit me prova, apo madje edhe nga pakujdesia, apo edhe me dashje.

Madje, edhe gjykatat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që njihet si djep i demokracisë, ka raste të shumta kur kanë gabuar. Kanë dënuar dhe madje kanë vuajtur burgun persona të pafajshëm me vite të tëra, për çka të dënuarit e pafajshëm, apo ndryshe thënë viktimat e gjyqësorit janë kompensuar me miliona e miliona dollarë, por nuk ka ndodhur që organet e tyre ligjvënëse apo ekzekutive të ndërhyjnë në vlerësimin e vendimeve të Gjyqësorit.

Përveç kësaj, nëse ky Kuvend e aprovon propozimin për formimin e një komisioni duhet të jemi të vetëdijshëm se do ta hapim një derë, në të cilën do të dëshirojnë të kalojnë një numër i madh i personave të dënuar të rasteve të ndryshme penale, duke u thirrur në pakënaqësinë që do të kenë ndaj punës dhe vendimeve të gjykatave. Në këtë mënyrë, ne do të kontribuonim që t'i nëpërkëmben gjykatat tona, me punën e të cilave edhe ashtu nuk jemi të kënaqur as ne si deputetë, por as qytetarët tanë, të cilët janë palë të shpeshta në procedurat e zhvilluara nga ato. Faleminderit!

KRYETARI: Diskutuesi i fundit, deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do të merrem sot me Fadil Syleviqin si administrator i këtij procesi, sepse kolegu i nderuar Lladrovci foli mjaft për këtë, por është me rëndësi që edhe ky Kuvend ta identifikoj tutorin apo tutorët e tij, sepse zbardhja e së vërtetës në rastin “Hajra”, një krim monstruoze, i dënuar nga të gjithë, është obligim i drejtësisë, jo vetëm për të dënuarit të cilët mbahen të pafajshëm sot në burgjet e Kosovës, por zbardhja e rastit “Hajra”, në këtë rast edhe e së vërtetës në rastin “Kiçina”, fillon komploti i organizuar kundër pjesëtarëve të UÇK-së dhe vazhdon pastaj edhe me “Grupin e Llapit”, edhe me rastet “Limaj” e “Haradinaj”.

Të nderuar kolegë deputetë,

Rastin “Kiçina” sot unë do ta trajtoj në dy segmente tjera.

Nën një, nga barazia para ligjit dhe gjykimin e barabartë për të gjithë dhe, nën dy, me institucionin e vërtetimit të pafajësisë për të shpallur fajtorë me vendim përfundimtar institucioni që nuk ekziston te ne.

Sa i përket çështjes së parë, bazuar në Kushtetutën dhe në Kodin Penal të Kosovës, të gjithë qytetarëve duhet t’u ofrohet trajtim i barabartë para ligjit dhe gjykim i barabartë.

Duke e ditur se Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për shërbime juridike falas tek vitin e kaluar dhe duke e ditur se gjendja ekonomike e të akuzuarve në kohën e hetimit dhe gjykimin ishte e dobët dhe vazhdon të mbetet ende e dobët, dhe duke e ditur se mungesa e Ligjit për shërbime juridike falas në atë kohë dhe pamundësi për t’ua afuar këto shërbime të hetuarve dhe pastaj të akuzuarve dhe të dënuarve, dhe gjithsesi duke e ditur edhe mundësinë e institucionit të akuzës, i cili ka pasur mjete materiale të bollshme në dispozicion, duke krijuar kështu një favor para gjykatës, konsideroj që në fillim të këtij procesi kemi të bëjmë me pabarazi para ligjit dhe gjykim të pabarabartë.

Shihet qartë se të akuzuarit e rastit “Kiçina” dhe institucioni i akuzës nuk janë të barabartë para ligjit dhe para gjykatës, sepse institucioni i akuzës kishte në dispozicion të gjitha mjetet e mundshme, kurse të akuzuarit nuk kishin mjete as për t’i paguar avokatët. Dhe, në pamundësi të pagesës së avokatëve dhe mungesës së Ligjit për shërbime juridike falas për këtë, në shumicën e rasteve në këtë proces të akuzuarit janë intervistuar pa praninë e avokatëve dhe kjo është shkelje procedurale për një gjykim të drejtë, të barabartë dhe të paanshëm.

Duke mos dashur në asnjë rast që të ndërhyj në vendimet e Gjyqësorit, dua që këtë çështje ta trajtoj edhe në segmentin e vërtetimit të pafajësisë, pas shpalljes së vendimit përfundimtar.

Kodi Penal i Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale parasheh dëshmimin e fajësisë së të akuzuarve dhe procedurat deri në shpalljen përfundimtare të individit si i fajshëm, apo i pafajshëm. Por, nuk ka asnjë procedurë kontestimore kur dikush shpallet i fajshëm për ta vërtetuar pafajësinë e tij, bazuar në testimet shkencore, në këtë rast analizat e ADN-së.

Kjo duke u bazuar në shumë raste të njohura në botë, ku të shpallurit fajtorë kanë mbajtur vite e vite burgim, e më pas është vërtetuar pafajësia e tyre.

Në vendet me demokraci të zhvilluar dhe me sisteme të pavarur të drejtësisë, ku të gjitha procedurat hetimore e gjyqësore respektohen, prapë janë themeluar organizata jo fitimprurës, të cilat merren me vërtetimin e pafajësisë së të burgosurve të shpallur fajtorë për vepra penale të rënda.

Një e tillë që merret me këtë çështje është shkolla për drejtësinë në universitetin ‘Benjamin Kardoza’ në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila në vitin 1992 e ka themeluar institutin e vërtetimit të pafajësisë për t’i ndihmuar të burgosurit, të cilët mund të provohen të pafajshëm nëpërmjet testimit të ADN-së.

Në ueb-sajtin e këtij institucioni thuhet se prej vitit 1992 e deri më tani kanë trajtuar mbi 300 raste për vërtetimin e pafajësisë së të dënuarve dhe kanë arritur që ta vërtetojnë pafajësinë e tyre nëpërmjet testit të ADN-së dhe lirojnë nga burgu shumë të pafajshëm, me një mesatare të qëndrimit në burg të tyre prej 13 vjetësh.

Pas aplikimit të analizave shkencore të testimit të ADN-së, në Amerikë dhe në vendet tjera në botë, në Angli dhe Gjetiu, janë me qindra raste kur është vërtetuar pafajësia e të dënuarve.

Joni Williams është një i burgosur i shpallur fajtor për vepër penale në vitin 2006. Ai i shkroi këtij institucioni një letër, në të cilën tha se ishte i pafajshëm. “Ju lutem, më ndihmoni, unë nuk jam i shtrirë”. Pas kësaj letrë të Joni Williams, avokatët e projektit për vërtetimin e pafajësisë morën autorizime për ta provuar pafajësinë dhe në bazë të testit të AND-së u vërtetua pafajësia e tij.

Pas lirimit, Williams kishte deklaruar: “Unë kurrë nuk kam qenë i çmendur për ta shkaktuar një veprim të tillë. Kam qëndruar në besimin, në të vërtetën dhe në Perëndinë, duke ditur që e vërteta do të dalë në shesh, herët a vonë”. Dhe, jam i bindur që edhe në rastin “Hajra”, dhe në rastin “Kuçina”, e vërteta do të dalë në shesh, herët a vonë.

Pas lirimit, Williams tha se nuk është zemëruar në ata që dëshmuan kundër tij gjatë gjyqimit, por kërkoi nga policia dhe organet e prokurorisë së hetuesisë që t’i gjejnë fajtorët e vërtetë, e mendoj që edhe në rastin “Kuçina” është më se e nevojshme që të gjenden fajtorët e vërtetë. Raste të ngjashme të vërtetimit të pafajësisë ka shumë, si ai i “Konjus” - Dobre Junior, i cili u vërtetua i pafajshëm pas 30 vjetësh burgim në Amerikë, apo ai Sean Olson, ku Gjykata Britanike e Apelit e ka konsideruar të pafajshëm, pasi ai i ka kryer 27 vjet burgim.

Oslon u dënua në vitin 1982 si fajtor për vrasjen e një vajze 22-vjeçare, akuzë të cilën ai kurrë nuk e ka marrë përsipër dhe e ka mohuar, dhe pas 27 vjetësh burgim, ai është liruar.

Bazuar në këtë, konsideroj se edhe në Kosovë, të paktën në kuadër të Agjencisë për Shërbime Juridike Falas, duhet të krijohet një institucion jofitimprurës, i cili do ta ketë të drejtën që, pas ofrimit të fakteve, të parashtojë kërkesën për vërtetimin e pafajësisë në institucionet e drejtësisë. Dhe, kjo jo vetëm për rastin “Kiçina”, por një institucion i tillë duhet të krijohet edhe për raste të tjera të ngjashme, kurdo të jetë i nevojshëm vërtetimi i pafajësisë të të dënuarve me vepër penale të rëndë.

Dhe, mendoj se kjo është rruga ligjore dhe e vetme për t’i zbardhur rastet e tilla dhe vërtetimin e pafajësisë të të dënuarve në raste të ngjashme, si rasti “Kiçina”, pa ndërhyrje në organet e drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi të tjerët të paraqitur për diskutim. Të pranishëm janë 48 deputetë. Nëse jeni dakord, e vazhdojmë në orën 14:00.

Urdhëro. Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dëshiroj që edhe një herë t’i kërkoj falje publike familjes Hajra për humbjen e të cilëve ndiej keqardhje që po e përmendim rastin në fjalë dhe po u shkaktojmë edhe një herë dhimbje, por fokusi është te padrejtësia e shkaktuar të dënuarve, ndaj të cilëve konsiderojmë se janë shkelur të drejtat e tyre.

Përveç fakteve që përmenda në fjalën hyrëse, dua të bëj të ditur një fakt të ri sot para jush. Ja ku e kam në dorë një dokument nga faktet e reja, i cili është fshehur dhe zhdurur qëllimisht për procesin gjyqësor dhe këtë do t’ia jap Sekretarisë. Është një mendim i dalë nga memorandum i Zyrës Ndërlidhëse, i datës 9 tetor 2007, i drejtuar nga prokurori ndërkombëtar, zoti Andria..., me numër të referencës 2985672/07, drejtuar gjyqtarit ndërkombëtar, zoti Frederik Hellinarin, nëpërmjet gjyqtarit tjetër ndërkombëtar, Beneton Gordiari, në të cilin, në mes tjerash, thuhet:

“Në mbledhjen tonë, paneli i anëtarëve të Prokurorisë, datë 27 shtator 2007, e aprovoi rekomandimin për rigjykimin e çështjes, kompetencë e Gjykatës së Gjilanit. Anëtarët e Prokurorisë e aprovuan këtë rekomandim sipas fakteve dhe sipas rastit të kësaj çështjeje. Paneli i anëtarëve të Prokurorisë i propozoi panelit të gjykatës, të përbërë prej pesë anëtarëve për aprovimin e këtij rekomandimi për rastin “Kiçina” dhe të tjerët.

Data e panelit gjyqësor 26 tetor 2007, ora 10:00, Ndërtesa e Gjykatës Supreme Prishtinë, rasti numër 2985672/07. Faleminderit për vëmendjen e kësaj çështjeje!”, shkruan në mes tjerash në rekomandimin e dalë nga memorandum i këtij paneli.

Tani sapo jua prezantova një nga provat e reja dhe pas aprovimit të protokollit të këtij vendimi të panelit të përbërë nga prokurorët ndërkombëtarë ndodhi të zhduket faqja në librin e protokollit dhe bashkë me të edhe vendimi për rigjykim.

Të nderuar deputetë,

Gjykata tha se humbja e fakteve gjithmonë është në dobi të të akuzuarve. Sigurisht se do të pajtoheshia edhe unë me këtë fakt, sikur këta të akuzuar të mos dënoheshin maksimalisht, të tre të parët me nga 30 vjet burg, dënim ky maksimal në Kosovë; i katërti Jeton Kiçina me 16 vjet burg, edhe pse ky shtetas suedez erdhi vullnetarisht ta dëshmojë të vërtetën, si edhe 11 vjet burg për Blerim Kiçinën, të vetakuzuar sipas deklaratës së 4 dhe 7 korrikut 2002, edhe pse e tërhoqi atë deklaratë më 11 tetor 2002 para gjykatësit hetues.

Për të jua vërtetuar edhe një herë shkeljet e të drejtave të lirive të njeriut, po ja u sjell shembullin se Blerim Kiçina, edhe pse i dënuar dhe dënimi është përmbaruar nga të gjitha gjykatat, ai po mbahet padrejtësisht tash e 11 vjet në Burgun hetues të Gjilanit.

Dhe, konstatimi më i mirë për vlerësimet e shumta gjatë zbatimit a moszbatimit të procedurave hetimore, shkelje këto të cilat janë konstatuar edhe me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, e cila deri më tani ka anuluar më shumë se 200 raste të ngjashme të vendimeve të gjykatave tona, pas shterimit të debatit rreth rastit “Kiçina”, unë si parashtrues i kërkesës për debat, i nënshkruar nga grupi prej 85 deputetëve, i paraqesim seancës për miratim rekomandimin si vijon:

- Kuvendi i Kosovës ta formojë Komisionin ad hoc për t’i vlerësuar pretendimet e parashtruesve të kësaj kërkesë dhe të konstatojë se a ka pasur vërtet shkelje të të drejtave të njeriut, të cilat janë të garantuara bazuar me nenin 5, paragrafi 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike, përkatësisht për të vlerësuar se a ka pasur shkelje procedurale në rastin “Kiçina”.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj të gjithëve që ta miratoni rekomandimin për formimin e një Komisioni ad hoc për rastin “Kiçina”. Faleminderit!

KRYETARI: Të pranishëm janë 64 deputetë.

Ju e dëgjuat propozimin për formimin e një Komisioni ad hoc. Është mirë që ne ta bëjmë pauzën, shëfat e grupeve parlamentare le të merren vesh dhe në vazhdim të seancës e miratojmë.

Në emër të Grupit, fjalën e ka deputeti Ilmi Reçica.

ILMI REÇICA: Po pajtohem kryetar, me propozimin tuaj, që pas pauzës ta votojmë ose do të vendosim çfarë të bëjmë.

KRYETARI: Pauzë pra. Në orën 14:00 vazhdojmë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Nuk e kemi numrin e duhur të deputetëve për të marrë një vendim për debatin që posa e përfunduam.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Debat parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike për muajin janar 2013, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës

Në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i LDK-së ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike për muajin janar 2013.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetin Ismet Beqiri, ta marrë fjalën në cilësinë e propozuesit të çështjes. Fjalën e ka Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Sipas kompetencave që i siguron Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, më 25 shkurt 2013, e dorëzoi kërkesën për seancë parlamentare për debat për faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë dhe njësorëve digjitalë.

Faturat për shpenzimin e energjisë elektrike për muajin janar 2013 shkaktuan valën e pakënaqësive të qytetarëve.

Këto pakënaqësi qytetarët i shprehën përmes ankesave drejtpërdrejt në adresën e KEK-ut, por edhe përmes protestave numri i të cilave po rritet me tendencë të vazhdimit dhe eskalimit.

Në përkrahje të protestave u bashkuan edhe shoqëria civile, organizata të ndryshme dhe një numër i deputetëve nga të gjitha partitë e adresuan këtë çështje në Kuvend.

Në adresën e Kuvendit arritën kërkesa dhe dokumente të ndryshme nisur nga dokumenti nga ZRRE-ja, më 12 shkurt 2012, me titullin: Raporti i monitorimit të faturave të kryera nga KEK-u, në dhjetor 2012, janar 2013, raport ky i cili u dërgua si kopje fizike dhe elektronike drejtuar deputetëve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe Qeverisë dhe Bordit të KEK-ut.

Më 13 shkurt 2013 e morëm shkresën nga KEK-u si përgjigje të KEK-ut ndaj raportit të monitorimit të dërguar përsëri në të njëjtat adresa.

Më 13 shkurt 2013 në adresën e kryetarit të Kuvendit, Kryesisë dhe kryetarëve të grupeve parlamentare erdhi letra publike nga organizatorët e protestave të qytetarëve ku kërkohej nga Kuvendi të merret me këtë çështje.

Dje, më 14 mars, morëm raportin informues për pakënaqësitë e konsumatorëve të krijuara nga faturimet e janarit 2013 nga ZRRE, dërguar një numri të madh të pranuesve, të gjithë deputetëve, Ministrisë së Zhvillimit, KEK-ut, medieve e të tjera.

Këto shkresa, letra publike, raporte monitoruese dhe informuese nga ZRRE, përgjigjet nga KEK-u, kërkesat nga qytetarët të drejtuar Kuvendit, tregojnë se kjo çështje është serioze dhe na obligojnë që t'i përgjigjemi dhe të gjejmë zgjidhje për probleme dhe ankesat e tyre.

Nga Qeveria ende nuk morëm përgjigje adekuate lidhur me këtë çështje përveç deklaratave, bile dje patëm edhe një deklaratë tallëse të ministrit të Zhvillimit Ekonomik se nuk është punë për ministri, por për ZRRE dhe se nuk kishte popull në protesta, po do njerëz tjerë, gjë e cila nuk ndihmon në zgjidhjen e problemit nga ana e ministrit.

Ndërsa në njërën anë qytetarët vazhdojnë t'i shprehin pakënaqësitë në mes të protestave të shumta që po tubojnë gjithnjë e më shumë qytetarë, në anën tjetër ka pasur raste të sulmit ndaj inkasantëve dhe punëtorëve të KEK-ut, si dhe mos pagesa të faturave. Në cilindo rast kjo kërkon një përgjigje serioze dhe institucionale.

Gabimet janë identifikuar, duhet identifikuar gjithashtu pse kanë ndodhur ato, të merren masa ndaj atyre që kanë kryer gabimet dhe të merren masa parandaluese që të mos ndodhin më këso gabimesh në të ardhmen.

Dhe në anën tjetër duhet të kuptohet që ne nuk kërkojmë heqjen e kokave apo dorëheqjen e Arben Gjukës si udhëheqës i KEK-ut, por mendojmë që është gabimi dhe problemi përtej KEK-ut, është në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Nga raporti i parë i ZRRE-së më 12 shkurt, dalin konstatime se KEK-u nuk ka raportuar parregullsi në faturim, që janë faturuar 34-36 ditë, gjë e cila automatikisht lëviz kilovatë orët e shpenzuara në bllok-tarifën e tretë nga ajo e dyta dhe janë bërë shkelje të procedurave të leximit të njësorëve. ZRRE në këtë raport rekomandon rritjen e personalit për shërbim të konsumatorëve në mënyrë që të bëhen korrigjimet në faturat vijuese. Përgjigja e KEK-ut më 13 shkurt demanton ZRRE-në dhe kërkon tërheqjen e deklaratës.

Në raportin e ZRRE-së për monitorim të faturimit nga KEK-u të dhjetorit 2012, janar 2013, jepet shpjegimi i hollësishëm për bllok-tarifat e procedurave, dalin analiza detale të llojeve dhe gabimeve dhe konkluzioneve.

Por raportin e ZRRE-së për 2012 ende ne nuk e kemi marrë, por nga raporti vjetor për 2010 dhe 2011, shihet përmirësimi i performansës së KEK-ut në funksionim, por në mes të informatave tjera shihet edhe numri i ankesave gjatë viteve.

Në vitin 2006, ka pasur krejt 33 ankesa, në 2007-ën 116, në 2008-ën 572, në 2009-ën 318, në 2010-ën 243, në 2011-ën si raportin e fundit që e kemi marrë 139, ndërsa në janarin 2013, kemi 3 mijë e 804 ankesa të cilat kanë ardhur në adresën e KEK-ut.

Numri i ankesave këtë vit është gati 30-fish më i lartë e në ndërkohë numri i konsumatorëve nuk e ka përcjell numrin e ankesave.

Pakënaqësitë e qytetarëve kategorizohen në gabimin e leximit të njësorëve, zhvendosjen e tarifës së lirë në kohë kur është e pamundur të përdoret në amvisëri si dhe në vendosjen e njësorëve elektronikë.

Disa nga pyetjet ishte edhe çka bëhet me njësorët elektromekanikë të vjetër të cilët i kanë paguar konsumatorët dhe të cilët janë zëvendësuar me ata të rinj digjitalë. Është shtruar edhe pagesa, domethënë, ka mendime që në fakt pagesa e shtrenjtë bëhet për t'i kompensuar edhe ata të cilët fare nuk paguajnë.

Thuhet se për janar janë faturuar 10 milionë euro më shumë, por për këtë shifër të saktë duhet të kërkojmë përgjigjen pikërisht prej KEK-ut dhe prej Qeverisë, shifër kjo e cila është afër me vlerën e projektit të blerjes së njësorëve digjitalë si për çudi.

Bile, ministri i Zhvillimit Ekonomik, zoti Beqaj, dje në seancë na shpjegoi për vendimin e ZRRE-së për t'i zëvendësuar njësorët elektromekanikë me ata digjitalë me ç'rast blerja e tyre është kryer në mars 2012.

Ndërsa përfundimi i privatizimit të rrjetit është bërë në nëntor 2012, pra 6 muaj pas blerjes.

Sipas ministrit për njësorë digjitalë janë shpenzuar 4,4 milionë euro në zëvendësimin e grupeve matëse dhe 4,56 milionë në zëvendësimin e njësorëve nëpër amvisëri, njësorët më të vjetër se 40 vjet.

Nga ky kalkulim po del se projekti i njësorëve nuk ka kushtuar 8 milionë si thoshin mediet, po sipas ministrit ajo ka kushtuar afër 9 milionë.

Ndërsa, Distribucioni është shitur në nëntor, 6 muaj pas tyre për 26 milionë dhe sot vazhdon instalimi i pajisjes në formë të njësorëve digjitalë, projekt i cili sipas ministrit ka kushtua 9 milionë euro.

A ka edhe ndonjë obligim tjetër deri tash të panjohur që është marrë nga Qeveria sipas kontratës së privatizimit, apo do të dalin ato më vonë si befasi ashtu qysh doli kjo puna e faturave?

Me fjalë të tjera nuk është i vetmi problem KEK-u dhe leximi i njësorëve, por problem janë politikat qeveritare nisur nga shitja e aseteve dhe reflektimi i këtyre politikave në fryrjen e faturave, vazhdon me mungesën e alternativave të ofruara për zëvendësimin e ngrohjes me rrymë, me alternativa ashtu si është projekti i kogjenerimit i përdorimit të lëndëve tjera dhe mundësimit që qytetarët të shpenzojnë më pak energji.

Këto dhe shumë pyetje kërkojnë zgjidhje dhe funksionim të shtetit dhe të institucioneve ashtu si është kërkuar prej deputetëve, por e njëjta është kërkuar edhe prej qytetarëve, prej konsumatorëve të energjisë elektrike të qytetarëve të Kosovës në mënyrë që të eliminohet nevoja e zgjidhjes së problemit përmes protestave, të largimit të spekulimeve si dhe sulmeve dhe rrahjeve të punëtorëve të KEK-ut.

Andaj, ne si iniciues të këtij debati propozojmë:

Rekomandimi i parë. Të formohet Komisioni Parlamentar ad hoc, i mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 77.1 dhe sipas Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 71.2 dhe pika 4.

2. Komisioni sipas kompetencave që i sigurojnë Kushtetuta dhe Rregullorja, t'i analizojë zhvillimet dhe procedurat rreth zhvillimeve të lartpërmendura.

3. Komisioni të përgatisë raportin dhe të gjithë të gjeturat t'ia dorëzojë Kuvendit për diskutim brenda afatit 3 javor nga data e formimit të tij.

Për plotësimin e rekomandimeve mund të dakordohemi të bisedojmë edhe me grupet tjera parlamentare. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: E ka fjalën ministri Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Ministër,

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mendoj që është një mundësi jashtëzakonisht e mirë që të debatojmë sot për problemin i cili ka zgjuar gjatë këtyre ditëve shumë debate, vlerësime të cilat kanë ardhur si shqetësim i qytetarëve me shumë të drejtë për një problem çfarëdo qoftë ai mbi faturim apo edhe gabimet të cilat kanë ndodhur.

Në këtë kontest mendoj që është një mundësi jashtëzakonisht e mirë që ne t'u shpjegojmë deputetëve dhe dua ta falënderoj deputeten për ftesën e këtij debati dhe qytetarëve se Qeveria e Kosovës, në kundërt të kompetencave të veta ka marrë të gjitha masat e duhura deri më tani, të cilat janë të sanksionuara me bazën ligjore dhe kompetencat të cilat i ka Qeveria si aksionare në ndërmarrjet publike.

Dua të theksoj se Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përfaqësuese e aksionarit në ndërmarrjet publike dhe si e tillë krijon politika zhvillimore për sektorin energjetik, por

nuk merret në asnjë rrethanë në menaxhim të drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve. Respektivisht, çështja e kohës së faturimeve, çështja e tarifave, çështja e bllok- tarifave janë në mënyrë të drejtpërdrejtë kompetencë e Zyrës së Rregullatorit për Energji, i cili aprovon planin e investimeve për KEK-un, në të gjitha investimet të cilat ata i specifikojnë një nga një dhe kjo bëhet një herë në vit, për të gjitha investimet të cilat parashihen.

Dhe, Ministria e Zhvillimit Ekonomik as Qeveria nuk kanë kompetenca mbi Zyrën e Rregullatorit. Dua të them që unë do të jem i gatshëm t'i përgjigjem secilës pyetje veç e veç për kompetencat e mia të cilat i kam dhe në emër të Qeverisë të përgjigjem, por dua të bëjë të qartë që sa i përket kohës së faturimit, përcaktimit të datave të faturimit, ditëve të faturimit, të gjitha janë vendime të Zyrës së Rregullatorit dhe Rregullatori është dashur të vijë sikurse ka ardhur dje me një raport të qartë.

Për hir të opinionit dhe qytetarëve dhe atë që ka marrë apo nuk ka marrë veprime Ministria e Zhvillimit Ekonomik, dua të jua përkujtoj një kronologji se çka ka ndodhur.

Më datën 11 shkurt 2013, unë kam themeluar një komision ndërministror duke parë shqetësimin e qytetarëve dhe në këtë komision ministror kanë qenë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, e cila ka pasur dy njësi, Njësia që merret me vlerësimin teknik të njësorëve, respektivisht njësia tjetër e cila ka të bëjë me mbrojtjen e konsumatorëve. Ka qenë pjesë Shoqata e Konsumatorëve, Ministria e Zhvillimit Ekonomikë dhe Zyra e Rregullatorit, të cilët kanë pasur për bazë monitorimin e procesit të rishikimit të ankesave. Këta kanë bërë një përzgjedhje të mostrave, ku përzgjedhja e mostrave është bërë nga Shoqata e Konsumatorëve, nga zoti Selatin Kaçaniku dhe nga këto mostra kanë dalë se ka gabime teknike. Konform këtij raporti, Komisioni i ministrave për ndërmarrjet publike, sepse ministri i Zhvillimit Ekonomik nuk merr vendime në mënyrë të drejtpërdrejtë për ndërmarrjet publike, por është një komision për ndërmarrjet publike, i cili i përfshin 5 ministra dhe i cili i ka rekomandua bordit që të marrë masat adekuate të cilat kanë rezultuar në masat të cilat janë konsideruar nga ana e KEK-ut si masa adekuate. Por, ne nuk i kemi dhënë vetes të drejtë të hyjmë dhe të merremi me menaxhim dhe të caktojmë se kush duhet të përgjigjet për çka.

Në ndërkohë, kemi kërkuar që asnjë qytetar i cili ka deponuar ankesë, të mos shkyçet, respektivisht kemi bërë ftesë që gjithë qytetarët të cilët kanë çfarëdolloj problemi, çfarëdolloj shqetësimi, të shkojnë në sportelet e KEK-ut dhe të dorëzojnë ankesat e tyre duke pasur parasysh që ne jemi të interesuar në mënyrë maksimale që asnjë qytetar edhe për një euro nëse është, të mos jetë i mbingarkuar për një proces të tillë.

Më datën 15 shkurt kemi marrë raportin dhe i cili ka konstatuar që ka gabime në disa sfera dhe në bazë të kësaj ka pasur veprime konkrete nga ana e KEK-ut për largimin, respektivisht suspendimin e disa zyrtarëve.

Më datën 28 shkurt, Ministria e Zhvillimit Ekonomik në cilësinë e kryesuesit të Komisionit të ministrave për ndërmarrje, ka trajtuar edhe një herë gjendjen e krijuar dhe ka rekomanduar bordin që të hartojë një raport të detajuar lidhur me masat të cilat bordi i

ka marrë, të mos bëjë edhe një herë shköputjen e asnjë konsumatori i cili ka deponuar ankesë dhe të kërkohë nga zyrtarët e KEK-ut që sanimi i gjendjes, respektivisht të përgatitet që gjithë atyre që janë mbingarkuar t'u kthehen mjetet e tyre. Pra, ne kemi kërkuar që edhe nëse një euro është mbingarkuar, ajo duhet të kthehet.

Më 1 mars 2013, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, respektivisht Komisioni për ndërmarrje publike i ministrave, ka marrë një letër nga kryesuesi i bordit, i cili realisht shpjegon se ka udhëzuar menaxhmentin që duhet të marrin masa shtesë për shkak se pesha e gabimeve nuk është e mjaftueshme me masa të cilat janë marrë. Dhe kjo ka rezultuar në bazë të ankesave të cilat kanë qenë kryesisht në distriktin e Prishtinës, me veprime konkrete nga ana e menaxhmentit dhe suspendimin e njerëzve deri në hartimin e plotë të raportit, të informatave të cilat duhet të merren.

Më datën 5 mars, unë kam marrë nga Bordi i Drejtorëve informatën për masën të cilat janë marrë.

Ndërsa, më datën 13 mars, duke parë që ankesat e qytetarëve janë edhe më tutje të nivelit të lartë, unë kam kërkuar me shkrim nga Zyra e Rregullatorit për Energji, të vijë me një konstatim se duke marrë parasysh se Rregullatori është ai i cili e mbikëqyr, e licencon dhe bën përcaktimin e blloqeve tarifore, respektivisht kohës kur duhet të lexohen orët, të ma sjell një informatë të saktë e cila na thotë se ka pasur apo nuk ka pasur shkelje menaxheriale, ka pasur apo nuk ka pasur gabime të tilla. Dhe, unë dje në mbrëmje sikurse ju që e keni marrë e kam marrë një raport të tillë, një raport i cili konstaton se ka pasur shkelje, i cili konstaton se këto shkelje janë bërë për shkak se nuk është menaxhuar situata mirë, i cili konstaton se ka gabime në lexim të njësorëve, i cili konstaton se është bërë gabim në rastin e ndërrimit të njësorëve edhe pse janë bërë faturime të dyanshme dhe i cili për mua ka qenë argument i mjaftueshëm profesional, institucional që të marrë masa të niveleve më të larta. Pra, unë nuk kam dashur në asnjë moment dhe mua më vjen mirë që deputetja tha që ne nuk jemi këtu për të kërkuar kokat e njerëzve, kam dashur që të sigurohem në mënyrë kronologjike, në bazë ligjore nga institucionet të cilat janë kompetente për monitorimin e funksionimit të KEK-ut.

Dua t'ua bëj me dije edhe njëherë qytetarëve që çmimet e energjisë, tarifat e energjisë, koha e leximit të orëve përcaktohet nga Rregullatori, investimet edhe për ndryshimin e njësorëve përcaktohen nga Rregullatori dhe unë nuk kam dashtë të marrë masa, sepse nuk ma lejon ligji me marrë masa përderisa nuk kam konfirmim të qartë nga ana e Rregullatorit se ka pasur shkelje dhe këtë raport e kam marrë dje në mbrëmje.

Njëkohësisht, unë kam kërkuar nga Rregullatori, në letrën time të datës 13, që ta rishikojë procesin e bllok- tarifave, sepse një pjesë e gabimeve të cilat kanë ndodhur janë për shkak të bllok- tarifave të cilat janë përcaktuar nga Rregullatori dhe vonesa në lexim ka qenë ajo e cila qytetarët i kanë mbingarkuar me kilovatë për një periudhë të caktuar dhe realisht bllok-tarifa i ka futur në çmime më të larta.

Dhe, unë kam kërkuar, realisht kam sugjeruar, sepse nuk është në kompetencën time të kërkohë nga Zyra e Rregullatorit, kam kërkuar që Rregullatori të fillojë një proces për të

rishikuar këto bllok-tarifa dhe kanë vënë në dispozicion Ministrinë me tërë potencialin tonë që të marrë masa në këtë proces.

Duke marrë parasysh se raporti është ai të cilin e keni marrë ju, të cilin unë e kam marrë sot edhe në mënyrë zyrtare si ministër, pra shkresë zyrtare jo vetëm raport informues, sepse unë kam kërkuar nga Rregullatori, jo raport informues, pra kam kërkuar që jo të kem raport informues, por kam kërkuar të kem dokument zyrtar i cili konstaton a ka pasur apo nuk ka pasur gabime dhe këtë e kam marrë sot me shkrim.

Në kuadër të kësaj kërkesë unë sot kam ftuar Komisionin ndërministror për ndërmarrje publike, me cilin jemi takuar në orën 11:30 dhe mbi raportin e Rregullatorit, ne kemi marrë vendim që të kërkojmë nga Bordi i KEK-ut shkarkimin e drejtorit ekzekutiv të KEK-ut dhe këtë po e them jo për shkak të asnjë të pakënaqësie që ka ndodhur, sepse nuk kemi dashur të marrim vendim në bazë ad hoc, por ky vendim merret mbi vendimin, respektivisht konstatimin e drejtpërdrejtë të institucionit i cili e mbikëqyr KEK-un nga aspekti i realizimit të detyrave të veta a ka kryer apo nuk ka kryer, a ka pasur apo s'ka pasur gabime?

Dhe për qytetarët ky Rregullator ka konstatuar se ka shkelje dhe mbi konstatimin që ka bërë Rregullatori dje pasdite, ne kemi marrë masa të duhura dhe kemi kërkuar nga bordi, sepse ne nuk kemi kompetencë prapë për të shkarkuar drejtorë, por Komisioni Ndërministror ka kërkesë, ka kompetencë ligjore të kërkojë nga bordi i KEK-ut, i cili është përfaqësues i aksionarit, që të shkarkojë drejtorin ekzekutiv për shkak të mos menaxhimit të situatave dhe nganjëherë, po e them me plot të drejtë edhe nga qasja jo shumë korrekte dhe unë dua t'u kërkoj falje qytetarëve nga qasja jo korrekte e cila ka ndodhur nga KEK-u, sepse ka qenë një arrogancë, e cila në mënyrë të vërtetë e ka denigruar raportin e qytetarit në raport me institucionin e vet.

Por po e them ne nuk kemi pasur mundësi të marrim masa konkrete pa pasur raport kredibil, i cili na ka mundësuar që ne të marrim në bazë të asaj që Rregullatori ka konstatuar se ka shkelje, ndërsa nga këndvështrimi ynë si Ministri e Zhvillimit Ekonomik, ne kemi konstatua se bordi, respektivisht drejtori nuk i ka respektuar dhe nuk i ka qar në vend detyrat fiduciare të cilat i ka bordi, respektivisht drejtori menaxhues i KEK-ut.

Këto janë vendime të cilat janë marrë dhe janë marrë po them në bazë procedurale. Ne nuk kemi dashur të marrim vendime të cilat janë në bazë ad hoc të situatave, por kemi dashur që të kemi të dokumentuar secilin atë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë i kisha lutur deputetët i kanë 10 minuta debat dhe debatin le ta përmbyllin brenda 10 minutave. Unë mendoj që 10 minuta mjaftojnë për t'i thënë ato që duhet thënë.

Fillojmë me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Mirë atëherë fjalën unë po ja japë deputetes Justina Shiroka-Pula.

JUSTIN SHIROKA-PULA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Ministra, deputetë,
Diskutimi rreth problemit të faturave gabim me ose pa qëllim nga KEK-u është një
çështje shumë e rëndësishme.

Nuk mund të neglizhohet joefikasiteti i inkasantëve në leximin e orëve dhe evidentimin e
shfrytëzimit të mbi 600 kilovatë orë të shpenzuara në tarifë të lartë.

Nuk është e arsyeshme të ndëshkohen inkasantët dhe mos të merren në përgjegjësi
menaxherët dhe nivelet më të larta që lejuan mosefikasitetin në menaxhim, sidomos në
periudhën e dimrit, në periudhën e tarifave të larta.

Mirëpo, mendoj se ky problem i ka rrënjët në një përpjekje dhe edukatë tashmë të krijuar
brenda KEK-ut dhe në disa institucione tjera që ta bëjnë rrjetin e shpërndarjes dhe
furnizimin sa më fitimprurës për investitorin privat.

Është momenti që ta analizojmë seriozisht dhe në tërësi gjendjen dhe arsyen pse kemi
arritur në këtë situatë pakënaqësie popullore dhe të marrim qëndrim ndoshta edhe për tërë
procesin e privatizimit.

Prej fillimit po shpreh indinjatën për këtë privatizim të distribucionit dhe furnizimit që
është model jo i mirë i privatizimit në dëm të konsumatorëve, pra, një privatizim ndoshta
më i keq se ai i Ferronikelit. Në atë kohë i falën resurset e Ferronikelit dhe tani po falim
rrjetin energjetik, infrastrukturën bile me koston shtesë të rritjes së tarifave në mënyrë
drastike brenda 2-3 vjetëve.

Me këto procese dhe transaksione jemi duke i treguar investitorëve serioz privatë,
përfshirë edhe ata evropian dhe amerikanë se Kosova dhe asetet e asaj nuk vlejnë, se në
Kosovë nuk ka kuadro profesional, Kosova nuk ka vizion dhe nuk strategji zhvillimore.

Në strategjinë e energjisë 2009-2018 janë përfshirë dy arsye që duhet të angazhohet
sektori privat, në sektorin e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, konkretisht.

1. Për të investuar në rrjet, ashtu që cilësia e shërbimeve të furnizimi të arrijë në norma
evropiane të humbjeve teknike, si dhe
2. Për ta përmirësuar menaxhimin e furnizimit, ashtu që të ulen në normat e lejuara
humbjet komerciale.

Me kontratën e privatizimit parashihet që investitori do të investojë 300 milionë për 15
vjet në zvogëlimin e humbjeve teknike, që nënkupton investimin prej 20 milionë në vit.

Vlerën prej 20 milionë do ta paguajë konsumatori përmes rritjes së çmimeve të energjisë.

Prandaj, kjo situatë e krijuar është shkalla e parë e rritjes së vlerës së faturës dhe përgatitja psikologjike e opinionit për faturat që do t'i kenë prej momentit të bartjes së distribucionit në duart e privatit.

Edhe pas privatizimit importin e energjisë do ta subvencionojë Qeveria, nëse jo, atëherë ZRRE-ja do të detyrohet të rrisë çmimin e energjisë për konsumatorët edhe për këtë shërbim.

ZRRE-ja që e ka ndjekur procesin e privatizimit duhet të mbajë përgjegjësi direkt pse është dakorduar në këtë privatizim dhe nuk ka bërë të qartë për popullin dhe konsumatorët, pasojat e tij që do të shprehen direkt në tarifë.

ZRRE-ja duhet të kishte të qartë planin e detajuar të investimeve private që aktualisht nuk ekziston.

Vetë ZRRE-ja në raportin për tarifat deklaroi se pret nga investitori të paraqesë planin e investimeve që ta miratojë. Bëhet pyetja, nëse investitori privat paraqet një plan investimesh të cilat do të fillojnë pas 3-4 vjetësh e jo menjëherë, do të bëjë ZRRE-ja, do t'i heqë licencën KECIT, privatit, me siguri këtë vendim nuk do ta ketë guxim ta marrë siç nuk ka pasur guxim ta luajë rolin që i takon gjatë negociatave për privatizim si dhe me pjesëmarrjen e Komitetit të ministrave dhe këshilltarëve ndërkombëtarë.

Do të bëjë ZRRE-ja kur të shohë se menaxheri i huaj privat do të paguhet rreth 100 mijë dollarë ose më shumë në muaj, por kur të shohë se menaxhmenti i huaj do të paguhet në total shumë miliona euro në vit.

Po, nëse në planin e investimeve të KECIT, privati mund të kërkojë që investimet të kthehen mjaftë shpejtë nëpërmjet tarifave. Pra, tarifat gati do të dyfishohen brenda pak vitesh.

Cila është përgjegjësia e ZRRE-së, që është rregullatori për t'i mbrojtur interesat e qytetarëve konsumatorë?

A mund të na thotë ZRRE-ja dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik se sa për qind fitim janë dakorduar që t'i marrë investitori privatë? Po nëse kërkesa nga privati do të jetë 20 deri në 30% si do të zgjidhej kjo kërkesë? Kush e paguan këtë çmim të lartë të energjisë? Me siguri që popullata jo, sepse nuk ka.

Sipas ekonomisë ndërkombëtare të tregut, çmimi i energjisë duhet të ngritet dhe do të ngritet, por ekonomia e tregut ka kuptim kur ka fuqi blerëse të konsumatorëve dhe në këtë ekonomi shteti afron mekanizma dhe instrumente tjera përkatëse për jetë dhe për punë.

Por në Kosovë në këtë nivel të ardhurave mesatare dhe në nivel të lartë të papunësisë, pra me një rritje ekonomike shumë të ulët, ekonomia e tregut ka humbur komplet logjikën dhe kuptimin.

Pra, kjo situatë e krijuar na tregon se është momenti më i mirë që të ndalet procesi i privatizimit të Distribucionit dhe të analizohen në detaje dhe në mënyrë analitike pasojat të cilat do të vijnë me ngritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Jo shumë vonë do të shohim dështimin dhe shtimin e pakënaqësive dhe ata që e bëjnë këtë privatizim do të pendohen, por do të jetë vonë.

Puna është se sot nuk e dimë se si do të ndahet përgjegjësi për një proces të tillë privatizimi të paqartë dhe të kryer në kohën më të papërshtatshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë,

Të nderuar ministra,

Lidhja Demokratike e ka shqyrtuar këtë problematikë dhe është bartëse me kërkesë për këtë mocion.

Deputetja Teuta i prezantoi qëndrimet përgjithësisht, unë do të flas për disa nuanca tjera të cilat nuk u thanë.

Po debatojmë për një artikull, i cili është artikull monopol, nuk e rregullon tregu, sepse nuk ka konkurrencë, është njëburimor.

Dhe jo vetëm energjia, por edhe shërbimet tjera të cilat janë njëburimore, është krejt normale që shteti duhet t'i ketë mekanizmat e vet që e rregullojnë menaxhimin dhe mënyrën e veprimit duke nxjerr akte ligjore, nënligjore në trajtimin e atyre temave.

Në këtë kuptim, shoqëria e Kosovës ka një ministri që quhet Ministria për Zhvillim dhe brenda asaj e kemi një departament që quhet Departamenti për Monitorim, pra ka objektiv monitorimin e kompanive publike sa dhe si vepron brenda kornizës të dispozitave ligjore të përcaktuara.

Te ky artikull, te ky mall që thashë se nuk i nënshtrohet ligjeve të tregut e kemi edhe Zyrën e Rregullatorit të Energjisë që përmes akteve të veçanta rregullon mënyrën e trajtimit të këtij malli në raport me konsumatorin.

Është evidente se në këtë drejtim ne shohim një neglizhencë të Ministrisë për Zhvillim, gjegjësisht Njësisë Monitoruese.

Në një nga raportet e Auditorit të Përgjithshëm kur flet për Ministrinë e Zhvillimit, thotë se nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje vjetore aksionare, në mbledhje në të cilat shqyrtohen politikat, jepen direktiva, jepen rekomandime dhe përcillen zbatimet e atyre rekomandimeve.

Ministri paska ndërmarrë disa veprime që mua më pëlqyen, por krejt këto kur i ka marrë i paska marrë prej datës 13, do të thotë kur kanë dalë njerëzit në rrugë. Ne e shohim përgjegjësinë direkt që lidhet me ministrin dhe Qeverinë.

Te ky artikull në Kosovë ka edhe disa specifika. Kosova ka energji në termo kryesisht dhe atë e ka në sisteme të mëdha që ka qenë kur janë ndërtuar të dizajnuar me sistemet hidro në nivel Jugosllavie.

Kosova nga viti 2000, pra unë po e marrë nga pavarësia, sepse përpara të tjerët kanë sunduar, e dini që ka qenë Këshilli Ekonomik Fiskal dhe ai ka vënë parametrat, prandaj mund t'i akuzojmë njerëzit si të dom, por përgjegjësinë e kemi prej shpalljes së pavarësisë, neglizhenca e Qeverisë që të ndërmarrë hapa që Kosova të mos jetë në këtë nivel të prodhimit dhe konsumit, sepse të jem i qartë, në çdo fazë konsumi dhe prodhimi te energjia duhet të jenë të harmonizuar, nëse nuk janë të harmonizuar do të shkaktosh problemin në tregun regjional dhe do të marrësh sanksione. Çka nënkupton kjo? Kosova gjatë ditës disa herë shet rrymë dhe blen rrymë. Për fat të keq e shet shumë lirë ose edhe me gjoba dhe e blen me çmim shumë të shtrenjtë, për shkak të strukturës që e ka që e thashë se është një sistem i trashëguar.

A ka mund Qeveria diçka të bëjë? Ka mund të bëjë edhe unë mendoj se të gjithë ata të cilët e kanë neglizhuar dhe po e neglizhojnë, qoftë këtu, qoftë në Shqipëri, mosrealizimin e projektit 400-voltësh, po e bëjnë një shërbim të shkëlqyeshëm Serbisë dhe po e dëmtojnë ekonominë e Kosovës edhe të Shqipërisë. Pse e them këtë? Shqipëria kryesisht e ka energjinë në hidro, ne kryesisht e kemi në termo, një kombinim i tillë do të mundësonte që Kosova të mos blejë asnjëherë rrymë, sepse kapacitetet prodhuese tona janë më të vogla se prodhimi në çdo fazë. Prandaj, përmes huadhënies dhe huamarrjes do t'i ikshim të gjitha këtyre, do të thotë është një përgjegjësi e Qeverisë që në prioritet nuk e ka trajtuar çështjen e energjetikës mbi këtë bazë.

Problemet i kemi edhe te Zyra e Energjisë. Ju lutem. të gjitha shtrenjtimit edhe shtrenjtimi që po parashihet, Zyra i planifikon të ndodhin në fund të periudhës dimërore, që konsumatori të mos e vërej rritjen e çmimit. Kjo është përdorimi i profesionit në aspektin negativ.

Kjo është një politikë që pa zhurmë në një mënyrë të bëjë shtrenjtimin e rrymës. Shtrenjtimi i rrymës nënkupton shtrenjtimin e kostos të jetës, sepse e ke në të gjitha produktet. Prandaj, çdo shtrenjtim nuk duhet ta përcjellim me periudha, me faza po duhet ta trajtojmë me raportin e gjithëmbarshtëm, me koston e jetës, me mundësinë blerëse e tjera e tjera, ka shumë faktorë që duhet trajtuar. A ka ndodhur diçka e tillë, nuk ka ndodhur?

Pastaj, nga informacionet që kam unë Zyra ka ngritur disa standarde në nivelin e konsumit ku i trajton me çmime të ndryshëm, 200 vatë, 600 dhe mbi 600.

Ju lutem kjo është në kundërshtim me rregullat dhe rregullat e tregut në trajtim, kjo është abeçe-ja. Blerësi që blen sasi më të madhe duhet ta marrë më lirë jo më shtrenjtë dhe këto

norma që janë caktuar, e kuptoj për shkak të mungesës së rrymës, megjithatë distribucioni i çmimeve është shumë i lartë.

Vetë ekzistenca e këtyre parimeve ku i lihet që familja duhet të ketë maksimalisht ta zëmë 600, i lënë mundësinë që operimi mund të ndodhë edhe në aspektin subjektiv, ia lenë 2-3 ditë këtij muaji pa kalkuluar dhe i kalkulon muajin tjetër dhe gjithsesi e ka kaluar 600 ku trajtohet me një çmim tjetër, do të thotë, duhet të kemi rregulla strikte, kur duhet të lexohen, dhe për mua krejt e palogjikshme ekzistimi i këtyre fazave.

Ndërsa sa i përket atij raportit me të lirë dhe të shtrenjtë që kryesisht të lirë e ke natën, ajo është për shkak të dizajneve të mëdha, formës së rrymës do të thotë që e kem vetëm në termo dhe po të lidhet me 400-voltëshin edhe ajo logjikë do të bjerë.

Të kthehem krejt te problemi, po të kishte qenë Qeveria në këtë rast Ministria për Zhvillim dhe Njësia Monitoruese, agjil të veprojë në impuls me problemet që kanë lindur gjatë periudhës, se këto probleme nuk janë të momentit, këto janë probleme edhe të trashëguara, por megjithatë kjo Qeveri kur e ka marrë këtë çështje është dashur këto çështje t'i trajtojë dhe po të kishte pasur takime më të shpeshta do t'i kishte këto reagime, nuk do ta prite datën 13 dhe ta shohë tash mos ta elaboroj me një rast në kohën e diferencimeve të hershme, ishte nisur një delegacion të shkojë në një shkollë atje në një katund, rrugës me një xhip, e gjejnë, një kalimtar e marrin, prej nga je, i filan katundit, thotë - çka punon, thotë - në shkollë jam kurir edhe ndërkohë po e pyet - thotë ku po shkoni thotë me, po shkojmë ta bëjmë diferencimin në shkollë, thotë e paskam hëngër unë i shkreti. Në këtë rast e paska hëngër Arben Gjuka, jo, jo zoti ministër nëse ka përgjegjësi je ti. Dhe unë në emër të Grupit ta kërkoj dorëheqjen se është momenti, mos pastë kurrëgjë është momenti shumë moral që t'i në këtë rast duhet të japësh dorëheqje. Përpos fakteve që thasë, nuk e ke mbajtur asnjë takim si pronar i atyre aseteve, asnjë takim vjetor të aksionarëve nuk i ke mbajtur. Ky nuk është konstatim i imi, ky është konstatim i Auditorit të Përgjithshëm që në raport ta ka...

Prandaj, këto veprime të ishin marrë sikur se i paskeni marrë disa nga ato, unë besoj që nuk ish ardhur deri te kjo, prandaj, paraqitja e juaj dje para në atë mënyrë është çështje juaja, por nuk ka shkuar në funksion të qetësimit të situatës në arsyetimin e problemeve, sepse po shihet se ju vetë e thatë se paska probleme, se ato probleme qenkan të arsyeshme e tjera e tjera, dje këto nuk i thatë, por folët me një gjuhë krejt tjetër. Prandaj, këtu është një përgjegjësi politike, morale, më në fund të fundit edhe funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", fjalën e ka kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

U thanë shumë gjëra për sa i përket edhe këtij aspektit teknik pra problemit të aty për atyshëm shumë që kemi pasur me faturat e dhjetorit, pastaj të janarit po edhe për një lloj të them nënshtratis të politikave dhe vendimeve që rrjedhin edhe nga Qeveria që e ka ndikuar këtë rritje të çmimit.

Unë në fjalën time natyrisht do ta bëj një përmbledhje të asaj se si e shohim ne këtë problematikë nga këto dy aspekte që janë evidente, të dyja të vërteta.

Pra, nga aspekti i faturave të janarit tashmë është bërë më duket e qartë për të gjithë që aty ka pasur keqpërdorime, qoftë të qëllimshme apo të rastësishme dhe këto keqpërdorime kanë ndikuar që këto fatura të jenë më të larta se sa që është dashur të jenë. Pra, vetë fatura nëse krahasohen muajt e dimrit, shihet që ka në disa raste natyrisht, ka fryrje të madhe të faturës, domethënë nëse dallimi prej dhjetorit në janar, gjë që e ka shtyrë një pjesë të konsiderueshme të konsumatorëve që të ankohen dhe të protestojnë për këtë çështje dhe kjo vjen edhe siç e ka shpjeguar edhe KEK-u për shkak të kohës në të cilën është bërë leximi i shpenzimeve. Pra, në dhjetor janë hequr disa ditë në fillim të vitit për shkak të leximit të muajit nëntor i cili është bërë më 1 dhjetor, për shkak të festave të fundit të nëntorit.

Dhe në anën tjetër po ashtu muaji dhjetor ka përfunduar për KEK-un më herët, pra është lexuar më herët për shkak të festave të fund vitit dhe këto ditë kanë kaluar pastaj në muajin janar, gjë që i ka rritur ditët në muajin janar, dhe këto ndryshime të ditëve dhe shpenzimeve të energjisë elektrike në këta muaj kanë rezultuar që kur të dalin në muajin tjetër, domethënë nëse shpenzimet e dhjetorit llogariten si shpenzime të janarit, atëherë automatikisht ato kanë kaluar në bllokun e tretë tariforë, pra në atë të shtrenjtin mbi 600 kilovat dhe kështu është llogaritur padrejtësisht në një bllok tarifor të cilit në muajin paraprak kur është bërë shpenzimi nuk i ka takuar. Pra, kjo është mendoj një keqpërdorim i cili është bërë në të gjitha këto fatura.

E dimë që janë disa faktorë që e përcaktojnë këtë shtrenjtim apo çmimin e energjisë elektrike të cilat i merr Zyra e Rregullatorit të Energjisë për bazë, pra prej atyre që janë prej kosos operative te kostoja e mirëmbajtjes, te çmimi i importit të energjisë elektrike dhe po ashtu edhe kostoja kapitale. Pra, të gjitha këto merren parasysh në një farë mënyre kur ZRRE-ja e merr një vendim për rritjen apo për formësimin më mirë të them të çmimit të energjisë elektrike.

Dhe në këtë drejtim konsiderojmë që të gjitha këto apo propozimet për këto vijnë nga kompania apo jo. Pra, edhe në pyetjen e djeshme që ja kam bërë ministrit ka qenë kjo pikërisht që kompania i bën kërkesat në ZRRE dhe natyrisht pastaj ZRRE-ja vendos nëse do t'i pranojë ato, po me këto kërkesa kompania dëshiron që ta dëshmojë kërkesën e vet për rritje të çmimit të energjisë elektrike duke e arsyetuar atë me këto investime që duhet t'i bëjë, pastaj me koston operative që e llogarit që do t'i kushtojë për vitin e kështu me radhë.

Mua çka po më duket interesante në këtë raportin që e ka sjell ZRRE-ja, pra askund nuk përmendet të paktën të na jepet një shifër e aseteve të kompanisë për distribuim, të cilat do të duhej të ishin pjesë përbërëse e dokumentacionit të kësaj kompanie kur këta aplikojnë për rritjen apo zvogëlimin e energjisë elektrike. Pra, nuk e dimë ne se sa do të kishte me qenë kostoja operative dhe kostoja e mirëmbajtjes për shkak se nuk e dimë vlerën e gjithëmbarshme të aseteve, të cilat do të mirëmbahen. Dhe këto informata besoj i ka ZRRE-ja, do të duhej t'i kishte për shkak se edhe në vendimin për privatizim të kësaj

kompanie është dashur ta ketë këtë dokumentacion që ta di të paktën ZRRE-ja se ne nuk po e dimë se çfarë ka vendosur Qeveria të shesë dhe në këtë arsyetim që na e ka sjellë neve për çmimin e energjisë elektrike duke pasur parasysh që kjo është një komponentë e rëndësishme në formësimin e këtij çmimi, atëherë është dashur neve si deputetë të na informoj për gjendjen reale dhe asetet e kësaj kompanie në të cilën e ka bazuar kalkulimin pastaj të kostos së mirëmbajtjes e cila do ta formësonte çmimin.

Dhe në këtë drejtim vendimi përfundimtar i ZRRE-së, natyrisht bazohet edhe në të hyrat e lejuara për kompaninë duke u bazuar në këto komponentë dhe në të gjitha këto komponentë ne e shohim që Qeveria e Kosovës ka mundësi të ketë ndikim me qenë se është qind për qind aksionare kompanisë. Tash ministri tha që nuk ka pasur ndikim, mbase edhe nuk ka pasur, nuk ka dashur të marrë ndikim.

Pra, siç e dëgjuam edhe nga zoti Sadriu, ky s'paska takuar kur aksionarët, rrjedhimisht ka qenë plotësisht i pa interesuar për kompaninë, por mendojmë që Qeveria e ka një përgjegjësi të kujdesit ndaj kësaj kompanie me qenë se është kompani publike dhe me Ligjin për ndërmarrje publike Qeveria është qind për qind aksionare.

Dhe në këtë drejtim Qeveria po duket se nuk ka bërë asgjë deri sa është bërë kjo puna e çmimit e madhe.

Po unë dua të ndalem pak në çështjen në ndërlidhjen dhe këtu mendoj që është drejtpërsëdrejti përgjegjësia e Qeverisë, natyrisht është te politikat e Qeverisë për energjinë elektrike edhe çmimi i energjisë elektrike, për shkak se kjo është shumë e rëndësishme.

Siç e përmendi edhe deputetja Pula, me shumë të drejtë privatizimi drejtpërsëdrejti është i lidhur me nivelin e çmimit të energjisë elektrike dhe këtë e kemi parë në praktikën në të gjitha vendet, veçanërisht në vendet në rajon dhe kjo po ndodh edhe këtu në Kosovë. Mirëpo këtu po ndodhë paraprakisht për shkak se po i shtrohet një farë mënyrë terreni që kompanisë private mos t'i duhet të aplikojë për shumë shpesh për rritje të energjisë elektrike për shkak se një pjesë të kësaj rritjes po ia kryejnë tash kompania e cila planifikohet të kalojë në pronësi private në maj, po që është ende publike.

Pra, nuk është e rastësishme, sipas mendimit tim, se si në Kosovë, vetë kohëve të fundit i kemi një rritje të çmimit të energjisë elektrike për 8.9% që ka ndodhur në qershor të vitit të kaluar, pra në momentin kur Qeveria vendosi për kompaninë fituese të tenderit për privatizimin e rrjetit dhe një tjetër e cila po na kanoset po them ashtu si qytetar po na kanoset të ndodhë në javën e ardhshme apo në fillim të muajit të ardhshëm në prill, kur planifikohet që energjia elektrike të rritet për 10 apo 11%, sipas paralajmërimeve që i ka dhënë Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Pra, për një kohë kah të gjatë nuk ka pasur rritje të energjisë elektrike dhe tash befasisht përbrenda një periudhe për pak më shumë se 8 muaj, i kemi dy rritje enorme të energjisë elektrike.

Njëra prej kërkesave kryesore që vjen nga investitorët e huaj për investime në energji është që çmimi të jetë atraktiv për ta, por kjo është një lloj rregulle që e përdorin të gjithë ata që i besojnë verbërisht teorisë të liberalizimit dhe privatizimit në mënyrë që kompanitë e interesuara për të investuar në një vend në kapacitetet energjike, ata donë që ta kenë një çmim të energjisë prej të cilës sigurojnë një profit të kënaqshëm. Dhe, në këtë drejtim konsideroj që politikat e Qeverisë janë drejtpërsëdrejti ndikuese në rritjen e energjisë elektrike për shkak se e dimë që politikat e kësaj Qeverie janë që sektorin e energjisë tërësisht ta privatizojmë, pra jo vetëm shpërndarjen e furnizimin, por ta privatizojnë edhe gjenerimin, gjë që do të shkaktojë edhe një kërkesë për rritje më të madhe të energjisë elektrike.

Pra, në këtë drejtim konsiderojmë që të diskutojmë sot vetëm për rritjen e energjisë elektrike, apo për faturat e janarit, pa e ndjekur edhe pa e problematizuar edhe këtë çështje, ose arsyen kryesore pse ndodhin këto rritje, është e mangët, edhe pse shumë e dëshirueshme, ne e përkrahim Komisionin ad hoc, të propozuar për ta hetuar këtë çështje.

Mirëpo, konsiderojmë që është shumë e rëndësishme që ky Komision ta shtrijë fushëveprimin e vet edhe ta ndjekë të paktën mundësinë e ndërlidhjes mes politikave privatizuese të Qeverisë së Kosovës dhe nivelin e çmimit për energji elektrike që e paguajnë qytetarët e Kosovës.

Po ashtu unë kisha dashur një pyetje t'ia shtrojë ZRRE-së edhe pse nuk janë këtu po përmes këtij debati që të na e shpjegoj pak më mirë se si kanë ardhur deri te ky blloku tarifor dhe deri në çfarë masa ata e konsiderojnë këtë bllok tarifor, në njërën anë të drejtë dhe në anën tjetër, funksional. Për shkak se ky 600-kilovatëshi që është te kufiri i epërm i blloqeve tarife për muajt e dimrit ku ne e dimë se një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve të Kosovës e përdorin energjinë elektrike për ngrohje për shkak se nuk kanë mundësi tjera, ky 600-kilovatëshi nuk është asgjë. Pra, është një sasi tejet e vogël e kilovatëve të energjisë elektrike për t'i përmbushur nevojat elementare. Dhe këtu në shpjegimin që na ka dhënë ZRRE-ja shihet që blloku i parë tarifor është ai që është menduar të jetë, domethënë, përmbushje e nevojave elementare të energjisë elektrike, ndërkohë që për muajt e dimrit ky 600-kilovatëshi nuk është fare as për së afërmi i saj. Në vendet e rajonit e kanë këtë shumë më të lart, për shembull ka vende që e kanë 1600 kilovatshin, ka vende që e kanë mbi 1300 e kështu me radhë, domethënë, ka dallime po asnjë vend nuk e ka 600-in.

Dhe në anën tjetër duhet ta konsiderojmë edhe një çështje që është shumë e rëndësishme që çmimi i energjisë elektrike në politikat publike të Kosovës nuk duhet të ndikohet nga nevoja e investitorëve, por nga mundësia e qytetarëve për ta paguar atë. Për shkak se e dimë që edhe me këtë çmim që e kemi tash shumica e qytetarëve po kanë problem ta paguajnë. Paramendoje nesër kur të kemi rritje të reja se një pjesë e konsiderueshme e amvisërive dhe po ashtu prodhuesit e vegjël, nuk do ta kenë thjeshtë mundësinë që ta paguajnë energjinë elektrike dhe si të tillë do të detyrohen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po filloj t'i citoj disa thënie të ministrit. Ministri tha: Gabimet të cilat kanë ndodhur, unë ju them - Si i quani gabime ministër hajnitë që po u bëhen vazhdimisht konsumatorëve. E keni kërkuar një komision ndërministror. Çfarë u bë me ankesat e qytetarëve? Vërejtje se ka gabime teknike. Keni kërkuar që qytetarët të mos shkyçen. Unë ju them se kjo nuk është e vërtetë. Ata vazhdimisht po shkyçen. Nga këto gabime teknike janë larguar njerëz të pafajshëm nga puna. Keni kërkuar që të mos ngarkohen me asnjë euro ngarkesë tepër qytetarët. Unë ju them jo me një euro, por me 200 deri 300% është ngarkesa që u është bërë qytetarëve tanë.

Zyra e Rregullatorit ka konstatuar se gabimet me rastin e ndërrimit të njësorëve janë shkelje, por unë ju them që këto gabime nuk kanë ndodhur vetëm për ndërrim të njësorëve, sepse ka fatura të stërngarkuara edhe aty ku nuk janë ndërruar njësorët. Dhe, ministër, krejt fjala e juaj përmbledhet kështu: Ka pasur gabime teknike, nuk kemi kompetencë. A keni pasur kompetencë, ministër, kur keni nënshkruar për ta falë për 26 milionë euro Divizionin e Shpërndarjes dhe Furnizimit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndodhi që në Kosovë, vlera e shitjes së Divizionit të Shpërndarjes dhe Furnizimit për 26 milionë euro të jetë sa një faturë mujore. Sot në vendin tonë faturohet 60-65% të energjisë. Kjo është e papranueshme, me gjithë premtimet e vazhdueshme të Qeverisë dhe menaxhmentit të KEK-ut se do të investohet në rivitalizimin e Rrjetit dhe aseteve tjera, rrjetit i cili është skajshmërisht i dobët gjithandej vendit tonë, sidomos nëpër zonat rurale.

Si pasojë e kësaj, jo rrallëherë ndodh që qytetarët, apo më mirë të themi konsumatorët, të mbeten edhe me ditë e me javë të tëra pa energji elektrike. Për këtë, askush nuk e çan kokën. Po si mund të ndodhë një gjë e tillë edhe 14 vjet pas përfundimit të luftës? Ku janë milionat që u investuan vazhdimisht në këtë korporatë? A nuk duhet që dikush të japë llogari për këto keqmenaxhime në vazhdimësi, të cilat s'do mend se po bien mbi kurrizin, edhe ashtu të thyer të konsumatorit. Si mund të pritet përmirësimi i gjendjes në këto dy dikastere të KEK-ut, kur dihet se konsulencat e vazhdueshme ndërkombëtare, edhe investimet e pafund, nuk e kanë rritur eficiencën, përkundrazi e kanë zvogëluar atë. Asnjëherë nuk është dhënë përgjegjësi për dështimin e dhjetëra milionave investime, por as për faktin se me gjithë konsulencat e shumta ndërkombëtare, rezultatet në punë nuk u përmirësuan. Si është e mundur që edhe më tutje faturohet vetëm 60-65% e energjisë? E edhe më tutje abuzohet me njësorët. Deri më tani, menaxhmenti vendor servil i konsulentëve të dështuar përdori shumë forma për përmirësimin e rezultateve, që vazhdimisht shkonin në dëm të konsumatorit. Veç analizojini faturat. Secila është e ngarkuar me 2,27 euro tarifë fikse. Kjo vërtet është e pakuptimtë dhe e papranueshme.

Minimizohet numri i faturave zero, duke u ngarkuar me kilovatë të pashpenzuar nga konsumatorët, vetëm e vetëm për ta ngritur shkallën e faturimit, zvogëlim fiktiv i

humbjeve. Largohen punëtorët nga puna për të mospërbushje të planit të inkasimit sipas një rregulloreje interne të KEK-ut, ndërsa përgjegjësit kryesorë, si menaxhment vendor servil dhe konsulent të dështuar, janë të paprekshëm. Mirëpo, këta duhet të japin përgjegjësi dhe, edhe pas shumë viteve, nuk po mund t'i përmirësojnë rezultatet ashtu që këto dy divizione, pra ai i Shpërndarjes dhe i Furnizimit, të veprojnë në mënyrë rentabile.

Një gjë e tillë po dëshmohet çdo ditë me gabime të pafalshme të këtij menaxhmenti, gabime të cilat po bien drejtpërdrejt në kurrizin e konsumatorëve, pra të qytetarëve tanë. Dhe, krejt në fund, i them ministrit: nga gabimet që ju po i quani teknike, unë ju kisha thënë sot bëjeni një veprim teknik - dhe jepni dorëheqje.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetarja e Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh se sot kemi temë diskutimi debatin e kërkuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës për faturat e energjisë elektrike për muajin janar 2013, mund të them se si Kuvend i Kosovës dhe si deputet të Kuvendit të Kosovës mund të diskutojmë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, të cilat i kemi të miratuara në Kuvendin e Kosovës. Në rast se e shohim Kushtetutën e Republikës së Kosovës si aktin më të lartë të shtetit, mund të themi se ndërmarrjet publike janë nën menaxhim të politikave të Qeverisë së Kosovës, dhe në këtë rast i kemi bordet, të cilat menaxhojnë me ndërmarrje publike dhe pronësia e ndërmarrjeve publike është në pronësi të Qeverisë së Kosovës.

Çfarë ndodh me çështjen e faturimit në muajin janar të vitit 2013? Duhet të jemi transparentë para qytetarëve të Kosovës se ky gabim që ka ndodhur në janar të vitit 2013, ka ndodhur edhe në tri vitet paraprake. Po ju them shumë sinjerisht. E njëjta situatë ka ndodhur edhe në tri vitet paraprake nga kompania e quajtur KEK dhe qytetarët e Kosovës tash janë duke u përballur me një krizë më të madhe ekonomike dhe çështja e tyre tash është shumë më e ndjeshme, e për këtë arsye kemi hasur në protestat, të cilat janë zhvilluar përpara kësaj ndërmarrjeje. KEK-u duhet t'ia shtrojë një pyetje vetes sesi është kjo kompani duke funksionuar me menaxhmentin e vet, kur e di mjaft mirë se subvencionet i merr po nga Buxheti i Kosovës, e ky buxhet mblidhet nga taksat e qytetarëve të Kosovës.

Që ta kemi një faturim të mirë dhe të kemi një inkasim të mirë, menaxhmenti i KEK-ut pikësepari duhet t'i zvogëlojë humbjet dhe me zvogëlimin e humbjeve, edhe çështja e Zyrës së Rregullatorit për ngritjen e tarifave të energjisë elektrike duhet të jetë më e vogël. Ju them shumë sinjerisht se Zyra e Rregullatorit të Energjisë funksionon në bazë të Ligjit të Zyrës së Rregullatorit, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe kjo zyrë i përgjigjet direkt Kuvendit të Kosovës dhe fatbardhësisht mbrëmë ka dalë me një raport, në të cilin thotë mjaft qartë se KEK-u apo inkasantët kanë gabuar, se në këtë rast është menaxhmenti i KEK-ut. Nuk mund t'i quajmë inkasantët gabues, se menaxhmenti i KEK-ut e ka obligim, i di tarifat muaj për muaj, cili konsumator apo cili qytetar i

Kosovës ka harxhuar për një muaj dhe t'i faturohet ajo energji elektrike. E kur dihet mjaft mirë se në tarifat e dimrit, u theksua këtu edhe nga kolegët, për harxhimin mbi 600 kilovatë energji elektrike, çmimi kalon shumë 10,16 centë, atëherë sa i vjen në fund të muajit një konsumatori që të paguajë. Dhe, ky është gabimi. Gabimi është te menaxhmenti.

Këtu e tregoi ministri Beqaj, që tani nuk është këtu, që ka kërkuar nga Bordi që të shkarkohet drejtori menaxhues. Unë kërkoj nga ministri, jo të shkarkohet drejtori menaxhues, por të shkarkohet edhe Bordi i KEK-ut, dhe Qeveria të ketë politika të qarta në sektorin e energjisë dhe kur politikat e qarta në sektorin të energjisë të bëhen në favor të qytetarëve, atëherë edhe ministri duhet të jetë shumë i qartë para qytetarëve të Kosovës.

Rekomandimi im është që Zyra e Rregullatorit, së bashku me Qeverinë dhe Bordin, në rast se e lënë atë bord, ose e ndryshon atë bord, që t'i zvogëlojë humbjet. Me zvogëlimin e humbjeve, në bazë të plan-biznesit që e kanë, atëherë edhe unë ju them këtu në fjalën publike, se nuk do të ketë ngritje shumë të madhe të çmimit të energjisë, për arsye se një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës nuk paguajnë energji elektrike dhe ne e dimë kush janë ata qytetarë të Kosovës dhe një pjesë e madhe e tyre e keqpërdorin energjinë elektrike. E këtu është problemi që ata qytetarë që e paguajnë energjinë elektrike, paguajnë edhe për ata qytetarë që nuk e paguajnë dhe ende e kemi planin ABC, të vendosur po nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, e cila ndëshkon edhe atë konsumator në rast se e ka një fqinj, i cili nuk e paguan energji elektrike dhe futet në grupin C. E çka?

Ne si Kuvend, besoj edhe deputetët e partive tjera politike që janë këtu, duhet të kërkojmë nga ministri që në mënyrë urgjente të bëhen politika e sakta në sektorin e energjisë, çfarë duam të sigurojmë sektorin e energjisë.

Nën dy, nëpërmjet ligjit të ndërmarrjeve publike, ministri e ka njësinë për monitorimin e ndërmarrjeve publike dhe e kemi pasur raportin e ndërmarrjeve publike në komision parlamentar dhe tash shumë shpejt pritet të dal në seancë plenare, të dihet performansa e KEK-ut dhe aty të jepet llogari nëpërmjet kësaj njësie monitoruese. E në rast se shohim humbjet në efekt të KEK-ut në të holla mund të themi se vetëm për vitin 2012, për mos zvogëlimin e humbjeve, KEK-u ka arritur që të ketë humbje deri në 4 milionë euro dhe kjo mundësi është shfrytëzuar në mënyrë të gabueshme ndaj konsumatorëve dhe konsumatorët janë ndarë të pakënaqur me faturat e janarit 2013.

Ne nuk mund ta kërkojmë nga ministri çështjen e faturimit për arsye se ministri nuk e bën e faturimin. Çështjen e faturimit e bën KEK-u dhe unë prapë kërkoj edhe nga Bordi, edhe nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, si mbikëqyrës i KEK-ut, që të japë raporte strikte dhe të thotë se këtu janë diku 980 ankesa të konsumatorëve, që janë reale, që do të thotë se gabimi është shumë i madh. Nuk është 1, 2 a 3%, por është mbi 10%. Dhe, kjo përgjegjësi duhet të etiketohet te ata njerëz ku e kanë përgjegjësinë. Ministri udhëheq me politikat energjetike, ndërsa me çështjen e menaxhmentit, e thashë edhe një herë, në bazë të Ligjit të ndërmarrjeve publike, është njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike, bordet e ndërmarrjeve publike dhe fatbardhësisht ministri tregoi që drejtori ekzekutiv ka

shkuar në shtëpi. Ai është vetëm një ngarkesë e vogël për të shkuar në shtëpi. Duhet të japë llogari publike se çfarë ka ndodhur me ato të holla të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poštovane dame i gospodo poslanici,

Ako je suditi po iznosima računa za utrošenu električne energiju koje su potrošači dobili, stanovnicima Kosova prestoni period mraka, jer su januarski računi u trostručni, u odnosu na decembarski. Kada trebamo govoriti o ovako osetljivoj temi, kao što su računi za struju, koji samo... kompanije KEK, moramo biti kritični i reći da je KEK jedno monopolitičko preduzeće koja u ovom trenutku, najblaže rečeno, vrši torturu nad svojim potrošačima, u vidu velikih računa, kao i samovolje radnika na terenu.

Kao poslanik, izražavam svoju zabrinutost, ne samo što se tiče iznosa na računima, već je moja zabrinutost mnogo veća zbog statističkih podataka, dok od 7 500 zaposlenih u kompaniji KEK, imamo 25 zaposlenih Srba. To je najblaže rečeno nedopustivo, i mislim da se taj odnos mora promeniti, kako bi se moglo ispuniti zakonske norme od najmanje 10% zaposlenih koji dolaze iz Srpske zajednice. Tako da sve ovo što je govorio ministar za žalbe građana, još sve ostale informacije koji građani i potrošači moraju da imaju, u srpskim sredinama nisu to imali. Takođe još jednom u nizu mojih zabrinutosti je fiktivni stari dug koji postoji u koloni na računu, a koji smo kao predstavnici svog naroda morali da prihvatimo 2009. godine, kako bi smo mogli da potpišemo kolektivne ugovore, koji su nas uveli kao redovne potrošače u kompaniji KEK.

Kada smo to potpisali, izrazili smo svoju zabrinutost i svoje nezadovoljstvo zbog fiktivnog starog duga, koji se pojavio u koloni i koji iznosi 1 500, 3 500 pa čak i više do 15 000 evra. U zavisnosti od raspoloženja nekog koje je od oka ocenio da je neko potrošio toliko, ali tada smo dobili uveravanje od strane predstavnika KEK-a, kao i međunarodnih predstavnika, koji su tada bili menadžeri u KEK-u, da će stari dug kao kategorija na računu biti izbrisan nakon dve godine, ukoliko potrošači redovno izmiru svoje obaveze.

Poštovano gospodo poslanici,

To se upravo nije dogodilo, iako su potrošači redovo izmirivali svoje obaveze, tako da je procenat naplate preko 95%, ali umesto potpisivanja duga po dogovoru, sada Kosovska energetska korporacija upozorava svoje potrošače da ukoliko žele da i dalje koriste njihove usluge, moraju da plate taj stari dug, inače će biti isključeni sa mreže, ili će biti predati u nadležnost suda.

Poštovana gospodo poslanici,

Sada ću vam izneti jedan podatak iz 2009. godine. Od 800 domaćinstava koji žive u tri sela koje su tada pripadale opštini Lipljane, iznos dogovaranje za stari dug bio je 1 320 900 hiljada evra, što je nezamislivo da je moglo da se plati tada i danas. Da bi smo to još bolje malo razjasnili i naše nezadovoljstvo opravdali od oka na pisanih računa, moramo

uzeti u obzir da smo u vremenu od 2000. do 2009. godine, imali takve restrikcije, koji su išli do te mere da smo imali dnevno 3.-4. sata struju, a ostatak dana bez struje. Dali samo zbog samih restrikcija, ili zbog kvarova koji su to vreme, u tom periodu bili veoma česti.

Kao poslanik u ovom Parlamentu, postavio sam ministru za energetiku pitanja starog duga. Zašto je još aktivan stari dug, i ako potrošač u 95% izmiru svoje dugove redovno? Nisam dobio odgovor. I sada pitam: Kako će se kategorija starog duga, koji je na računima i dalje tretirati, jer ako on ostane, najviše će biti ugrožene kategorija seoskih srpskih domaćinstava, kao i socijalno ugrožene porodice. Nadam se da će ovim pregovorima, koji se vode između Prištine i Beograda, jedna od tema biti kategorija starog duga, i to bi bio jedan od načina da potrošači, koji su ovako opterećeni velikim računima za struju, izbegnu još jednon velikog nameta kojim je kompanija KEK napakovala u vidu starog duga. Nadam se da će neko reagovati ili će srpska domaćinstva, ali i sva ostala na Kosovu, kao što smo mogli da vidimo na jednom od transparenata morati da se zaduže kod neke 'kuku banke', kako bi mogle da naplate harač u vidu računa za struju. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, kryetarja e grupit Shinik e ka fjalën:

MYFERA SHINIK: Sayın Başkanım!

Kosova Elektrik Kurumunun son günlerde halkımıza karşı faturalarda elektrik enerjisi harcamalarını gerçeğin ötesinde göstermesi, bizleri ciddi bir şekilde rahatsız etmektedir.

Aslında dikkatle konuşulması gereken konu, halkımızın zor ekonomik şartları içerisinde bizim enerji miktarına ödemiş oldukları yüksek fiyattır.

Elektrik enerjisi fiyatlarının bölgede Kosovada en yüksek olduğu ve harcanan enerji miktarlarının çeşitli tarifelere ayırarak faturaların yüksek gelmesine ortam yaratmaktadır.

Bunun için tek düzen ödeme şekli düşünülmelidir.

Enerji Bakanlığı yetkililerinden bu konu üzerine gereken önlemleri almasını talep etmekteyiz.

Elektrik enerjisi kesintilerinin herkese eşit şekilde, bazı defa da minimum borcu olanın da elektriğinin kesilmesihaksızlık yaratmaktadır.

Bunun bir an önce Bakanlık ve KEK tarafından sayaçları okuyan görevlilerin zamanında okuması ve düzenli ödeme yapılması konusunda düzene koyulması gerekir.

(Mbledhjen e merr nën drejtim nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari-deputeti Jakup Krasniqi

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,

Dua t’i them nja tri çështje me këtë rast, duke qenë se Kosova është zotuar që t’i përshtatë politikat e saj të energjisë në linjë me ato të BE-së dhe meqenëse jemi nënshkrues të traktatit të komunitetit për energji, atëherë zhvillimi i mëtejme i tregut energjetik duhet të

jetë pa monopol, kushte për konkurrencë, mosdiskriminim, barazi dhe respektim të mbrojtjes së konsumatorëve.

Nëse diskutimin tim e nis edhe vetë nga ky këndvështrim, atëherë shqetësimet dhe pyetjet që shtrohen sot janë: Protestat, përmbajtja e pankartave dhe shqetësimet tjera që kanë ngritur protestuesit ditëve të fundit lidhur me faturat e muajit janar, konsideroj se janë fakte të favorshme për t'i analizuar politikat menaxhuese të KEK-ut, si dhe modelin e politikave energjetike që po aplikon Zyra e Rregullatorit për Energji. KEK-u ka mbetur i vetmi operator i gjenerimit të furnizimit me energji.

Reformimi, strukturimi, e së fundit edhe privatizimi i Rrjetit dhe i Distribucionit nuk ka krijuar kushte për eliminimin e monopolit në tregun e energjisë. Nuk ka siguruar mosdiskriminimin të konsumatorëve dhe ka penguar liberalizimin e tregut të energjisë. Mbi bazën e këtyre fakteve, shtrohen pyetjet: Pse politika aktuale energjetike në Kosovë është shmangur nga ekonomia e tregut të lirë dhe, përgjithësisht, nga politikat energjetike të BE-së? Pse nuk po vazhdohet me reformimin struktural të sektorit të energjisë dhe pse po zvarritet shfrytëzimi i burimeve alternative të energjisë?

Pa dashur t'i amnistoj gabimet e mundshme të zyrtarëve të KEK-ut gjatë procesit të leximit të faturimit, konsideroj se debati ynë nuk do të ketë efekt pa një raport nga Zyra e Rregullatorit për Energji, i cili do t'i përfshinte të gjitha çështjet që janë shkak i fryrjes së faturave të energjisë për muajin janar, ose së paku t'i kemi konstatimet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë se a ishin veprimet e KEK-ut në pajtueshmëri me kushtet e licencës? A i ka zbatuar KEK-u tarifën e rregulluar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe a i ka zbatuar KEK-u rregullat, aktet dhe vendimet e lëshuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë?

Mungesa e një raporti, i cili do të bazohej në një hetim kompetent, ashtu siç parashihet në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, jo vetëm që kanë krijuar huti në opinion, por njëkohësisht kanë ndikuar në krijimin e një imazhi të keq për KEK-un, i cili do të reflektojë me uljen e inkasimit, luhatjen e besimit të investitorët dhe, përgjithësisht, në performansën e KEK-ut. Konsideroj se kompetentët duhet të përgjigjen për këto pasoja, sanimet të cilat do të shpenzojnë shumë kohë dhe mund.

Mungesa e një debati kompetent nga institucionet përgjegjëse, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Komisioni i Konkurrencës, organizatat e konsumatorëve dhe aktorë tjerë nga shoqëria civile, përfshirë edhe Komisionin e Parlamentit, do të na sjellin vështirësi për ta nxjerrë një gjykim meritore, me arsyet e aplikimit të sistemit të tillë tarifor. Nëse e analizojmë strukturën e tarifave me pakicë të energjisë elektrike, vërehet se Zyra e Rregullatorit të Energjisë i ka vendosur në pozitë shumë diskriminuese konsumatorët e amvisërisë, në raport me konsumatorët tjerë.

Ky grup i konsumatorëve, i cili përbën 80% të numrit të përgjithshëm të konsumatorëve, është ngarkuar me dy lloj çmimesh për sezon: i lartë - i dimrit, dhe i ulët - i verës. Dy lloj çmimesh kohore: i ditës dhe i natës, dhe tri bllok-tarifa. Domethënë, faturat e këtyre konsumatorëve kanë 12 lloje të ndryshme ngarkesash A1-B1; A1-b2; A1-B3, A2-B1; A2-

B2; A2-B3, varësisht nga cila bllok-tarifë dhe cili sezon i tarifës evidentohet si shpenzues, sistemi tjetër tarifor ka dhënë mundësi për keqkuptime, gabime, por edhe për keqpërdorime. Mbi të gjitha, është në kundërshtim me kërkesat e tregut të energjisë...

(Ndërhyrje e kryesuesit: Ju lutem për qetësi, deputetë!)

...Këto janë tarifa regresive e ndëshkuese për konsumatorin dhe të cilat aplikohen vetëm këtu te ne. Diferenca në ngritjen e çmimit nga tarifa në sezonin e ulët A1, në atë të lartit A2, në të cilin regjistrohet mbi 60% e konsumit të energjisë, është për 39,8% më e lartë dhe kur kësaj i shtohet diferenca në çmim të kalimit nga blloku i tarifës B1 në bllokun tarifë B2, i cili është 27,8% dhe diferenca me çmim të kalimit nga blloku tarifor B1 me bllokun B3, i cili është 50,3% më i lartë, rrjedh se në sezonin e dimrit konsumatori i amvisërisë e paguan çmimin e energjisë elektrike përafërsisht 80% më të lartë, në krahasim me sezonin e verës.

Vlen të theksohet se në muajt e dimrit pothuajse të gjithë konsumatorët e amvisërisë shpenzojnë mbi 600 kilovat orë për një muaj energji elektrike, që bie se shumica ngarkohet me bllok-tarifën B3, e cila e bën rrymën për konsumatorët e amvisërisë me çmimin më të lartë nga 30,4-32%, në krahasim me konsumatorët industrialë dhe konsumatorët e tjerë të mëdhenj. Për procedurat jotransparente dhe jo në harmoni me ligjin për miratimin e tarifave, për çdo miratim tarifor, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka obligime ligjore të bëjë:

1. Konsultimet për çështjet që kanë të bëjnë me tarifat me të gjitha palët, t'i identifikojë çështjet, të cilat e kanë rregulluar tregun, t'i publikojë ato dhe t'u mundësojë të gjitha palëve të interesuara dhënien e komenteve para miratimit tarifor.
2. Mungesa e analizës mbi ndikimet e strukturës aktuale tarifore dhe performansa ekonomike dhe sociale, si dhe të nxjerrë efektet e dëmshme nga aplikimi i tarifave regresive për konsumatorët e amvisërisë.
3. Niveli jo i duhur i përputhshmërisë ndërmjet çmimeve dhe kostos reale të prodhimit,
4. Mosekzistimi i konkurrencës dhe i transparencës i operatorëve në tregjet e energjisë në Kosovë.

Çështje tjetër është mungesa e raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë mbi monitorimin e punës së KEK-ut, e sidomos pas rasteve të fundit duhet ta dimë se a janë shkelur kushtet e licencës?

Dy, a janë zbatuar tarifat e aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë? Dhe, tre, a janë shkelur rregullat e aktit, vendimet e lëshuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë?

Përfundimisht, do të rekomandonim që Zyra e Rregullatorit të Energjisë duhet t'i braktisë praktikën e përcaktimit të çmimit dhe tarifave pa një analizë më gjithëpërfshirëse dhe jashtë parimeve të tregut të lirë të energjisë. T'i heqë tarifat ndëshkuese, bllok-tarifat për konsumatorët e amvisërisë dhe të aprovojë sistemin tarifor, i cili do të garantonte mosdiskriminim, barazi dhe respektim të mbrojtjes së konsumatorëve.

Të vendoset një limit mbi të cilin nuk do të pranohej mbulimi i këtyre humbjeve nga konsumatori. Ka vite që KEK-u po operon me nivel të madh të humbjeve teknike dhe komerciale, mbi 38%. Secili investim që është bërë në KEK deri më tani është arsyetuar si investim për zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale dhe asnjëherë nuk kemi pasur një analizë mbi efektet e këtyre investimeve, si dhe mbi shkaqet pse ky ritëm kaq i ulët i zvogëlimit të humbjeve. Po jua përkujtoj se për keqmenaxhimin, keqshfrytëzimin e resurseve dhe nivelin jo të kënaqshëm të performancës në fund po faturohen pagesat.

Të mos ketë ngritje të çmimit të energjisë, meqenëse vitin e kaluar Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka bërë një ngritje prej 8,9%, pa TVSH, përkatësisht 9,8% me TVSH, e cila ngritje atëherë është arsyetuar si pasojë e ngritjes së rentës për thëngjill, ndonëse ngritja eventuale e çmimit të energjisë do të ishte e pajustificueshme, meqë do t'i dekurajonte investimet e jashtme në Kosovë, do ta rriste rrezikun për trazira sociale dhe përgjithësisht do t'i fuste politikën tona energjetike në antagonizëm të thellë me politikën e ekonomisë së tregut të lirë.

Të ndërpritet plani ABC i furnizimit me energji të konsumatorëve.

Unë mendoj që këto janë rekomandimet që duhet të dalin nga ky debat i organizuar për problemet në sistemin e energjisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Unë mendoj se shkarkimi i drejtorit ekzekutiv, zotit Arben Gjuka, nuk i zgjidh problemet që na janë paraqitur në sektorin energjetik. Ne sqarojmë se kjo Qeveri e ka sjellë këtë gjendje, e ka sjellë sektorin energjetik në këtë gjendje çfarë është sot. Deri më sot ka mjaft të dhëna që tregojnë se faturat e fryra nuk janë vetëm derivat i gabimeve teknike dhe leximit të orëve. Qytetarët e Kosovës po përballen me shtrenjtimin e rrymës, shtrenjtimit i cili do të vazhdojë.

Pjesa më e madhe e problemeve vjen kryesisht nga procesi i privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit të energjisë elektrike, që besoj që në mënyrën më të mirë të mundshme u elaborua pikërisht nga ish-ministrja e Energjetikës, zonja Pula.

Të nderuar deputetë,

Vitin e kaluar ka ndryshuar baza ligjore, kur është dhjetëfishuar tantiema për thëngjill, nga 26 centë në 3 euro, e për këtë besojmë që nuk është përgjegjës zoti Gjuka. Për këtë

është përgjegjës drejtpërdrejt Qeveria. Kjo nënkupton që qytetarët i paguajnë buxhetit të shtetit 3 euro për çdo ton të thëngjillit që ata nxjerrin dhe përdorin për prodhimin e energjisë elektrike. Sipas ekspertëve, ky është tatim i dyfishët për qytetarët dhe është në kundërshtim me konventat evropiane. Sipas këtyre konventave, qytetarët e paguajnë koston e shërbimeve publike që marrin nga shteti. Në rastin konkret, qytetarët duhet ta paguajnë koston e prodhimit të energjisë elektrike. Tantiema në thëngjill nuk është kosto për prodhimin e energjisë, por është taks që qytetari, nëpërmjet KEK-ut ia paguan shtetit. Përveç kësaj, qytetari paguan edhe 16% në emër të tatimit mbi vlerën e shtuar, do të thotë për shpenzimin e energjisë elektrike.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Vetëm po jua përkujtoj se në letërën dërguar Fondit Monetar Ndërkombëtar nga zotëri Thaçi, vitin e kaluar, Qeveria e Kosovës e bën të qartë se dëshiron të mbledhë rreth 6 milionë në Buxhetin e Kosovës nga qytetarët në emër të tantiemës për thëngjill gjatë vitit 2013. Pra, vendosja e kësaj takse mbi thëngjillin nga 1 janari i vitit 2013 është bërë me qëllim të mbushjes së buxhetit të shtetit. Kjo e ka shtyrë Zyrën e Rregullatorit të Energjisë që vitin e kaluar ta rrisë çmimin e energjisë për 9%. Vetëm vendosja e tantiemës e ka rritur çmimin e energjisë për 4%. Me këtë rast, ne dëshirojmë të bëjmë me dije se tantiema për thëngjill ka filluar të implementohet nga 1 janari i vitit 2013, dhe kushdo që përpiket ta thotë të kundërtën, është thjesht tentim për mashtrimin e opinionit.

Qeveria para pak ditësh ka qenë shumë e zëshme në debatin për të mos e rritur pagën minimale prej 170 eurove, por kur është fjala për ngarkesat e qytetarëve, ajo ka iniciuar ndryshimet e ligjeve dhe ka bërë shtrenjtimin e energjisë elektrike.

Lidhja Demokratike e Kosovës e shpreh shqetësimin e saj lidhur me gjendjen e mjerë të jetesës së qytetarëve të saj. Nën udhëheqjen e PDK-së dhe të Thaçit, këto ditë Kosova u rendit në mesin e 9 vendeve më të varfra në botë. Indeksi i varfërisë është një matës i përgjithësuar i gjendjes ekonomike dhe që bazohet në papunësi dhe në inflacion. Nisur nga fakti që papunësia në Kosovë është 45% dhe inflacioni 8%, indeksi i varfërisë me të drejtë e ka radhitur Kosovën në pozitën e 9-të të vendeve më të varfra në botë. Do të ishte e udhës që zyrtarët qeveritarë, duke filluar nga zotëri Beqaj, e më pas nga kryeministri Hashim Thaçi, ta marrin përgjegjësinë për mashtrimet që në vazhdimësi ua kanë bërë qytetarëve, për mashtrimin ‘24 orë furnizim me energji elektrike’.

Është shumë e vërtetë që është përmirësuar gjendja e furnizimit me energji elektrike në Prishtinë, por, të nderuar deputetë, të gjithë ne kemi familjarë, kemi farefis nëpër fshatra. Pyetni fshatrat, pyetni komunat tjera se a kanë energji 24 orë në ditë. Gjendja është e tmerrshme. Duhet ta marrin përgjegjësinë për dështimet në ngritjen e hidrocentralit të Zhurit. Edhe ky ishte një premtim i fushatës elektorale. Për dështimet në lidhje me sistemit energjetik me Shqipërinë, për dështimet në realizimin e projektit “Kosova C”. Të gjitha këto kanë qenë premtime dhe kanë qenë të parapara në strategjinë energjetike të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Do të ishte e udhës që zoti Thaçi të sqaronte para qytetarëve të Kosovës se a do të rritet çmimi pas prillit të vitit 2013, sepse diskutimet për një rritje të radhës të çmimit të energjisë elektrike veç kanë filluar. Meqenëse po bëhen përpjekje që përgjegjësia të hedhet nga Qeveria diku tjetër, unë kam edhe kërkesa të tjera. Ne si LDK kemi edhe kërkesa të tjera që mund t'u shtohen rekomandimeve që i kemi prezantuar, e që janë shumë të qëlluara.

Kërkesa apo rekomandimi numër 1, në këtë rast nga unë, do të ishte që në afat prej 2 javësh, Qeveria ta sjellë një raport për nivelin e implementimit të strategjisë 2008-2018. Në afat prej dy javësh, Qeveria të raportojë lidhur me deklaratat e International Financial Corporation, se privatizimi i Distribucionit nuk është bërë në përputhje me praktikën dhe në përputhje me ligjet në fuqi. Ne e dimë rolin që e ka pasur IFC-ja gjatë privatizimit dhe deklarime të tilla me të vërtetë vetëm sa i forcojnë dyshimet tona që kemi pasur një privatizim, i cili e ka pasur qëllimin që t'i fryjë xhepat e partiakëve dhe të individëve, e assesi të shkojë në favor të qytetarëve të Kosovës.

Në afat prej dy javëve, duhet të kërkohet që Qeveria të raportojë se përse nuk ka progres në linjën 400-voltëshe me Shqipërinë. Rëndësia e saj u elaborua më herët dhe Qeveria, në afat prej dy javëve, të raportojë lidhur me progresin për projektin "Kosova C". Për të gjitha këto, nuk është përgjegjës zotëri Gjuka, por është përgjegjës Besim Beqaj dhe Qeveria Thaçi. Me dëmtimin që i është bërë sektorit energjetik me rastin e privatizimit, krijimit të një monopoli të natyrës së vet me rastin e shitjes së furnizimit të energjisë elektrike, nuk mjafton as dorëheqja e zotit Beqaj, e as dorëheqja e zotit Thaçi, sepse do të vijjnë qeveri e qeveri dhe këtë dëm që ua kanë shkaktuar qytetarëve të Kosovës nuk do të mund askush ta riparojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Ajo çfarë po ndodhë tani me faturat për shpenzimin e energjisë është tregues për të ardhmen e çmimit të energjisë elektrike. Pra, këto fatura janë të tilla, ndër të tjera se energjia është shtrenjtuar dhe ky shtrenjtim u paraprin shtrenjtimit që do të pasojnë. Ky shtrenjtim është miratuar nga ZRRE-ja nga 1 qershori 2012 dhe i bie të jetë në të njëjtën kohë kur ndodhi edhe privatizimi i Rrjetit të Distribucionit e Furnizimit, pra kur u shpall ofertuesi më i mirë.

Rritja tjetër prej 10% pritët të shqyrtohet dhe të miratohet nga ZRRE-ja në prill të këtij viti dhe kjo në momentin kur "Liman&Çalik" ta marrë menaxhimin e Rrjetit të Distribucionit dhe Furnizimit. Përse shtrenjtimit të ardhshëm po i paraprin tani ky i fundit? Kjo ndodhi verës, kur nuk vërehej qartë, dhe e ndiejnë tani në dimër që ky shtrenjtim të kamuflohet nga rritja e shpenzimeve për shkak të ngrohjes. Tani thuhet se është dimër dhe rrjedhimisht qytetarët shpenzojnë më tepër, e kur të bie sasia e shpenzimit në pranverë, ndodh rritja e radhës, e cila nuk do të mund të vërehet pas pagesave të larta në dimër dhe e cila barrë në dimër. Rritja ndodh verës, e barra bie kryesisht në dimër. Pushteti synon të llogarisë në shpresën për memorie të dobët të qytetarëve. Marifet, se jo mahi! Ky shteti ynë me këtë politikë të Qeverisë dhe këta

qeveritarë, marifete dinë dhe mund të bëjnë si duket vetëm me qytetarët tanë të varfër. Si duket këtë, gjë po dinë ta bëjnë më së miri dhe është e qartë se këtë e kanë mësuar nga marifetet e të tjerëve mbi ta.

Marifeti “Limak&Çalik” është se ai e do energjinë e shtrenjtë me ndihmën e shtetit të Kosovës dhe po ia del në këtë qëllim. Këtu Qeveria, ose është pjesë e marifetit, ose është po e ha atë. Qeveria ndaj privatit nuk bën marifete, por kryen punë me zell për të. E ndotur është kjo pozita sadomazohiste e këtij pushteti, që qëndron në mes të interesave të të tjerëve, në njërën anë dhe qytetarëve, në anë tjetër.

Mazohistë ndaj një “Limak&Çalik” dhe sadistë ndaj qytetarëve. Edhe në vendet e rajonit, kompanitë që e privatizuan distribucionin, e rritën çmimin e energjisë. Rryma është shtrenjtuar për 45% në Shqipëri, pas privatizimit. Po ashtu është shtrenjtuar në Maqedoni, në Mal të Zi. Për sa i përket privatizimit kjo ka qenë edhe një nga arsyet e kundërshtimit të privatizimit nga Lëvizja “Vetëvendosje”. Dhe përgjigjja nga ministri Beqaj ishte se këtu do të jetë më ndryshe.

Çka po ndodh, realisht? Në vendet e rajonit, rritjet e çmimit i rezistonte shteti. Tek ne, shteti e ndihmon këtë. Në vendet tjera ndodhi rritja pas transferimit të pronës te kompania private dhe me kërkesë të saj, tek ne kjo po ndodh para transferimit. Këtu kjo rritje po bëhet me kërkesë të kompanisë publike, pak para se të ndodhë transferimi tek privati dhe këtë rritje në fakt po ia realizon shteti.

Rritje të shpeshta të çmimit të energjisë po ndodhin si asnjëherë më parë, pikërisht para se t’i bartet pronësia “Limak&Çalik”. Rritje të tilla të çmimit nuk kishte kur KEK-u kishte nevojë për rritje, rritja po ndodh për “Limak-&Çalik”

Po ashtu janë duke u investuar 8 milionë euro për ndërrimin dhe digjitalimin e njehsorëve pikërisht këta muaj, po bëhen investime tash që t’i gëzojë “Limak & Çaliku”, nga muaji prill.

Çka i thuhet kësaj? Mbrojtje e interesit të qytetarëve apo mbrojtje e interesit të kompanisë private. Me kompaninë që privatizoi KDSI-n po ndodh e njëjta gjë, që ndodhi edhe me kompanitë tjera që privatizuan pasuritë e Kosovës si ‘Ferronikeli’ apo ‘Sharrceci’, edhe ato u subvencionuan nga shteti. Privatizimi në vend se të lehtësojë shtetin nga derdhja e parasë publike tek ne, ai po e ngarkon atë edhe më tej. Po e kemi të qartë pra efektin e këtij privatizimi, atë po e ndjen shteti mbi kurriz, atë po e ndien qytetari ynë i varfër.

Për 13 vjet, njëri prej problemeve kryesore të KEK-ut ka qenë energjia paainkasuar, pra ajo e vjedhur. Njehsorët digjitalë do të kishin qenë një ndihmesë jashtëzakonisht e madhe për të përmirësuar këtë gjendje dhe asnjë qeveri asnjëherë nuk e ndërmori këtë investim. Dhe tash kur po privatizohet, po i investojmë 8 milionë euro në to. Kjo është logjika e kësaj qeverie, pra shkatërrimi i publikes për privatizim dhe deri në privatizim, e pastaj përdor të gjitha mjetet shtetërore, përfshirë paranë publike për ta ndihmuar të njëjtën ndërmarrje.

Rritje çmimesh do të ketë, pra, edhe më tutje me këtë politikë dhe Qeveri, qytetari do të vazhdojë të japë para, do të vazhdojë t'i shtohet barra, do të vazhdojë të varfërohet pasi apetitet e pushtetarëve, kompanive që po zhvatin potencialin e këtij vendi, janë gjithnjë në rritje. Prandaj, ky vend ka nevojë për ndryshime të thella politike, jo vetëm reformime e riformatizime të kota, jo ndërrim formal të pushtetarëve, por ndërrim thelbësor të politikës.

Në fund, kalimi i distribucionit në pronësi të “Limak&Çalik” urgjentisht duhet të ndërpritet, pra duhet të ndalohej, madje duhet penguar me çdo kusht.

Dhe, në fund, protestat janë të drejta dhe ato assesi nuk duhet të ndalen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në lidhje me KEK-un prej pas lufte ka probleme dhe tani kanë ardhur deri te, kanë vluar problemet dhe tani kemi protesta.

Kur në legjislacionin 2004/2007 isha në Komisionin e Zhvillimit Ekonomik, aty mbanim shumë work-shope sesi do të fillojë shumë shpejt ndërtimi i termocentralit të ri ose termocentralit C dhe unë besoj se kam shprehur që në këtë vit të fillojë të funksionojë ky termocentral për arsye se e kemi lëndën e parë dhe Kosova është shumë e pasur me lignit dhe flemë, thuaja se, mbi thëngjill dhe me siguri do të kishte dalë edhe çmimi shumë më i lirë për energjinë elektrike që do të ishte shumë e mirë për qytetarët e Kosovës. Besoj që KEK-i me bllok tarifat të cilat i ka caktuar është duke i dëmtuar në masë të madhe qytetarët e Kosovës, për arsyes se vetëm në Kosovë përdoren këto bllok- tarifa, me një stil të tillë.

Ne jetojmë dhe kemi familjar në Perëndim dhe dihet që në Perëndim në fund të vitit bëhet pagesa, për çdo muaj bëhet pagesa, gjendet një mesatare dhe në fund të vitit bëhet plus ose minus, harxhohet. Ndërsa tek ne ndodh që ndodhsha, jo ndoshta po kjo ka ndodhur që inkasantë të vonohen me qëllim të caktuar një ose dy ditë dhe të ngritët mbi tarifën 600, dhe mandej të bëhet ngritja e çmimeve. Mjafton kjo të tri herë të gabojnë inkasantë dhe të mos vijnë në Kosovë dhe kur kemi 400 000 orë, do të thotë 400 000 që e shfrytëzojnë rrymën dhe paguajnë, po të jetë shuma nga 10 euro, aty janë 4 milionë euro. Do të thotë tri herë gabohet nga 4 milionë euro, janë 12 milionë euro dhe mandej KEK-i do ta paguajë kredinë që e ka marrë nga Qeveria, nga buxheti i Kosovës, nga taksat e qytetarëve të Kosovës dhe prapë me para të taksapaguesve, të qytetarëve të Kosovës ta paguan edhe kredinë e marrë.

Një diçka tjetër që është dhe që e ngrit çmimin e rrymës është numri mjaft i madh i punëtorëve në KEK. Ne të gjithë e dimë që në Kosovë është papunësi, mirëpo dua të them vetëm një fenomen. Vjen një inkasant e merr gjendjen e orës, pas dy ditëve vjen inkasanti tjetër i cili e bie faturën dhe i treti është arkëtari. Do të thotë këta ndikojnë në

ngritjen e kostos së çmimit të produktit dhe kështu na del që çmimi i rrymës është shumë më i lartë se sa në tërë Evropën, edhe Juglindore por edhe Perëndimore.

Unë shpresoj që këto gabime duhet të evitohen nga ana e KEK-it dhe me siguri se çmimi për konsumatorët do të jetë më i lirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Emin Gërbeshi e ka fjalën.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit kryesues!

Edhe në të kaluarën ka pasur vazhdimisht manipulim me faturat e energjisë elektrike, por këto kanë qenë në përmasa më të vogla, prandaj edhe nuk janë hetuar lehtë nga konsumatorët, por këto të fundit kanë qenë tej mase të fryra prandaj edhe reagimi i konsumatorëve ka qenë i ligjshëm dhe i menjëhershëm.

Është vështirë të dilet nga ky menaxhim i tillë i KEK-it, sepse ekziston monopoli dhe kur ekziston monopoli atëherë politikat diktohen më lehtë. Megjithatë, sot ky debat duhet të ndikojë të paktën që të merren masat e duhura që të eliminohen të paktën këto të meta të cilat po e dëmtojnë drejtpërdrejt konsumatorin e Kosovës.

Është tepër shqetësuese rasti kur dihet që ZRRE-a veç po thuhet se ka miratuar kërkesën e KEK-it për rritjen e rrymës elektrike e cila është dashur të merret vendim më 28 shkurt 2013 dhe kjo rritje do të jetë mbi 10% që megjithatë do të ndikojë edhe kështu në jetesën tepër të vështirë që e kanë pjesa më e madhe e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Unë pa hyrë në detaje tjera, sepse u tha shumë, po propozoj që në rekomandime të përfshihet.

E para, që të ndalohet rritja e energjisë elektrike, e dyta, që të hiqet bllok tarifa për ekonomitë familjare, sepse aty po ka mundësi të manipulimit më shumë me faturat e energjisë elektrike, sepse kjo në njëfarë forme, u tha edhe më herët, është edhe kundër ekonomisë së tregut, sepse ai që shpenzon më shumë ai duhet ta ketë çmimin më të lirë dhe jo ai që shpenzon më shumë në ekonomi familjare të futet në një kategori më të lartë me çmim për kilovat orë të energjisë elektrike dhe e treta, që Kosova të zbatojë direktivat që janë të parapara edhe në bazë të traktatit për energji elektrike në kuadër të BE-së, sepse është nënshkruese e tyre. Dhe nëse Kosova do t'i zbatojë direktivat e BE-së dhe traktatin e BE-së për energji elektrike, atëherë çështja rregullohet menjëherë, sepse këto janë të parapara në formë ligjore tarifave edhe për ekonominë familjare edhe për ato industriale dhe kështu problemet do të evitoheshin dhe mundësitë për fryrje të faturave të energjisë elektrike do të ishin shumë më të vogla.

Unë mendoj se ata që e menaxhojnë sot KEK-un dhe ata që janë jashtë menaxhimit të tij, po kanë ndikim në KEK, nuk mund të rrinë pa keqpërdorime të tilla, prandaj dyshoj shumë që kjo situatë do të na përcjell edhe me vite të tëra, po një debat i tillë duhet të paktën të ndikojë që t'i vihet një kufi këtij keqmenaxhimi dhe kësaj mundësie të vazhdueshme të keqpërdorimit të faturave të energjisë elektrike që ka argumente se në të kaluarën ka pasur po në një shumë më të vogël 2, 3 euro, 5 euro dhe kjo ka ardhur

sidomos, sepse leximi i orëve të energjisë elektrike ka ardhur dhe gjithmonë është bërë me vonesë dhe është bërë me qëllim të caktuar nga KEK-u se ajo menjëherë e kalon atë 600-kilovatëshin e famshëm që është përcaktuar si kategori nga KEK-u dhe kështu normalisht që konsumatori i varfër i Kosovës është i detyruar të paguajë më shumë.

Mendoj se Qeveria madje edhe Parlamenti duhet ta japë fjalën e vet dhe të ndikojë që në KEK të ketë tjera politika menaxhuese dhe aty të jenë njerëzit e ndërgjegjshëm të cilët vërtet do të punojnë jo veç për interesa të një korporate ose të vetat personale po të mendojnë edhe për interesa të qytetarit dhe të konsumatorit, sepse në fund të fundit ata po prekin jetën dhe standardin e vet qytetarëve tonë.

Po shpresoj që ne do ta kemi një ndikim dhe do të bëhet diçka më mirë në këtë aspekt dhe shpresoj që Grupi i Lidhjes Demokratike do të marrë parasysh këto rekomandime, po edhe rekomandimet tjera që u thanë këtu dhe dolën se do të jenë të mirë, të përgjithshme dhe madje edhe në të mirë të qytetarëve tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në kuadër të strategjisë së energjisë, dokumenti i votuar në këtë Parlament, një nga shtyllat kryesore është edhe siguria e furnizimit. Kjo është sfida me të cilën jemi ballafaquar që një kohë të gjatë.

Kur flasim për energjinë elektrike ne duhet të kemi në konsideratë se ku kemi qenë para dy-tri vjetëve në planin ABC, me kualitetin e energjisë, me ndërprerje të shpeshta si rezultat i rrjetit të dobët, me neverinë e shkaktuar nga gjeneratorët në çdo rrugë të Kosovës. Andaj, të gjithë jemi dëshmitarë se gjendja e furnizimit me energji gjatë dy vjetëve të fundit është përmirësuar dukshëm dhe kjo ka ndodhur si rezultat i politikave më të mira në nivel të Ministrisë përgjegjëse, por edhe të koordinimit më të mirë të aktorëve në kuadër të këtij sektori.

Ky reflektim pozitiv ka ndodhur si rezultat i investimeve të vazhdueshme në sektorin e energjisë, investime të cilat janë shtrirë po thuaj se në të gjitha fushat që nga gjenerimi, transmissiioni dhe distribucioni.

A është bërë mjaft dhe a ka vend për të bërë më tepër? A kemi nevojë për më tepër energji në bazë të dhënave për import, me siguri se po? Shkuarja përpara në procesin e ndërtimit të kapaciteteve të reja siç është termocentrali Kosova e Re, por edhe shfrytëzimi i burimeve alternative si mundësi, siç është rasti me ndërtimin e hidrocentralit në lumenjtë e Deçanit nga kompania austriake ‘Kelkos’. A ka nevojë për një energji më kualitative dhe duke krijuar mundësitë që ajo të mos humbë gjatë bartjes se saj, padyshim se po?

Investimet në rrjet, konkretisht në distribucion kanë kosto të lartë dhe kjo është arsyeja që ne duhet të përkrahim privatizimin e distribucionit nga “Limak&Çalik”, ngase ne nuk kemi buxhet të mjaftueshëm për këto investime.

Andaj, të nderuar kolegë, ju ftoj që të jemi më pragmatikë në kërkesat tona. Të kërkojmë që situata e furnizimit me energji të përmirësohet edhe më tutje dhe këtë mund ta bëjmë më së miri duke përkrahur të gjithë aktorët në sektorë si Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, KOST-in dhe KEK-un. Gjithashtu, duke parë investimet private në sektorë në funksion të këtyre qëllimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Faturat e energjisë elektrike për janar të vitit 2013 vërtet e terrorizuan qytetarin. Çka është ky eksperiment i radhës i Qeverisë së Kosovës e cila vazhdon avazin e vjetër me skandal pas skandali. Kush është fajtor? Dihet fare mirë, adresa është po kjo Qeveri e cila mat pulsën e qytetarit dhe rëndon ekonominë edhe ashtu të rrënuar familjare.

Familjet që rëndom paguanin nga 30 deri 50 euro për ekonomi familjare në janar shastisen nga ardhja e faturave. Po këto familje marrin fatura me qindra euro shpenzime edhe pse numri i elektro-pajisjeve është i njëjtë, numri i anëtarëve është i njëjtë, sasia e shpenzimeve është e njëjtë për vite me radhë, por çdo muaj kanë paguar shumë të njëjtë parash e në janar të 2013 u vjen fatura shumëfish më e lartë.

Arsyetimi i menaxhmentit të KEK-ut jepet sikur të ishin në foshnjore të fëmijëve, se baba dimri nuk ju sjell dhurata nëse nuk tregoheni të mirë. Arsyetim banal, por edhe i rrezikshëm gjoja se nuk janë lexuar matësit elektrik me kohë.

Pyetje po për këtë menaxhment, si është e mundur të mos lexohen mirë orët elektrike për mbi një vit në tërë Kosovën? Sigurisht se kjo sa është qesharake po aq dhunon inteligjencën e secilit qytetar të Republikës së Kosovës.

Prapë një pyetje po menaxhmentit të KEK-ut, si është e mundur në tërë Kosovën të mos jenë lexuar njehsorët elektrikë dhe të gjithë ekonomitë familjare dhe bizneset paska pasur tejkalim të shpenzimeve të energjisë elektrike, kjo është lojë e rrezikshme dhe me pasoja vetëm për këtë Qeveri?

Kush është ai që ka të drejtë të vjedhë e plaçkit qytetarin e Kosovës në emër të ligjit të shtetit? Kjo është sa paradoksale po aq edhe e dhimbshme.

Në anën tjetër, lexoj në media se si zoti Buzhala, i cili pa skrupull pohon se secili qytetar ka të drejtë ankese dhe se, sipas tij, ato do të shqyrtohen me seriozitet, cinizëm!

Njëjtë del menaxheri i KEK-ut në mediat elektronike, e mundohet të shesë mend e tu qes hi syve popullit mbi të drejtën që e kanë dhe se gabimet janë 0,0% dhe se kanë mbi 400 000 njehsorë dhe se marrë parasysh ankesat ky numër është simbolik.

Me mijëra ankesa të qytetarëve, e nga to mbi gjysma e tyre me gabime e shumë e shumë qytetarë të revoltuar as që u ankuan. Sigurisht se presin të dalin të palarat e matjeve të inkasantëve.

Prapë një pyetje për menaxherët e KEK-ut dhe ata që dhanë direktiva të bëjnë këtë aventurë. Nga këto, mbi 400 000 njësi, pra orë elektrike po të vidhen veç nga 2 euro, arrijnë milionin. Po sa është hajnia kur kjo shumë shumëfishohet? Sigurisht se këto llogari të thjeshta di t'i bëjë edhe menaxhmenti i KEK-ut.

Reagoi Avokati i Popullit. Reaguan edhe shumë e shumë institucione, edhe nga Shoqëria civile, ndërsa Qeveria hesht, apo reagoi vetëm shkarazi sa për sy e faqe.

KEK-u doli me deklarata se ka suspenduar inkasantë që nuk kanë qenë në nivel të detyrës, e në anën tjetër po ky KEK stimulon po këta inkasantë që sa më shumë shkyçje që të bëjnë aq më shumë marrin pagë. Kësaj i thonë: “dushk për gogla”.

Ndërkaq, Zyra e Rregullatorit të Energjisë deklaroi se ende po mblidhen prova, sigurisht se edhe ky është cinizëm i llojit të vet.

Populli doli në rrugë për hajnitë e KEK-ut, por jo vetëm për këto hajni, por edhe për hajni tjera, numri i tyre u rrit shumë. Kjo është fillimi i protestave popullore të cilat kërkojnë dhënien e përgjegjësisë së kësaj Qeverie për skandalet e njëpasnjëshme. Sigurisht se populli mund të gënjehet, por kurrë të manipulohet.

Kjo Qeveri është ngritur mbi hajninë e votës, e vazhdon avazin e vjetër, por populli do ta ndëshkojë ashtu siç e ka merituar qysh moti, kjo Qeveri të bjerë nga qeverisja e vendit.

Po kjo Qeveri e ka katandisur Kosovën në vendin më të varfër në Evropë dhe në fundin e fundit të renditjes edhe në botë për varfëri ekstreme. Populli është lodhur nga hajnitë, korrupsioni e skandalet e njëpasnjëshme. Faturimi i KEK-ut për janar të këtij viti ngjan me lëkurën e lepurit që e rrëzoi devenë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Beqaj e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit shumë, zoti nënkryetar!

Më lejoni që t'i falënderoj të gjithë ata deputetët të cilët me të vërtetë kanë dhënë sugjerimet dhe vërejtjet e tyre profesionale, sepse nga shumica e debateve, mbi 80% të debateve u bënë mbi bazën e nevojës për diskutim, respektivisht monitorim dhe komunikim me Zyrën e Rregullatorit të Energji, të cilën unë e thashë që në fillim, prandaj Ministria e Zhvillimit Ekonomik i ka dhënë në dispozicion edhe Zyrës së Rregullatorit të drejtën që të komunikojë edhe sa i përket tarifave dhe ne do të jemi të gatshëm, dhe Qeveria do të jetë shumë e gatshme ta japë kontributin e vet, nga pjesa e vet

për çmimin e energjisë, që kjo të jetë sa më e vogël dhe këtë për hir të qytetarëve, sepse ne konsiderojmë që mirëqenia e qytetarëve është elementi më i rëndësishëm.

Lidhur me debatet të cilat janë jashtë temës për të cilën ne e kemi thirrur sot ku flitet për strategjinë e energjisë, unë dua vetëm t'i përkujtoj deputetët se strategjia e energjisë është aprovuar nga ky Kuvend, unë si ministër e kam trashëguar një strategji të tillë e cila në bazë trevjeçare ka për obligim të rishikohet dhe ne kemi filluar procedurat për ta rishikuar dhe prapë do të vijë në Parlament.

Dhe kjo strategji ka paraparë edhe privatizimin dhe ai privatizim i cili është bërë është bërë me vendim të Kuvendit. Ky Kuvend ka debatuar së paku tri herë mbi procesin e privatizimit dhe ka aprovuar tri herë procesin e privatizimit. Pra, ne jemi të obliguar që të respektojmë, respektivisht t'i zbatojmë vendimet e Kuvendit.

Edhe një herë dua të them se tarifat për energji caktohen nga Zyra e Rregullatorit dhe nuk caktohen nga Qeveria. Qeveria kjo është për qytetarët, nuk e ka asnjë kompetencë të vetme në drejtim të marrjes së vendimit final. Ne kemi një pjesë dhe ajo është pjesa e përfitimit nga ekuitetet apo pasuritë të cilat ata i kanë dhe ne këtu do t'u jemi shumë të kujdesshëm, por i bëj ftesë Kuvendit që të jetë shumë agil në mënyrë që tarifat të mos rriten mbi nevojat dhe mundësitë që i ka qytetari për t'i paguar. Vendimi mbi tarifat është vendim i Kuvendit, jo i Qeverisë.

Burimet alternative të cilat u përmendën, dua të shpjegoj për hir të qytetarëve dhe të Kuvendit se të gjitha licencat për furnizimin, respektivisht prodhimin e energjisë alternative, i jep Zyra e Rregullatorit në bashkëpunim me komunat.

Ky është Ligji mbi dhënien e licencave të cilat bëhen me autorizim dhe Qeveria, respektivisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik asnjë kompetencë të vetme mbi lëshimin e licencave në energjinë alternative nuk e ka por e ka rregullatori. Ministria ka për obligim që të vendosë caqet orientuese për nevojën e energjisë alternative dhe ne këtë e kemi aprovuar, e kemi njoftuar Rregullatorin dhe unë e ftoj Kuvendin ta ftojë Rregullatorin dhe Rregullatori të japë shpjegim cila është procedura, pse janë ato procedura të tilla, sa ka kompani të cilat kanë aplikuar për licencë, sa u kanë dhënë licencat dhe sa kanë dhënë pa licenca?

Këtë dua ta bëjë për qytetarët. Vitin e kaluar janë licencuar 24 megavat, ndërsa janë pa licencuar diku rreth 100 megavat nga Zyra e Rregullatorit, por Kuvendi mund të ketë në mënyrë të drejtpërdrejtë informatën nga ana e Zyrës së Rregullatorit.

Dhe ajo se qytetarët po e ndjejnë dhe kanë qenë të terrorizuar, unë dua të them që qytetarët kanë pasur shqetësim me të drejtë. Qeveria ka marrë vendimet mbi dokumentet zyrtare të cilat i keni marrë ju deputetë dhe unë i kam marrë dhe mbi verifikimin e shkeljeve dhe ky ka mundur që Qeveria të mos marrë vendime ad hoc sipas dëshirave të askujt, por të konfirmuar nga autoritetet dhe institucionet të cilat janë përgjegjëse për këtë.

Prandaj, qytetarët jo që janë të terrorizuar, por qytetarët në mënyrë të përditshme e ndjejnë se furnizimi me energjinë elektrike dhe shfrytëzimi i gjeneratorëve është e kaluar. Qytetarët kanë shfrytëzim, kanë furnizim të rregullt me energji elektrike dhe ky është fakt.

Ndërsa, po e them edhe një herë që vendimet e Qeverisë merren mbi fakte, mbi vlerësime profesionale, procedurale, institucionale, të institucioneve të cilat janë përgjegjëse.

Dhe, edhe një herë dua të them për qytetarët që më vjen mirë që në Kuvend mbi 80% të debatit për problemin energjetik në Kosovë, po shkon në drejtim të Zyrës së Rregullatorit dhe i bëj ftesë Kuvendit ta thërret Zyrën e Rregullatorit, sepse keni kompetencën mbi ta dhe mund t'i rregulloni procedurat shumë më mirë. Rregullatori është ai i cili e ka licencuar KEK-un, e monitoron KEK-un, e penalizon KEK-un për mosrespektim të licencës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues dhe të nderuar deputetë, Shtrenjtimi i faturave të energjisë elektrike për muajin që e lamë pas apo edhe paralajmërimet për rritje të çmimeve gjatë muajve në vijim për këtë sektor të rëndësishëm të shoqërisë, simptomatkisht paraqesin thelbin e krejt gjendjes së rëndë në të cilën ndodhet ky sektor.

Nuk ka dilemë se sektori i energjisë ballafaqohet me probleme të shumta organizative ekonomiko-financiare dhe që kanë për rrjedhojë mospërmbushjen e misionit themelor që është furnizimi i rregullt me energji të rregullt për qytetarët e për ndërmarrjet, qëndrueshmërinë ekonomike dhe mbrojtjen e ambientit. Në këtë kontekst të kaosit, krizës totale deri më tani nuk ka strategji të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik as prioritete të definuar të orientimit të energjisë nëpër sektorë të ekonomisë, si parakusht të planifikimit strategjik të zhvillimit të energjisë, të analizës paraprake dhe të bazuar të këtij planifikimi për vlerësimin e nevojave për energji, sasinë e kapaciteteve të reja energjetike, madhësinë dhe numrin e njësive të gjenerimit.

Kështu efienca e energjisë asnjëherë nuk është trajtuar dhe nuk po trajtohet si një potencial me prioritet të zbatimit nëpër sektorët e ekonomisë, por me këtë qasje që është duke u aplikuar dhe veçanërisht që ka dominuar këtyre dy muajve të fundit dhe që paralajmërohet të ndodhë gjatë muajve në vijim, ai po trajtohet si një mundësi shtesë për të plaçkitur qytetarët e vendit dhe nuk ka dyshim se pikërisht rasti i fundit i fryrjes së faturave, si dhe paralajmërimet për shtrenjtim të ri të çmimeve të energjisë veprime këto të cilat nuk marrin parasysh gjendjen ekonomike të qytetarëve të Kosovës, janë pikërisht pjesë e kësaj strategjie. Madje ky rast më pastaj nxiti reagimin e qytetarëve të Kosovës për këtë dukuri, që fatkeqësisht disa ministra cinikë të Kabinetit qeveritar, në mënyrë shumë të paskrupullt këtë protestë për drejtësi e quajtën si përpjekje për të marrë pushtetin, etiketim më absurd besoj se nuk ka.

Sidoqoftë kjo fryrje e faturave si dhe rritja e çmimeve tashmë nuk ka dyshim se janë pasojë e drejtpërdrejtë e përgatitjeve për rritje që do t'i kemi nesër e që do të na i bëjë konsesoliumi, të cilit iu fal aseti i rëndësishëm i distribucionit si njëri prej aseteve strategjike të zhvillimit ekonomik. Prandaj kjo plaçkitje e qytetarëve nga kjo kompani që gjoja u bë gabimisht dhe në anën tjetër privatizimi i saj qëndrojnë në një lidhje kauzave njëra me tjetrën. Rritja e faturave është ana tjetër e medaljes së privatizimit.

Dhe kjo rritje e çmimit të energjisë elektrike për të krijuar favor investitorit privat, është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e një qasje që interes primar e ka vetëm fitimin e kompanisë me çdo kusht, madje edhe mbi varfërimin e qytetarëve të shtetit të tij. Madje nëse analizohet me vëmendje vetë Qeveria e Kosovës dhe këshilltarët teknik të korporatës financiare ndërkombëtare për të cilët me të drejtë një studiues i njohur ndërkombëtar i zhvillimeve në Kosovë shumicën e këtyre këshilltarëve i ka përkufizuar si kriminelë aventurier që qëllim themelor kanë pasur përfitime personale, disa herë kanë argumentuar se çelësi për privatizimin e rrjetit të energjisë do të jetë ngritja e tarifave të energjisë dhe pikërisht pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për të shitur rrjetin e energjisë për 26 milionë euro, apo më tepër, më mirë të themi për të falur, ky vendim i ZRRE është një hap tjetër i dëmshëm i cili do të rëndojë edhe më shumë në xhepin e qytetarit edhe ashtu të varfër të Kosovës.

Shprehur në mënyrë metaforike, kjo logjikë e mbrapshtë qeveritare pohon se duhet t'i shtrenjtojmë çmimet që ta kemi më të lehtë që t'i falim më pastaj kompanitë.

E kjo fryrje e faturave apo shtrenjtimi i çmimeve të energjisë, nuk do mend se nuk do të pa goditur edhe segmentet e tjera të shoqërisë, ngase në mënyrë implicite do të nxisë edhe shtrenjtimin e artikujve të tjerë të konsumit, kurse kjo edhe më shumë do t'i varfërojë konsumatorin të cilit vazhdimisht po i dobësohet fuqia blerëse. Kështu kjo ngritje do të ndikonte në rritjen e shpenzimeve për banim dhe shpenzimeve për ushqim, sidomos kur dihet se këto dy kategori janë më kryesoret dhe përbëjnë më shumë se 2/3 e buxhetit të çdo qytetari të Kosovës.

Ndërkaq, arsyetimet absurde se shtrenjtimi i energjisë bëhet edhe nisur nga fakti se Kosova e ka kilovatin më të lirë në rajon, është i pa themeltë, sepse në anën tjetër duhet pasur parasysh se edhe Kosova është vendi me GDP më të ulët në rajon dhe Evropë, saktësisht ndërsa GDP për kokë banori është 2.5 herë më i ulët se në Shqipëri e në Bosnje apo gati 4 herë më i ulët se në Mal të Zi dhe gjykuar mbi këto parametra ekonomike si dhe nga ky nivel i zhvillimit apo më mirë të themi i mos zhvillimit shoqëror e ekonomik, atëherë na del se janë pikërisht qytetarët e Kosovës edhe pse më të varfrit në rajon ata që paguajnë më së shumti çmimin e energjisë elektrike. Ndërkaq edhe përpjekjet që humbjet teknike dhe komerciale që aktualisht KEK-u mund t'i ketë si pasojë e shumë faktorëve të kompensohen me anë të fryrjes së faturave apo rritjes së çmimeve, paraqesin një strategji manipulative të llojit të vet me synim plaçkitje dhe ndëshkimin pikërisht të atyre që rregullisht paguajnë.

Në këtë kontekst, është paradoksale edhe fakti se si deri më tani gjatë këtyre viteve të fundit kjo korporatë ka eksportuar rrymë me çmim më të lirë se sa që ka importuar, madje ajo që është më skandaloze në këtë rrëfim ndërlidhet me faktin se pikërisht

kompani me seli në Beograd deri më tani kanë pasur monopolin për t'i shitur rrymë Kosovës, ndërkohë që injorohet ndërtimi i kapaciteteve të përbashkëta energjetike me Republikën e Shqipërisë.

Prandaj, gjykuar mbi këto parametra kjo fryrje e faturave apo edhe rritja e çmimeve të energjisë është rezultat i drejtpërdrejt i keqpërdorimeve dhe keqmenaxhimit që deri me tani ka ekzistuar në këtë ndërmarrje publike si pasojë e kësaj politike të mbrapshtë të mos zhvillimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Falënderoj Grupin Parlamentar të LDK-së që e ka ngritur me shpejtësi këtë debat për shkak të situatave që u krijua me faturat e janarit, edhe pse problemi është shumë më i thellë dhe shumë më i rëndë, por ky ishte një pretekst që na të diskutojmë dhe përpiqemi që të japim sugjerime se si të dilet nga kjo situatë.

Vetë fakti se prej 3 000 ankesave që i ka shqyrtuar KEK-u vetë, rreth 900 sa kanë dalë me probleme, tregon që kemi të bëjmë me një situatë të çrregulluar. Bile çrregulluar shumë keq, kështu që nuk jam i sigurt që shkarkimi, domethënë me shpejtësi i drejtorit menaxhues të KEK-ut do ta rregullojë situatën. Kjo më tepër i përngjan si një lloj paniku që të ndërmarrim diçka që të qetësohet situata.

Më mirë është që situata të shihet mirë, të analizohet mirë dhe të ndërmerren masa adekuate afatgjate.

U përmend çështja e politikës së çmimeve dhe unë në këtë pikë pajtohem me ministrin se çështja e çmimeve, rregullimit, të konkurrencës, të standardeve bien në fushëveprimin e Rregullatorit, por 80% për t'i çuar këto probleme te Rregullatori, mendoj se ishte një kërkesë, mos të them, jo serioze shumë.

Nuk janë problemet për të cilat ne sot po flasim, 80% probleme që dalin nga ajo që punon Rregullatori. Këto probleme dalin në rend të parë nga mënyra se si ne marrim vendime, se si i përcaktojmë politikat, si i bëjmë investimet, se si i qeverisim ndërmarrjet publike, dalin nga transparenca e munguar ndaj Kuvendit dhe ndaj kërkesave të deputetëve në procesin e privatizimit.

Në këtë drejtim, mendoj se ne duhet të jemi real, konstruktivë dhe të shohim, sepse problemi pra është në një faturat, problemi nën dy është bllok-tarifa, por këto janë që paraqiten në sipërfaqe, si probleme ekzistuese. Edhe unë pajtohem që duhet t'i bëhet një reformë serioze këtyre bllok-tarifave.

Ajo që tha kryetari i Kuvendit dhe disa kolegë tjerë, me të vërtetë është absurde, gjithë ajo shkallë e vështirëson të qenët transparent ndaj konsumatorit dhe mundësia për të manipuluar me kilovatë dhe në dëm, shpeshherë, gati gjithë në dëm të konsumatorit,

është interesant që krejt manipulimet, krejt fryrjet shkojnë në dëm të konsumatorit, atëherë duhet reformë e thellë, e ne mendoj se këtu të gjithë pajtohemi që menjëherë Rregullatori duhet ta shqyrtojë këtë tarifën e bllokut, e cila si duket te ne ka mbetur në një relikte prej atyre racionimeve që janë karakteristike për një sistem që e kemi tejkaluar, domethënë, me lugë të japi konsumin. Konsumatori, ndërmarrjet le të planifikojnë konsumin e vet në pajtim me buxhetin e vet. Krejt çka duhet është të marrin vendime të mira dhe të jenë transparent dhe s'ka nevojë këto bllok - tarifa t'i mbrojnë konsumatorët e as ta mbrojnë kurrkënd me bllok-tarifa, sepse në Kosovë meriton diku propagohet që është çmimi i lirë i energjisë, por në qoftë se i shohim kjo çka ndodhë me bllok- tarifat dhe këto shkallë bllok tarifa dhe nxjerrim një mesatare të ponderuar, nuk del edhe aq i lirë në krahasim me rajonin. Nuk del edhe aq i lirë çmimi!

Por problemi më serioz është perspektiva, ku e kemi perspektivën? A dimë çka do të ndodhë, a mund të jemi të sigurt që ne po ecim rrugë së mirë? Ne kemi tregime gjithmonë të bukura, por praktika po na demanton në pritjet që po na paraqiten këtu nga Qeveria.

Pra, problemi kryesor është ku do të jemi për 2-3 vjet pas privatizimit? Dhe unë mendoj që e përkrah propozimin për një komision, por mendoj që ai komision duhet para se gjithash të merret me këtë problem. Nevojitet një auditim komplet i situatës me të cilin do të ballafaqohemi në të ardhmen, jo vetëm rreth çmimit shumë të kontestuar 26,3 milionë, i cili mund të ketë qenë pasojë e shumë problemeve, por problemet janë edhe më serioze. Ministri na ka thënë se ky çmim është i lirë por ne, në këmbim të këtij çmimi, kemi fituar shumë favore tjera nga investitori, fatkeqësisht këto favore tjera na nuk i kemi parë, ne nuk i dimë, deputetët nuk janë të informuar.

E në çka mund të jenë ato favore? Mund të jenë investime. Thuhet 300 milionë, kur do të investohen, me çfarë dinamike, në cilin sektor? Nuk e dimë atë, nuk e kemi. Edhe favorët tjera, cilat janë?

Në këtë drejtim, mendoj se ky komision duhet të bëjë pra auditin, ky komision që është propozuar, jo vetëm të faturave, jo vetëm të bllok- tarifës, jo vetëm politikave por për mua është më me rëndësi ta bëjë një audit a janë respektuar të gjitha procedurat rreth privatizimit sipas ligjit, sipas konkursit, sipas tenderit, të gjitha, prej 'a' deri në 'zh'.

Nën dy, të auditojmë procesin e pranim-dorëzimit. Unë e di dhe kam lexuar në gazetë se është krijuar një komision për pranim- dorëzim midis KEK-ut apo Qeverisë dhe Limakut. E kam lexuar edhe përbërjen e tij dhe jam habit pak a shumë lidhur me përbërjen, në aspektin profesional, para se gjithash megjithëse ka edhe tjera probleme, por sidomos në aspektin profesional, të shohë si po shkon ai pranim-dorëzim, çka po pranohet, çka po dorëzohet, a është kjo në harmoni me atë situatë që e kemi pas në tender?

E treta, investimet. Me të vërtetë, ne dëshirojmë të themi , ky Kuvend ta dijë kontratën. "Limaku" ka për t' i bërë 300 milionë, ka qenë e deklaruar. Kur do t' i bëjë ato investime? Si do të shprehet ajo në tarifa, si do të zhvillohet? Kështu ka qenë, e tash po shoh, ministri po thotë ndoshta s' i bën 300, ndoshta i bën 500, apo i bën 200, s' ka lidhje. Po unë këtë shifër e kam dëgjuar, për atë dhe bash për këtë po kërkojmë ne t' i japë këto, s' po paragjykojmë, jepni. Thoni çmimi është ky, ne i kemi fituar këto përfitime. Këtë e kemi

kërkuar në Kuvend, kjo është neglizhuar, kjo është esenciale, esenciale që ne ta dimë ku do të jemi me furnizimin me energji, ku do të jenë me çmime konsumatorët, si do të lëvizim më tutje? Këto janë esenciale dhe unë pajtohem që të forcohet roli dhe përgjegjësia e Rregullatorit, por këto gjëra janë esenciale në kuptimin afatgjatë dhe këto gjëra ne i kërkojmë në tavolinë dhe këto gjëra kërkojmë që t'i bëjë Komisioni eventual që do të formohet pas kësaj. Nëse nuk i bën Qeveria, nëse i bën Qeveria, s'ka nevojë komisioni, por është e pesta herë që po i lypin këto gjëra të vijnë këtu dhe nuk po vijnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj dëshiron të sqarojë diçka.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Një shpjegim të shkurtër për profesorin, por edhe për opinion dhe për deputetët.

Nuk është mirë të manipulohet me shifra dhe saktësi të dokumenteve të cilët janë publike. Çdo dokument, sa i përket procesit të privatizimit të Distribucionit është publik, profesor, janë të publikuara në ueb faqe.

Për më shumë, për të gjithë ata që dëshirojnë dhe që nuk mund ta shfrytëzojnë ueb faqen, ka hapësirë, është Ligji për qasje në dokumentet publike, i cili shpjegon qartë se me një kërkesë zyrtare mund të keni qasje në secilin dokument veç e veç me kushte të cilat vihen në këtë ligj. Prandaj unë po ju bëj ftesë që të mos shpërndajmë gjëra të cilat qytetarët nuk mund t'i dinë, kontrata është dokument publik. Për privatizimin e Distribucionit është raportuar tri herë në këtë Kuvend dhe janë dhënë të gjitha detajet. Për investimet nuk është mirë të manipulohet, sepse investimet, po e them edhe një herë, janë në kontratë dhe ato janë 300 milionë euro të parapara, të cilat janë subjekt i marrëveshjes në Rregullatorin. Rregullatori është ai i cili e vërteton apo nuk e vërteton.

U përmend këtu shumë që qytetarët do të ngarkohen me tarifa më të larta për shkak të Rregullatorit. Nuk është e vërtetë ajo, sepse ju, të nderuar deputetë, mund ta thirrni Rregullatorin e t'i thoni - nuk ka rritje të çmimit. Nga ana e Qeverisë, unë po ju them se Qeveria do të shkojë në minimum të kërkesave të veta që rritja të jetë zero, por ju jeni ata të cilët merrni vendim për çmime dhe tarifa të energjisë elektrike dhe nuk do ishte mirë të hapim këtu debat e të themi që Rregullatori e Qeveria, megjithatë Rregullatori. kështu e ashtu, janë gjëra të specifikuar në mënyrë shumë të qartë, shumë konkrete dhe kërkoj që të kemi qasje sa më profesionale për hir të interesit të publikut.

Procesi dhe strategjia e energjisë është aprovuar nga Kuvendi. Vendimi për privatizim është marrë nga Kuvendi. Këtij Kuvendi i është raportuar 3 herë. Dokumentet janë publike, investimet janë publike, të parapara në kontratë. Rreziqet rregullatore të gjithë ata të cilët kanë dëshirë të hyjnë e t'i lexojnë kontratat mund t'i lexojnë, por nuk është mirë t'i shpallim, t'iu japim informata publikut i cili nuk ka kohë të merret me këto gjëra, informata të cilat nuk janë të sakta. Këtë po e them për shkak të opinionit, për shkak të atyre të cilët mund të krijojnë panik për këto gjëra.

Prandaj, po e them edhe një herë, ne kujdesemi në mënyrë maksimale në kuadër të politikave qeverisëse. Të gjithë ata që flasin që s'ka strategji zhvillimore, mendoj se është një miopi ekonomike, të cilën nuk dëshiroj ta transmetojmë te qytetarët, sepse qytetari e sheh, rritja ekonomike në Kosovë është 4%, më shumë se në krejt vendet tjera të rajonit. Investimet janë këto, pagat janë këto. Do të thotë janë përkushtim për zhvillim, përkushtim për një jetë më të mirë. Sigurisht se ka përmirësim. Kuvendi mund të marrë çfarëdo vendimi, sepse është organ legjitim i cili ka fuqinë e vendimmarrjes, por mu po më duket jo logjike që Kuvendi kërkon për të krijuar komision mbi institucionin të cilin e monitoron vet dhe i cili është i thirrur të monitorojë, të auditorë , krejt t' i bëjë. Dhe kjo po më shtyn tash pak në dilemë. Logjika do të ishte që ju ta thirrni Zyrën e Rregullatorit që është institucion që ju e keni themeluar dhe t'ju përgjigjet juve. Ata të bëjnë auditim, sepse ata kanë bazë profesionale. Por nëse dëshironi të bëni komision mbi komision, komision mbi institucionin të cilin ju e keni themeluar dhe është përgjegjës para jush, urdhëroni bëjeni , është çështje e deputetëve, por këtë po e them për hir të interesit dhe publikut, sepse gjendja në Kosovë është më e mirë se sa po pretendohet të paraqitet këtu. Qytetarët do ta ndjejnë dhe po e ndjejnë në baza të përditshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është paraqitur zoti Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Po unë po habitem me këtë qasje që e dëgjuam tash. Unë e thashë shumë qartë se investimet janë 300 milionë dhe e kam parë kontratën, e kam lexuar, por kontrata ka shumë anekse, ka shumë telashe, anekset nuk janë.

Çështja e investimeve është shumë thelbësore, a bëhen investimet tash a mbas 10 vjetësh? Mu për këtë kur bëhet kontrata, nëse investohen sot 100 milionë, nga përfitimet nga ato investime në 10 vjetët e ardhshëm do të ndodhë diçka pozitive, por në qoftë se investojmë pas 15 vjetësh, është krejt një tregim tjetër.

Mandej, këto janë gjëra që ne i dimë shumë mirë dhe e dimë çka thotë njëra çka thotë tjetra.

Dy, ne nuk po kërkojmë të formojmë komision për Rregullatorin. Komisioni duhet të krijohet me atë, që unë e thashë, është të krijohet pikërisht për t'ia bërë një auditim thelbësor, një auditim serioz procedurës, përmbajtjes dhe gjithçka që ka ndodhur me privatizim të KEK-ut. Ky është propozimi im. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për ministrat,

Kolegë,

Unë do të jem shumë i shkurtër në këtë drejtim, meqë folën mjaft kolegët. Unë e di që çështja e faturave është çështje më shumë politike dhe kërkesat janë mjaft politike, po nuk dua të ngarkohet KEK-u për këtë çështje që nuk është kompetencë e KEK-ut kur kompetencë është drejtpërdrejt e Zyrës së Rregullatorit e po ashtu edhe e Ministrisë që i bën politikat.

Për çështjen e faturave e kam një raport të datës 8.3.2013 për muajin janar ku totali i gjithë njehsorëve në Kosovë është 459 mijë e 669, ndërsa kemi edhe kërkesat e ankesave që janë bërë, numri i ankesave është 3 804. Numri i ankesave të shqyrtuara është 3 782. Numri i ankesave të refuzuara dhe të pa bazë janë 2 785. Totali i aprovuar të ankesave është 980, ndërsa për të gjitha komunat, Prishtina prin në këto ankesa të shqyrtuara, Prizreni, Peja, Ferizaj, Gjilani, Gjakova dhe Mitrovica, prej të gjitha këtyre, Gjakova është më 77 ankesa të shqyrtuara dhe 77 dhe dallimi është zero.

Këtu është një raport i KEK-ut që tregon që KEK-u e ka kryer përgjegjësinë e vet në mënyrë të duhur, ndërsa përgjegjësia është e Rregullatorit dhe e Ministrisë.

Me këtë nuk duhet të ngarkohet as të kërkohet shkarkimi i dikujt që nuk ka përgjegjësi, por duhet të kërkohet përgjegjësia aty dhe ku është baza. Ndërsa, deklaratimet politike që janë bërë po ashtu që nuk duhet të paguhet fatura nga ministri, ka ngjallë indikacione që shumë njerëz mos ta paguajnë dhe angazhimi i të gjithëve ka qenë që KEK-u të mbledhë fatura dhe faturat që i ka mbledhur kemi pasur raste kur janë rrahë punëtorët e KEK-ut. Ne kemi kërkuar t'i mbrojmë punëtorët e KEK-ut, ndërsa kur ministri ka deklaruar këto ditë në mënyrë politike se nuk duhet të paguhet fatura ka qenë jo e drejtë, jo e përgjegjshme.

Ndërsa, unë mendoj se Kuvendi nuk cakton çmime të faturave, as të tarifave. Këto i cakton Zyra e Rregullatorit. Zyrën e Rregullatorit ne e zgjedhim vërtet, por ne nuk e caktojmë ato. Ndërsa, unë mendoj që këtu duhet të kërkohet dhe për muajin janar e njëjta është sikurse e muajit janar 2012. Unë pajtohem me kryetarin që kërkoi përgjegjësi, por megjithatë kjo përgjegjësi duhet kërkuar te institucionet të cilat merren me politikën dhe këto politika i bën Ministria dhe Zyra e Rregullatorit. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Vetëm për sqarim të deputetëve dhe të opinionit publik për një konstatim i cili nuk është i saktë. Asnjëherë, as Ministria e Zhvillimit Ekonomik, asnjë ministër, asnjë ministër në komisionin ministror për ndërmarrje publike, nuk ka bërë ftesë për mos pagesë të faturave.

Ne kemi bërë ftesë që asnjë shkyçje nuk do të bëhet për të gjithë ata njerëz të cilët kanë bërë ankesa deri në përfundim të trajtimit të ankesave të tyre, ndërsa kemi apeluar rregullisht dhe këto mund të shihen edhe nëpër komunikatat për shtyp që qytetarët apelojnë për të paguar faturat e veta, prandaj do të ishte mirë që të jemi të saktë në prononcime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Nait Hasani, kundër-replikë, një minutë.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk dua të merrem me thash e thëne, merrem me deklaratat që janë dëgjuar përmes mjeteve të informimit që nuk duhet të paguhet fatura e janarit. Këtë e ka thënë ministri! Faleminderit shumë.

KRYETARI: Mendoj që ministri e tha fjalën e vet. Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që në kuadër të këtij debati u thanë shumë edhe nga parafolësit. Konsideroj se ne e shprehim shqetësimin për gjendjen e krijuar sa i përket faturave të energjisë elektrike. Për një muaj a më shumë KEK-u dhe Qeveria nuk bënë asgjë për t'i adresuar shqetësimet e qytetarëve, sigurisht se qytetarët nuk mund të presin se problemin do ta zgjidhin ata të cilët e kanë krijuar vetë.

Nuk mund të zgjidhen problemet me konferenca për shtyp nga ana e Qeverisë duke i kërcënuar inkasantët e KEK-ut se do të penalizohen siç ndodhi edhe me largimin nga vendi i punës për disa menaxherë dhe zyrtarë të ulët në këtë dikaster dhe së fundi tash ministri na prezantoi se është larguar drejtori i KEK-ut.

Kjo ka ndodhur vetëm sa për ta arsyetuar vjedhjen që po u bëhet qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ne po ia përkujtojmë Qeverisë së faturat e fryra të energjisë elektrike janë përafërsisht tri herë më të larta se ndihma sociale që e merr një familje e varfër, 50% e një page mesatare të një shërbyesi civil, por në anën tjetër faturat janë vetëm 5% e pagës që marrin ministrat e Qeverisë së Kosovës.

Prandaj është e lehtë për ta të ironizojnë me qytetarët që dalin e protestojnë në shi, andaj ne vlerësojmë se deklaratimet e KEK-ut janë të papranueshme, kinse janë disa gabime teknike në faturime.

Një numër i madh i qytetarëve janë ankuar edhe për faturat e reja të fryra të muajit shkurt, ndërsa në anën tjetër zyrtarët e KEK-ut, po i quajnë normale vjedhjet dhe rritjet e faturave duke tentuar të maskojnë vjedhjen me gabime.

Ne i bëjmë me dije KEK-ut dhe të gjitha institucioneve relevante që merren me çështjen e energjisë së vjedhur që po bëhet me fatura të fryra nuk mund të jetë lëshim. Faturat e fryra të marra nga qytetarët asnjëherë me zvogëlim vlerash, tregon për vjedhjen me paramendim dhe kurrësi me gabime dhe lëshime.

Kjo Qeveri nuk ka kredo politike për të qeverisur. Ne kërkojmë përgjegjësi dhe do të ishte e udhës që Qeveria të dalë publikisht dhe të pranojë përgjegjësinë për këtë situatë të krijuar vetë. Por duke ditur moralin politik të kësaj Qeverie, ne nuk presim që ai ta bëjë një gjë të tillë, sepse nuk e ka bërë edhe për skandalet më të mëdha që kanë ndodhur në Qeverinë Thaçi 2.

Prandaj, kërkojmë nga Qeveria të merren përgjegjësi për dështimet në realizimin e projektit të Kosovës C, projekt i cili është aprovuar edhe në Parlamentin e Kosovës dhe njëkohësisht ky projekt nuk ka lëvizur fare më tutje.

Ne kërkojmë nga ministri Beqaj të sqarojë para qytetarëve se për sa do të rritet çmimi i energjisë duke filluar prej datës 1 prill të vitit 2013, sepse diskutimet kanë filluar për një

rritje tjetër të çmimeve të energjisë elektrike, edhe pse ministri po na thotë se Zyra e Rregullatorit merret me çështjen e tarifave, mirëpo edhe ministri në këtë rast është përgjegjës, sepse është ministër i kësaj Ministrie ku përfshin edhe këtë dikaster që ka të bëjë edhe me KEK-un.

Alternativat e Lidhjes Demokratike në fushën e energjisë elektrike janë të qarta. Ndërtimi i termocentraleve 300 megavat, ndërtimi hidrocentraleve të vogla në të gjitha lokacionet ku është e mundshme, implementimi i masave të eficiencës së energjisë elektrike në shfrytëzimin e amvisërisë dhe bizneseve, implementimi i masave për evitim e humbje të energjisë në rrjete, prandaj të gjitha këto do të ofrojnë furnizim stabil me energji dhe me çmime të përballueshme për qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë që debati është në një kohë ku ka goxha një presion publik për shkak se edhe ka protesta, po nuk është mirë që në fjalën tonë, në foltoren e Kuvendit, të bëhet diçka që nuk i kontribuon ose të thuhet diçka që nuk i kontribuon aspak as daljes nga kjo gjendje, as sanimit të problemeve të caktuara, as përmirësimit të këtij sektori e tjerë.

Ne, deputetët këtu e kemi rastin disa herë të trajtojmë çështje, ose sa herë që duam të trajtojmë çështje që janë problematike për qytetarët ose brengë e qytetarëve, po sot është një debat që ka të bëjë kryesisht me një temë të caktuar, me faturat me rritjen e faturave, ose me problemet e qytetarëve rreth faturave të energjisë dhe ne sot e shfrytëzojmë që të flasim më shumë edhe për tema që kanë të bëjnë edhe me strategjinë e energjisë, edhe me çështje që kanë të bëjnë me privatizimin, edhe me çështje tjera dhe për më tepër në disa prej fjalëve të kolegëve deputetë, pati gjatë fjalëve të tyre më shumë se 10 herë ndoshta fjala vjedhje, pati edhe terrorizim e gjithçka në fjalor, që mendoj më shumë se sa një patetikë, aspak nuk i kontribuon trajtimit normal të kësaj dukurie.

Nëse themi se ka vjedhje, duhet të bazohemi në diçka. Dhe, mendoj që janë organet kompetente ato që duhet t'i zbulojnë këto, t'i dënojnë këto dhe mendoj që po ashtu edhe ne si deputetë i kemi mundësitë e hapura t'i gjejmë ata ose të gjejmë dokumente ose raste të caktuara me emra e mbiemra për t'i detektuar këto dukuri.

Unë i kam dy dokumentet në të cilat mendoj që duhet trajtuar mirë. Është një dokument i datës 12 shkurt, një vlerësim i përbashkët nga institucionet, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Departamenti i Metrologjisë së Kosovës, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, pastaj Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit nga po kjo Ministri, Zyra e Rregullatorit, KEK-u dhe Shoqata e Konsumatorit në të cilën rezultojnë disa të dhëna që ne nuk duhet injoruar. Unë e di që në këtë debat të sotëm nuk është popullore të flasim diçka që ndoshta nuk u shkon mirë edhe shqetësimeve të qytetarëve që në këtë kohë dimri kanë edhe probleme serioze me faturat po edhe në mënyrë më normale kanë më shumë shpenzime të energjisë, por nga këto të dhëna del diçka që nuk mund të japim konstatime si deputetë kaq lehtë në foltore të Parlamentit. Ta zëmë nga janari 2012, janari 2013 janë disa statistika krahasuese ku energjia e faturuar në kilovatë në janar 2012 është

312.000, në janar 2013, 313.000 ose 0,27% më shumë dhe në euro që është 23.747.000 në 2012, në 26.100.000, 2013, që është 9,91%, del që është një përqindje gati e përafërt ose gati e njëjtë me rritjen e tarifave të energjisë elektrike. Pra, duhet të bazohemi në informata të cilave duhet t'u besojmë kur këto dokumente dalin bashkërisht nga një numër i institucioneve që janë të gjitha përgjegjëse njëra me tjetrën.

Janë dy çështje që janë detektuar, që janë publikuar dhe që janë thënë edhe këtu, që janë të meta: koha e leximit është për një dyditësh në kohën e festave të fundvitit, që nuk mund të justifikohen, prandaj edhe duhet të merren masa nga institucionet përkatëse dhe nga Bordi i KEK-ut dhe nga Ministria - Rregullatori i energjisë dhe janë njehsorët.

Ju e dini që ka probleme me vjedhjen ose rrjedhjen e energjisë e elektrike, faji është i gjithanshëm, probleme të mëdha, që po përsëriten me vite dhe ne duhet, përveç disiplinimit të kompanisë që duhet të ketë kujdes, duhet t'i vetëdijesojmë edhe qytetarët se kjo rrjedhje kaq e madhe e energjisë, ne nuk mund ta stabilizojmë energjinë në vend me një sfidë, që po përcillet vit pas viti e që janë humbjet.

Duhet ta kenë parasysh të gjithë qytetarët, ndërrimi i njehsorëve, e shihni në këtë dokument, rezulton edhe në rritjen e ndjeshme të faturimit të energjisë elektrike. Dhe, ka pasur problem pastaj aty ku thuhet edhe një dokument tjetër të rëndësishëm, që është i Rregullatorit të Energjisë Elektrike, ka pasur problem pastaj edhe ta kuptojnë qytetarët dallimin në mes të njehsorëve të rinj dhe të vjetër, sepse me njehsorët e vjetër ka pasur mundësi toleromi t' i ndërrojnë ato me të natës dhe të ditës dhe, kështu kemi pasur një problem në këtë drejtim.

Sido që të jetë, unë parapëlqej që Zyra e Rregullatorit të Energjisë të vazhdojë të merret edhe më shumë me këtë çështje. Unë e kam po ashtu, edhe një dokument të ditës së djeshme të Rregullatorit, do të kërkoj që ky raport, që është raport informues për pakënaqësitë e konsumatorëve të krijuara nga faturimet e janarit 2013 e që ka edhe disa rekomandime, t'u shpërndahej edhe deputetëve. Është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe po ashtu, edhe Bordi i KEK-ut në masat që duhet me i marrë sipas sugjerimeve të ministrit, duhet të bazohet nga disa konkluzione, të cilat i ka dhënë Rregullatori i Energjisë e të cilat konkluzione janë jashtëzakonisht shumë racionale dhe që janë në përputhje me dispozitat në fuqi, që kanë të bëjnë me leximin e faturimit, që kanë të bëjnë me njehsorët, që kanë të bëjnë me kujdesin e ndërrimit të njehsorëve, pastaj edhe te kërkesat e konsumatorëve, e tjerë.

Duhet ta them edhe një fakt tjetër, që numri i ankesave të konsumatorëve në këtë vit, nuk ka qenë më i madh se numri i ankesave të vitit të kaluar. Domethënë, është një proces të cilin duhet trajtuar më seriozisht, për shkak se ka pasur një rritje të faturave, por kjo nuk mund të konstatohet ndryshe, përderisa nuk kemi gjetje nga organet e caktuara.

Mos të harrojmë se pasi ka dalë publike kjo çështje, kemi pasur një informatë publike, po ashtu që edhe njësia e krimeve ekonomike ka qenë e involvuar në këto. Ne duhet ta dimë a kemi edhe rezultate të kësaj natyre. Nëse kemi duhet të merren masa. Në raste të tilla, mandej edhe shkarkimi nuk është i mjaftueshëm i zyrtarëve, qoftë menaxherial e tjerë. Por gjithsesi, gjithçka që mund të thuhet deri më tash, mbetet në nivelin e menaxhimit

ose në nivele menaxheriale dhe nuk ka të bëjë fare me përgjegjësi të tjera, të cilat sot u thanë në Kuvend e mendoj që nuk e ndihmojnë aspak këtë proces.

Unë kërkoj, që ministri, meqenëse është edhe kompetencë ligjore, sa më shpejtë është këtë vit ta sjellë edhe rishikimin e strategjisë për energji dhe po ashtu, nëse ka nevojë, sot prej deputetëve u tha edhe rritja e tarifës. Ju e dini që rritja e tarifës është bërë mbasi që ne në këtë Kuvend e kemi aprovuar tantimën. Pra edhe ju e dini fort mirë se si ka qenë ai debat. Askush nuk e ka potencuar këtu që me ndryshimin e tatimeve të mineraleve do të ketë, do të pasojë edhe ose shumë pak është biseduar kjo. Nëse është e nevojshme, ne duhet të debatojmë edhe gjatë trajtimit të rishikimit të strategjisë së energjisë, ndoshta edhe të thërrasim debat të veçantë edhe për tantimat, të cilat i paragjykojnë në njëfarë mënyre tarifat e energjisë elektrike. Faleminderit!

KRYETARI: E ka fjalën Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar, faleminderit!

Kolegë deputetë,

Për Qeverinë çka të them, ministri po lodhet nganjëherë po bën pushim, po besoj që dikush na dëgjon, se ai ka ekip, po ma merr mendja, që janë të përgjegjshëm, dikush na dëgjon.

Çështja për të cilën do të flas unë nuk ka të bëjë vetëm me profesionale, se unë inxhinier nuk jam. Kur më intereson i pyes ata që i dinë këto punë, nëse i kam njerëz që i njoh, po kjo që do të flas unë ka të bëjë me ne këtu, pavarësisht prej profesionit edhe zanatit.

Është bërë modë këtu që ministrat vijnë herë pas here dhe kur nuk japin përgjigje për pyetjet që u shtrohen, na tregojnë qysh agjencitë e pavarura janë të zgjedhura nga Kuvendi dhe Kuvendi le t'i thërrasë dhe le të marrë llogari prej tyre. Kjo është bërë bajate, për një arsye.

Për arsyen fillestare se ato që ne i quajmë agjenci të pavarura me rregullativat në fuqi, që të gjitha i propozon Qeveria dhe të gjitha ky Kuvend i zgjedh me shumicën relative, që i bie me shumicën e të pranishmëve që votojnë, që i bie pozita.

Pra, nëse doni quani agjenci të varura, nëse doni të pavarura, ato janë të varura më së pari prej Qeverisë, tani prej Kuvendit po prej pozitës. Dhe, këtë duhet ta dinë edhe qytetarët edhe deputetët këtu, ata që s'e kanë parë e shohin këtu e tutje, ose kanë mund ta shohin, kur të donë, mund ta vërtetojnë. Prandaj, nuk është kurrfarë mjeshtërie, kurrfarë bravure të foluri po të thuhet kjo.

Këtu sot gjithë kohën ministri e gjuan topin te Rregullatori, Zyra e Rregullatorit, po edhe Zyrën e Rregullatorit, kush e ka zgjedhur, qysh është zgjedhur, kush është zgjedhur? S'është moti, se janë ndërruar gati të gjithë e ju e dini.

Edhe KEK-u, tash po e heq problemi prej KEK-ut te Rregullatori, po edhe KEK-u, meqë është ndërmarrje publike ose shtetërore po i themi, se njësoj i bie, atëherë bordet e tij

kush i zgjedh? Qeveria është shef i aksionarëve, bordi është i zgjedhuri i Qeverisë, drejtori ekzekutiv është i zgjedhuri i bordit. Qysh t'i thoni, ajo është ndërmarrje që qeveriset direkt ose indirekt prej Qeverisë, indirekt Kuvendi e kontrollon qysh e kontrollon Qeverinë.

Sipas kësaj logjike, tërë kohën ne mund t'i themi edhe ministrit edhe Qeverisë: “O zotërinj po ju jeni që ju kemi zgjedhur ne.”, pra hiç nuk shkojmë te Rregullatori, se i kemi më afër këtu, dy metra. Kështu që, nuk është mirë që të derivojë debati ku s'ka nevojë të shkojë.

Problemi i energjisë është problem i madh dhe nuk ka kurrfarë mbulese nëse thuhet e kemi një strategji që ka kaluar në Kuvend. Mirë de ka kaluar, po punë e madhe, nëse s'funksionon, pse ajo strategji a është tabu a? S'funksionon, s'është kryer, e ndërrohet. Çka po do? A po do ta trajtohet energjinë si element themelor të shtetësisë së Kosovës, a jo? Ne, aset prodhimtar pos asaj energjie, pak send kemi! Jo, s'e kemi marrë, kemi vendosur ta shesim, ta privatizojmë, është problem tjetër teoria e privatizimit dhe është problem tjetër ta shesim sa të qëllojë.

Dhe, a respektohen procedurat? Është problem ta shesim me blerës preferencialë pa konkurrencë të vërtetë, që i bie ta falim, për të bërë dallavere i bie. Nuk domethënë pse thua “po dua ta privatizoj”, për ta bërë siç thonë “rrush e kumbulla”, se kjo është pjesë strategjike e këtij vendi. Nëse e shet kaq shumë që fiton shumë para dhe i investon në zhvillim, në rregull, le të bisedojmë për këto.

Por jo, shpeshherë thuhet, do ta privatizojmë, se bordet vendëse nuk po e udhëheqin mirë. Zoti na ruajt, po ajo domethënë për ta shitur shtëpinë, se s'di ta udhëheqësh shtëpinë tënde, bëhesh horë. Është me rëndësi ta dimë a është strategjike, a nuk është? Nëse e shesim, me çfarë kushtesh, kujt?

Këto janë probleme që shtrohen sot, sepse unë s'dua të flas për fatura, s'dua asnjë fjalë ta them, se fatura është shkak i pakënaqësisë, po është pasojë e gjendjes. Mos të bëhemi ne imtësor dhe të themi se e ka shkruar në vend 23 euro, 25, e është bërë nami. Nuk është ky problemi, problemi është më thellë. Edhe borxhet, kush i ka KEK-ut borxh, le të dalë, mos të na flasin me figura. Le të dihet kush i ka borxh, KEK-ut. Dihet, që minoritetet shumica sot s'e kanë paguar, dihet që institucionet s'e kanë paguar. Dihet që harxhuesit e amvisërisë janë paguesit më të rregullt dhe më “frikacakët” kushtimisht po e quaj, se e paguajnë çdo muaj, se s'e mbërrijnë. Dhe, ata që i marrin borxhet janë të mësuar, e lypin aty ku paguhet, diku s'guxojnë të shkojnë hiç, besa diku i këpusin. Te ata që paguajnë rregullisht, ia këpusin për një muaj, te ata që s'paguajnë kurrë s'ia këpusin kurrë!

Këtu kemi të bëjmë tash edhe me etikë të veprimit. Të gjitha këto janë probleme. Nuk është kjo çështja që kështu që i bie që ai, që është i rregullt, që është institucionalist, që është qytetar i vërtetë, është i dëmtuar, kjo është e vërteta.

Kështu që unë dola veç këto çështje t'i them. Për në fund, zoti kryetar, unë e kam një sugjerim, por kur të vijmë në fund për të dyja këto që i diskutuam sot, nëse ma jepni fjalën, do ta them edhe një fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Të gjithë të lajmëruarit për debat janë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Po shkojmë me rend. Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryetar!

Megjithëse e kam kërkuar fjalën shumë më herët, tash ma dhatë fjalën. Faleminderit!

I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Krasniqi,

Të nderuar ministra, edhe pse s'qenka asnjë, me siguri siç tha edhe zoti Hamiti na shikojnë në televizor ndokund.

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Meqenëse, deri më tash të gjitha fjalët që patën të thuhesh u thanë, unë do ta dorëzoj me shkrim fjalimin tim. Faleminderit!

Pjesë e diskutimit, e dorëzuar me shkrim

Pardje e kishim një protestë të qytetarëve me moton "Ndale hajninë, zhvilloje shtetin!". Po ashtu, tashmë gati një muaj po protestohet para ndërtesës së Korporatës Energjetike të Kosovës për shkak të faturave të fryra për energjinë elektrike. Pa marrë parasysh numrin e pjesëmarrësve të protestës së të mërkurës, apo të atyre para sporteleve të KEK-ut, qytetarët me arsye janë të brengosur për gjendjen e përgjithshme ekonomike e sociale, për nivelin e lartë të korrupsionit, për jokorrektësinë që po tregojnë ndaj tyre institucionet e pushtetit dhe ofruesit e shërbimeve publike.

Është karakteristikë se këto protesta në thelb janë të karakterit jopolitik, pa marrë parasysh se ka vlerësime dhe përpjekje që ata qytetarë t'i radhitin përkrah ndonjë subjekti politik, apo si kundërshtarë të këtij formacioni qeverisës.

Për këtë arsye, edhe nuk duhet të befasojnë kërkesat për dorëheqje. Ato duhet të kuptohen, së paku si një mesazh - kërkesë për vlerësimin e punës së disa resorëve qeveritarë dhe për përmirësimin e gabimeve, nëse ato kanë ndodhur.

Në fakt, gabimet po ndodhin secilën ditë. Bllokimi i procesit të zhvillimit dhe të përmirësimit të gjendjes sociale për shkak të korrupsionit dhe veprimeve të paligjshme nuk është vetëm gabim, por edhe mëkati më i madh që bëhet ndaj qytetarëve të këtij vendi.

Të nisim nga shkaqet që e nxitën këtë protestë dhe këtë debat. Ishte kostoja mjaft e lartë që qytetarët në muajin janar, por edhe në shkurt, paguajnë për energjinë e shpenzuar. Faturat u cilësuan si të fryra, në shpërputhje me shpenzimin real dhe veprim i qëllimshëm i KEK-ut, ashtu që të arkëtojnë sa më shumë para. Sa do që KEK-u fillimisht u arsyetua me faktin se në faturat e janarit janë përfshirë edhe tri ditë të festës, më vonë e pranoi se ka pasur gabime, por jo në masën aq të madhe.

Do të thotë se paska gabime, e ato nuk janë në numër të madh, meqenëse edhe numri i ankesave ka qenë minor, në krahasim me numrin e konsumatorëve që ka kjo kompani.

E dyta, nuk mund të pajtohem me faktin se edhe gabimet janë të mundshme dhe të natyrshme, siç deklarojnë zyrtarët e KEK-ut. Kjo nuk guxon të ndodhë për shkak se secili gabim në faturë, apo në leximin e gjendjes në njëhisorë e atakon buxhetin familjar të konsumatorit. Po ashtu, dyshimin se gabimet në fatura mund të jenë edhe të qëllimshme, e tregon fakti se asnjëherë nuk është faturuar më pak se që ka qenë gjendja reale, por gjithmonë më shumë se kjo.

E treta, KEK-u nuk guxon të gabojë, meqenëse punëtorët e saj duhet të dëshmojnë profesionalizëm, korrektësi dhe respekt ndaj konsumatorit. Kjo nuk po ndodh, e as që do të ndodhë, pos ndoshta kur pronari i ri e merr Distribucionin. Atëherë ndoshta ai e ndryshon qasjen ndaj tregut dhe ndaj konsumatorëve.

Të gjitha këto të këqija ndodhin para syve të ministrisë përkatëse dhe tërë Qeverisë. Ato nuk mund të arsyetohen, duke thënë se të gjitha këto janë çështje me të cilat duhet të merret stafi menaxhues i KEK-ut.

Mirëpo, çfarë pune bënë bordi dhe mekanizmat e tjerë mbikëqyrës për punën e KEK-ut dhe për raportet e tij me konsumatorët?

Në këtë situatë, Ministria për Zhvillimin Ekonomik, në vend se ta aktivizojë tërë mekanizmin e kontrollit dhe të auditimit, ajo formon komisione, të cilat në fakt nuk kanë asnjë mbështetje ligjore, e as kompetencë për të ndërmarrë diçka. Ato, siç u tha, mund të shërbenin si logjistikë për trajtimin e çështjes, apo si një trup konsultativ. E, në të vërtetë komisione, apo këshilla të këtyllë u formuan vetëm sa për të thënë se ministria po punon diçka, apo se ajo po brengoset për fatin e konsumatorëve të mllëfosur.

Gjatë këtyre protestave është vërejtur edhe një detaj, nëpërmjet të cilit qytetarët kanë treguar mirëkuptim për gjendjen në të cilën është KEK-u dhe energjetika, në përgjithësi. Ata nuk e kanë kontestuar aq shumë çmimin e energjisë elektrike, por vjedhjen që po u bëhet nëpërmjet faturave. Ata janë të shqetësuar se pas privatizimit të Distribucionit, pronari i ardhshëm mund të mos e ketë në konsideratë momentin social në Kosovë. Kjo është e kuptueshme, meqenëse pasi secili investitor këtu vjen për fitim, të cilin do ta arrijë nëpërmjet mallit, apo shërbimeve që shet.

Për shkak të situatës delikate dhe të rëndë sociale, pastaj paralajmërimeve për shtrenjtim të madh të energjisë elektrike, ZRRE-ja duhet të tregohet e përgjegjshme dhe të mos bjerë nën ndikim, apo nën presionin që do ta bëjnë operatorët. Ajo gjithmonë ta ketë parasysh se Kosova është vendi më i varfër në Evropë, prandaj popullata e saj nuk mund ta përballojë nivelin e çmimeve që janë në vendet e rajonit.

Për protestë, por edhe për debat ka edhe përplot gjëra të tjera që po ndodhin në KEK dhe në energjetikë, në përgjithësi. E para është mënyra dhe çmimi me të cilin është shitur Distribucioni. Pa transparencë dhe pa dhënë se paku një informim formal para Kuvendit

të Kosovës. Pas këtij procesi, përkatësisht pak muaj para se kjo pasuri t'i dorëzohet pronarit të ri, KEK-u nis implementimin e projektit për instalimin e orëve digjitale, të cilat edhe pak ditë nuk do të jenë aset i saj. Është e palogjikshme që të investohet në modernizimin e sektorit për të cilin është nënshkruar kontrata e shitjes.

Edhe më shumë duhet të shqetësojë fakti se përkundër investimeve shumë të mëdha, gjendja në KEK nuk po ndryshon. Të përmendim se sipas disa të dhënave për 13 vjet në këtë korporatë janë investuar hiç më pak se një miliard euro, qoftë si para që kanë shkuar nga Buxheti i Kosovës, apo si donacione.

Kjo shumë e parasë nuk solli siguri në sistemin energjetik, asnjë kilovat më shumë prodhim, e as furnizim të rregullt.

Pastaj, edhe pas këtij miliardi të shpenzuar, KEK-u ende është pengesa kryesore për zhvillimin ekonomik të vendit, meqenëse pa energji nuk mund të ketë zhvillim.

Në vend të kësaj, KEK-u mbeti vendi më i përshtatshëm për punësimin e familjarëve dhe të të preferuarve të partisë në pushtet, vendi ku mund të shpërblehen me tenderë ata që e financuan fushatën parazgjedhore të partisë në pushtet dhe vendi ku mungon llogaridhënia për dështimet e njëpasnjëshme.

Duke e pasur parasysh këtë situatë, problemin nuk duhet kërkuar brenda KEK-ut, ndërsa Qeveria, përkatësisht ministria përkatëse nuk mund të arsyetohet me suspendimin e disa menaxherëve të nivelit të ulët. Problemi nuk qëndron vetëm brenda KEK-ut, por te ata që e kanë pushtetin mbi KEK-un. E ajo është Qeveria e Kosovës, e cila nuk ka vizion se si të tejkalohet kjo situatë, pos duke i falur asetet publike, tenton ta largojë përgjegjësinë e saj.

Kësaj nuk mund t'i thuhet asgjë tjetër, pos mosdije për të menaxhuar me sektorin që ka ndikim në zhvillim dhe në gjendjen sociale në vend.
Faleminderit!

Hashim Deshishku, d.v.

KRYETARI: Deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

E vërtetë që u thanë shumë dhe do të provoja, që të mos e zgjas. Pra, ishin faturat ato si një shkas që rritën interesimin që të diskutohet rreth energjisë elektrike. Dhe, është shumë e çuditshme se si është menaxhuar ajo situatë, pasi që ka dalë gjithë kjo.

Është pranuar nga KEK-u, është thënë 4 ditë, pastaj është thënë 6 ditë, se ka pas tejkalim të ditëve dhe për çudi që nuk ka dalë një ide, që për aq ditë sa ka qenë tejkalimi dhe një pjesë e qytetarëve janë futur në një tarifë, që në mënyrë jo të drejtë i ka ngarkuar, pse nuk është dalë menjëherë të nesërmen me një propozim, që në mënyrë proporcionale për aq ditë të zvogëlohen faturat dhe ta krijojnë qetësinë tek qytetarët.

Mirëpo, ajo gjendje e tillë ka krijuar një mosbesim. Po edhe disa diskutime, që sot ishin këtu, prapë krijojnë një dilemë. Me këtë interesim të shtuar, pavarësisht se a është thënë edhe ndonjëherë diçka, është një rast i mirë, që këtë herë të shkohet përtej faturave, të bëhet temë çështja e energjisë dhe të sqarohen qytetarët për ato që i kanë dëgjuar, por edhe shumë çështje tjera, që edhe deputetët në realitet nuk i dimë.

Ne nuk dimë shumë, se pse Kosova e blen rrymën më shtrenjtë se të gjithë të tjerët. Sigurisht që nuk ka planifikime të mira, prandaj kur e blenë ad hoc brenda muajit, normal që e blenë më shtrenjtë.

Prandaj, kemi të drejtë të informohemi edhe ne si deputetë, po edhe qytetarët. Kemi të drejtë edhe ne ta dëgjojmë, se a është profitabil prodhimi i energjisë elektrike, sepse kemi termocentralet A dhe B. Nëse është profitabile, çka presim që kaq vjet që nuk fillohet me C-në, që të rritet, rritet prodhimi dhe të mos blihet energjia elektrike me ato çmime.

Dhe, shumë e shumë çështje tjera, që u thanë këtu deri te përlogaritja, plotësisht pajtohem që po të marrim dhe të shikojmë se sa qytetarë paguajnë deri në 200 KW, sa deri në 600 dhe mbi, del se çmimi i energjisë elektrike nuk është ai për të cilin ne nganjëherë diskutojmë, në të vërtetë është shumë i madh. Aq më parë, kur dihet se Kosova është prodhues në masën që është dhe, kur dihet se ka resurse aq të fuqishme.

Edhe unë e përshëndes iniciativën, që të formohet një grup i cili do të ndihmonte temën. Posaçërisht pse e përshëndes, në mënyrë që të mos ketë pretendime që brenda kësaj seance të japim konkluzione, që dikush mund të thotë se janë joreale dhe nuk iu kanë nënshtruar një informimi dhe një analize më të mirëfilltë.

Dhe, pikërisht ky komision do të rikthehet në këtë Kuvend dhe pas bisedave me aktorët dhe me ministrinë e me Zyrën e Rregullatorit, me bordin dhe me menaxhmentin. U tha këtu, se janë marrë masa ndaj menaxhmentit, mirëpo ndoshta një ditë në Kosovë do të vijë rendi, që do të thuhet janë marrë masa, është kërkuar përgjegjësi edhe nga bordet, të cilat u kënaqën. Askund bordet... janë një mes i shkëlqyeshëm në mes të atyre që i emërojnë dhe ata që i komandojnë. Dhe, gjithnjë bordet dalin diçka shumë e mirë, që në realitet paguhen mirë, pikërisht për këto çështje që të mos vijë deri te këto situata problematike.

Prandaj, unë i përshëndes formulimet e Komisionit dhe pres që ky komision me të gjithë aktorët do të punojë mirë, do të kthehet në Parlament me gjithë analizën e nevojshme, që pastaj të kihet konkluzione dhe të qartësohet se cilat janë ato politika, çka pret qytetari në afat të shkurtër dhe në afat të mesëm, komplet për çështjen e energjisë, si dhe të jepet iniciativa, që për aq ditë sa ka qenë ngarkesa në ditë të rikthehen faturat në mënyrë proporcionale. Pra, nëse 6 ditë ka qenë ngarkesa, për 6 ditë të kthehen mbrapa dhe tash e tutje, pra të mos krijojmë situata që të rrisim pakënaqësinë e qytetarëve në energji, se edhe ashtu kemi dilema: sa e paguajmë, si e furnizojmë dhe si e menaxhojmë? Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dua të theksoj se në tërësi i përkrah rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, të theksuara në kërkesën për këtë debat.

Rekomandimet e tilla i përkrah për arsye se jam i bindur se me ndihmën e tyre do të mbrohen qytetarët e Kosovës nga parregullsitë e KEK-ut, pasi që mbrojtja e të drejtave dhe interesave të qytetarëve në çdo sferë të jetës është obligim dhe duhet të jetë prioritet i këtij Kuvendi.

Vërtet, kur më datën 7 shkurt 2013 në gazetën “Zëri” në artikullin “KEK-u sakaton konsumatorët”, lexova se një qytetari të Fushë Kosovës i kishte ardhur fatura në shumë prej afro 800 eurosh për rrymën e shpenzuar në një banesë, pata mbetur i habitur se si është e mundur që në Kosovë për një muaj dikujt t’i faturohet një shumë aq e lartë.

Mirëpo, fatmirësisht qytetarët tanë të ndërgjegjshëm reagojnë shpejtë dhe për një kohë të shkurtër në drejtim të KEK-ut adresuan mbi 3800 ankesa, të cilat fillimisht u kontestuan nga zyrtarët e KEK-ut. Po, me kalimin e kohës dhe nga presioni i protestave të vazhdueshme të qytetarëve filluan të dalin në pah faktet të cilat tregojnë se pakënaqësia e qytetarëve ndaj KEK-ut ishte e bazuar dhe e drejtë. Se qytetarët ishin dëmtuar nga veprimet e KEK-ut dëshmon edhe raporti i ZRE-së i përpiluar gjatë muajit shkurt, në të cilin ndër të tjera thuhet: “katër ditë të dhjetorit janë faturuar në muajin janar, kështu që fatura e janarit është bërë për 34 deri në 36 ditë, e që ky dallim në lexim ka shkaktuar efekte negative për konsumatorë.”.

Mirëpo, edhe vetë rezultatet e shqyrtimit të ankesave nga KEK-u, tregojnë se qytetarët ishin dëmtuar nga veprimet e KEK-ut, që unë në një paraqitje të mëparshme në këtë Kuvend i pata quajtur “veprime kriminale”, sepse sipas deklaratës së drejtorit menaxhues të KEK-ut, në një takim me përfaqësues të medieve, gjatë muajit shkurt janë paraqitur 3 mijë e 804 ankesa lidhur me faturat e muajit janar. Prej tyre 980 apo 26% janë zgjidhur në favor të konsumatorëve.

Veprimi, me të cilin sillet në lajthim personi, për çka ai person në dëm të pasurisë së vet paraqet veprën penale të mashtrimit, kurse veprimet me të cilat kryhen veprat penale, përfshirë këtu edhe vetë veprën penale të mashtrimit quhen “veprime kriminale”. Dikush do të thotë se nuk është bërë dëm i madh, nëse qytetarit i faturohen 36 ditë brenda muajit, apo nëse qytetarit i faturohet rryma në mënyrë paushalle. Por vërtet, sikur rryma të paguhej me një tarifë apo çmim të vetëm, vërtetë nuk do të ishte ndonjë problem i madh, sepse nëse do të ishte paguar diç më shumë në muajin shkurt, atëherë në mars do të mbetej për pagesë një shumë më e vogël. Por, problemi është bllok- tarifa, sepse kujtdo që i faturohen më shumë se 600 KW në muaj, ai përveç rrymës së shpenzuar duhet të paguajë edhe një shumë shtesë në emër të penalizmit, që ka harxhuar më shumë rrymë elektrike.

Kjo rregull në pagesë dhe faturim, përveç që i mundëson KEK-ut, që të dëmtojë konsumatorin, është edhe anakronike dhe e pakuptimtë për ekonominë e tregut të lirë,

sepse në çdo treg të botës, konsumatori i cili blen sasi më të madhe të mallit, përfiton lehtësira apo benificione të caktuara nga shitësi, qoftë në çmim, kualitet apo sasi të mallit, kurse te ne KEK-u i penalizon ata që harxhojnë sasi më të madhe të rrymës.

Mirëpo, KEK-u plaçkit me milionë euro nga konsumatorët edhe përmes tarifës fikse. Sipas ekspertëve të energjetikës, mbi 1 milion euro në muaj KEK-u merr nga konsumatorët për një tarifë fikse që e fut në faturë pa marrë parasysh shpenzimin e konsumatorit. Kjo tarifë i ngarkohet konsumatorit nga KEK-u në emër të shpenzimeve, që bën KEK-u gjatë leximit dhe përpilimit të faturave. Kjo tarifë për konsumatorët e amvisërisë është 2,27 euro në muaj, kurse për konsumatorët komercial është prej 2,81 – 3,18 euro dhe me këto tarifa fikse ngarkohen as më pak e as më shumë, se 459 mijë konsumatorë, sa ka gjithsej KEK-u.

Me bllok-tarifa, me tarifa fikse, me çmime të ndryshme jounike për një kilovat, KEK-u ngarkon konsumatorin me barrën e të gjitha dështimeve të veta, por edhe dështimeve të institucioneve qeveritare dhe gjyqësore. KEK-u gjatë një viti ka humbje të mëdha teknike komerciale dhe humbje në transimion, pjesën më të madhe të cilave ia ngarkon konsumatorit të ndërgjegjshëm përmes faturave. Madje, konsumatorit të ndërgjegjshëm i faturohet edhe energjia elektrike, me të cilën furnizohet veriu i Kosovës, atje ku KEK-u tash e një kohë të gjatë nuk ka qasje fare.

Sipas ekspertëve, nëse një qytetar ka një faturë prej 50 euro në muaj, atëherë ai ka paguar 16 euro apo afro 32%, për të mbuluar këto humbje të shkaktuara nga paaftësia e menaxhmentit të KEK-ut, kurse 34 euro ka paguar për energjinë që e ka shpenzuar.

Pra, konsumatori është viktimë e veprës penale të mashtrimit. Pra, konsumatori është ai që i faturohen të gjitha lëshimet, gabimet, humbjet që bëhen nga menaxhmenti i KEK-ut. Andaj, kërkoj nga deputetët e Kuvendit, që t'i aprovojnë rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i LDK-së, me shpresë që do të formohet Komisioni ad hoc i Kuvendit, i cili do të kryejë punën e vet me nderë dhe më në fund ta lirojë qytetarin tonë nga tarifa të ndryshme, nga ngarkesat e humbjeve të KEK-ut, me të cilat në mënyrë serioze cenohet buxheti edhe ashtu i rrënuar familjar. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Këtu u diskutuan shumë tema, mirëpo unë po tentojmë që të jem i drejtpërdrejtë në atë, që unë mendoj se është e rëndësishme të thuhet dhe për mendimin tim nuk u tha.

Nuk u përmendën disa tema të rëndësishme, që është te furnizimi elementi i parë dhe kryesor, monopoli i prodhimit dhe në të njëjtën kohë monopoli i furnizimit nga blerjet në tregun ndërkombëtar.

Ne e dimë se monopolin e prodhimit këtu deri tani e kanë termocentralet e Kosovës, ndërsa monopolin e furnizimit nga tregu ndërkombëtar unë nuk e di se kush e ka, por e di

se është monopol. Dhe, e di që është monopol dhe këto grupe që e kanë këtë monopol janë shumë të lidhura me kryeministrin e vendit.

Sa i përket procesit të privatizimit, ne e dimë që është diskutuar shumë dhe është thënë shumë, se ky proces i privatizimit ka dëmtuar interesin e Kosovës, sepse çmimi i shitjes ka qenë shumë i ultë dhe në të njëjtën kohë interesi i qytetarëve të Kosovës nuk është mbrojtur.

Te çmimi dhe tarifat u fol shumë dhe u diskutua, nuk do të thellohem këtu, por unë do të thellohem te një element tjetër, te kualiteti i energjisë me të cilën furnizohen qytetarët e Kosovës.

Këtu u tha, se nuk paska më gjeneratorë nëpër rrugë dhe energjia elektrike nuk po u ndërpreka! Unë nuk e di se ku po jetuakan këta njerëz?! Nëse shkoni në Pejë, në Deçan, në Gjakovë apo në Llap apo në Anamoravë, ju e shihni se ka ndërprerje të energjisë elektrike dhe ka edhe gjeneratorë. Dhe, po na quhet si sukses i madh që në vitin 2013 po mundka të ketë furnizim me energji elektrike 24 orë. Ky nuk është kurrfarë suksesi, sepse tregu ndërkombëtar ka energji elektrike sa të duash dhe mund të blesh energji elektrike, sa të duash e të mos prodhosh hiç dhe çmimi del më i ultë se sa është kjo që e prodhon ky monopoli ynë dhe blerjet që bëhen me kompani që e kanë monopol.

Këto blerje, aty është kriminaliteti te blerjet, sepse i prishin edhe termoelektranat për të mund të përfitojnë prej furnizimit me blerje. Kualiteti i energjisë elektrike, i cili furnizohet në shumicën e qyteteve, por sidomos në fshatra, ju e dini se aparaturat për të funksionuar aparaturat elektro-shtëpiake duan minimalisht 220 V energji elektrike dhe maksimalisht, më duket 240. A furnizon KEK-U me këtë me këtë energji 220 - 240 , besoj që nuk furnizon? A shkakton dëm, kur nuk furnizon, kur furnizon me më shumë voltazh apo më pak? Shkakton! Këtu është një marrëdhënie kontraktuale, e cila bëhet në mes KEK-ut dhe konsumatorit. A dëmshpërblen KEK-u për dëmin që i shkakton konsumatorit? Në marrëdhënie kontraktuale thuhet që KEK-u obligohet që të furnizojë me energji elektrike 24 orë me kapacitet 220 – 240 V. Po flas për amvisërinë. Dhe, në këtë rast, nëse KEK-u nuk furnizon 24 orë, kush penalizohet? A penalizohet KEK-u, apo konsumatori? Dhe, nëse KEK-u nuk furnizon me energji kualitative 220 - 240 volt, kush penalizohet? Penalizohet konsumatori. Dhe në këtë rast, a dëmshpërblehet konsumatori, në qoftë se i digjen të gjitha aparaturat në shtëpi? Nuk dëmshpërblehet. Kjo është logjika e mbrapshtë, që është ndërtuar në këtë vend.

Dhe këtu u tha, se përgjegjësi për këto çështje po i takuaka Kuvendit, se Kuvendi po e zgjedhka Entin Rregullator, se Enti Rregullator po i propozuaka Qeverisë, e Qeveria mandej po e marrka parasysh. Juve ju kujtohet, që nuk ka shumë gjatë, kur u tentua - propozoi Enti Rregullator i Energjisë Elektrike, që të rritet çmimi i energjisë elektrike dhe me një fjalë të kryeministrit të vendit u tha që nuk do të rritet. Dhe, e ndaluan, bile ministri, nuk e di a ka qenë ky a ndonjë tjetër, shkoi ndërhyri dhe tha: “Nuk bën të rritet çmimi hiç”, dhe nuk u rrit.

Kështu që, këto ‘foret’ e përgjegjësisë ndaj Kuvendit, të paktën deputetëve të mos mundohen t’ua shesin, se ne e dimë qysh votohet, qysh shkojnë anëtarët nëpër borde, qysh shkojnë dje, për shembull guvernatori, kush u zgjodh dhe e dimë qysh zgjidhet edhe Qeveria vetë edhe Qeverinë e zgjedhë kuvendi. Tashti fajin e paska Kuvendi për Qeverinë. Po, Kuvendi është i ndarë, ka pozitë dhe opozitë dhe përgjegjësia edhe për energjinë elektrike edhe për abuzimin me energji elektrike edhe për abuzimin e fatura është e atyre që e kanë përgjegjësinë për të qeverisur. Dhe, kjo është e vërteta.

Këtu u tha sot se menaxheri ekzekutiv, më duket ishte titulli, i KEK-ut është propozuar nga Qeveria që të shkarkohet, le të shkarkohet. Po kërkohet një “kokë” turku. Le ta bëjnë, le ta “presin”! Dhe në këtë rast po e “presin” atë “kokë”. Është shprehje ndërkombëtare, që ju ndoshta s’e kuptoni. Dhe, po e presin atë kokë, mirëpo ata që e presin le ta dinë, se në popull është një shprehje, që thotë: “Çka shkon rrotull, kthehet dikur”, kështu që do t’ju kthehet edhe këtyre në kokë të veten. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka, tash erdhi me vonësë, Ardian prit edhe pak, po ia japim Bahri Thaçi, se e kemi pas në rend.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Përsëritje, zoti Mujota dhe Beqaj!

Unë nuk do të ju marr shumë kohë, se të gjitha çka kisha për të thënë u thanë dhe punimin tim do ta dorëzoj me shkrim, por para se ta dorëzoj me shkrim, jo rastësisht e përsëritja ministrin Beqaj, me emër, sepse derisa nuk ishte në sallë këtu, kisha ndërmend ta përsëritja, por më dilyn dy Beqaj, njëri dje i cili deklaroi se unë nuk pash qytetarë të cilët kanë probleme me fatura dhe njëri sot, i cili thotë vërtet kishte pasur dhe ne i morëm këto e këto masa.

Mendoj që nuk ishte në përgjegjësinë e ministrit që të thotë se unë nuk i kam parë ato masa, ndërsa i kishte parë disa “dështakë politikë” dhe, mendoj që përsëri nuk është në përgjegjësinë e ministrit, që t’i akceptojë, t’i perceptojë ata dështakë dhe mos të perceptojë atë masë prej disa mijëra njerëzve, të cilët jo vetëm ata, por sigurisht që ata përfaqësojnë dikë, kryesisht janë përfaqësues të familjeve dhe është një masë shumë më e madhe, të cilët janë dalë për ta mbrojtur të drejtën e tyre legjitime.

Prandaj, unë kam një kërkesë të drejtpërdrejtë, e di që vështirë është të jepet dorëheqje nga posti i ministrit, por është një akt shumë i moralshëm dhe është një shembull i mirë për përgjegjshmërinë. Në qoftë se nuk mund ta bëjë atë, mendoj se është shumë e ndërgjegjshme dhe e mirë, për shkak të asaj që ka deklaruar dje publikisht, përsëri ta shfrytëzojë këtë foltore dhe të dalë e asaj mase t’i kërkojë falje, sepse ata njerëz i ka shtyrë zori për të dalë, kanë pasur një telashe të madhe, që ne vështirë se e kuptojmë, sepse gjendja materiale e jona sigurisht se nuk është e ngjashme me shumicën prej atyre, por ata kanë pasur një hall që kanë dalë për të mbrojtur të drejtën legjitime të tyre.

Dhe, mendoj që është diçka shumë e moralshme, në këtë foltore të dalë dhe t’u kërkojë falje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nëse nuk lajmërohet dikush tjetër, Ardian Gjini është i fundit prej diskutuesve.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Me kujdes e kam ndjekur diskutimin, për një kohë të gjatë mendoj se ajo që ka ndodhur dhe për çka po debatohet është tepër e qartë, për ta trivializuar krejt, ta themi thjesht ekzistojnë bllok-tarifat edhe shumë prej neve që jemi këtu në Kuvend, na kanë ardhur faturat më të mëdha, për shkak se nuk janë lexuar njehsorët dhe janë njehsorë e jo orë, se ora është njësi e kohës, ata janë njehsorë. Nuk janë lexuar njehsorët, për një muaj, dy ose tre, ose kanë ardhur në sistem të njëjtë dhe atëherë kur janë mbledhur kilovatët, konsumatorët kanë kaluar në bllok-tarifë dhe kanë paguar disa herë më shumë.

Edhe paramendoni sa u ka ndodhur qytetarëve shumë prej nesh këtu. Edhe paramendoni sa ju ka ndodhur qytetarëve, kur na ndodh edhe neve. Po, po më duket që në total kur po flasim për këtë temë, ne në Kosovë në njëfarë forme po shprehem edhe unë si parafolësit, gati popullorçe, po “e kapim problemin për bishti”.

Mendoj se nuk ka njeri në Kosovë, sidomos ata që kanë pak qasje në vendimmarrje, qysh janë deputetët në Kosovë e aq më tepër Qeveria dhe ministrat, që nuk duhet pyetur veten- Qysh bën në shekullin 21, vendi që fle në rezervat më të mëdha të thëngjillit në Evropë, të mos ketë rrymë?

Qysh bën vendi që i ka rezervat më të mëdha të qymyrit në Evropë, t’i pres malet për të djegur dru, t’i sakatojmë malet?

Nuk ma merr mendja që ka njeri që nuk ka pak përgjegjësi, sidomos po them ata që janë në Qeveri, të paktën të mendojë për këtë temë!

A jemi duke jetuar në shekullin e XV a të XIV, a kur jemi duke jetuar ne? Rrymë nuk kemi në Kosovë.

Tani ne mund të themi që KEK-u është katastrofë, KEK-u është një turp i madh. Mund të them që të gjithë ata që thonë, kanë të drejtë të thonë. Por, KEK-u është pronë publike, është pronë e jona, pronë me të cilën esencialisht menaxhon Qeveria e Kosovës dhe gjenerimi i energjisë për Kosovën nuk është temë e KEK-ut. KEK-u është një kompani. Ata gjenerojnë ose nuk gjenerojnë, punojnë me humbje ose nuk punojnë me humbje, mund të jetë e keqe e mirë, nuk është temë kjo. Po, tema e Kosovës duhet të jetë- qysh mund ne në shekullin 21, po kalon gati dekada e dytë, tash po hyjmë në mes të dekadës së dytë, të kemi problem me energji, të kemi me problem t’i furnizojmë njerëzit me energji elektrike?

Kurrfarë teme tjetër nuk duhet të na interesojë. Edhe njëfarë pyetje kështu, që del prej mllëfit të themi: “A jemi bre, normal?” Çka jemi kah flasim, ne për integritet evropian? Çka po flasim ne për luginat të silikonit? Çka po flasim ne për zhvillim ekonomik? Për çka po flasim, kur nuk kemi energji elektrike nëpër shtëpi?

Për të tjerët nuk është temë më, për pjesën më të madhe të botës, përpos ndonjë vendi të rrallë në Afrikë, nuk është as temë, a ka energji elektrike a nuk ka. E në vendin, që i ka rezervat më të mëdha të energjisë fosile është e vërtetë, thëngjill, 15 vjet pas lufte nuk

kemi mbërri t'i shtirë në sistem të pagesave njerëzit. 15 vjet nuk po mbërrimë t'i shtyjme njerëzit të paguajnë dhe nuk po mbërrimë ta bëjmë një kompani publike të sjellët normalisht, kur t'i mbledhë ato fatura, 15 vjet, edhe, po duam të bëhemi pjesë e Unionit Evropian. Qe 5 vjet shtet i pavarur, me projekt të gatshëm të energjisë elektrike. Kurrjë nuk kemi mbërri të bëjmë. Ka ardhur dikush, ka provuar të investojë, ka ikur. Kanë ardhur të tjerët, kanë ikur. Kurrkush nuk po mund t'i bjerë ra në fije këtij vendi, për energji.

Ma merr mendja, që Kosova kështu duhet menduar. Jo a i ka vjedhur KEK-u do mjete, se i ka vjedhur, është e vërtetë, vjedhje është t'i fusë në bllok-tarifë konsumatorët, për shkak se inkasanti nuk e ka lexuar njehsorin. Është vjedhje e pastër, është vjedhje e konsumatorit.

Po, kjo nuk është problemi kryesor, problemi kryesor është që ne kemi ngelur, na ka ngecur truri diku, sidomos njerëzve në Qeveri. Nuk janë kah dinë të kthjellën edhe të shohin ku janë edhe po flasin për integritet evropian. Mos bre, çfarë integritet evropian kur nuk kemi rrymë nëpër shpija! Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

XHEVAHIRE IZMAKU: I nderuari kryetar, deputetë,

Dy vitet e kaluara, në çështjet jashtë rendit të ditës kam ngrehur shqetësimin lidhur me furnizim me energji elektrike në të gjitha vendbanimet që i takojnë komunës së Vushtrrisë.

Qytetarët e komunës sime, bizneset dhe të gjitha kategoritë tjera ishin nën një jetë terri të pjesërishëm, por edhe aty ku kishte rrymë, kishte vende ku ishte jashtëzakonisht i dobët kapaciteti elektrik, mirëpo sot, kur e kemi një debat të tillë, që protagonist është Korporata Energjetike e Kosovës, ndihem e obliguar moralisht ta jap edhe anën tjetër të kësaj medaljeje, atë gjendje aktuale dhe reale, që vërtet është shumë e ndryshuar për të mirë.

Muajt e fundit të vitit të kaluar dhe këtë vit, Korporata Energjetike e Kosovës arriti të bëjë një përmirësim shumë të mirë të këtij furnizimi, dhe këtë e faktojnë qytetarët e krejt vendbanimeve të komunës së Vushtrrisë, duke shtuar furnizimin, por edhe duke përmirësuar rrjetin shpërndarjes në disa lokalitete, bashkë me vërejtjet eventuale.

Çështja e ngrehur lidhur me dyshimet për faturimin joreal të ditëve të fundit sigurisht se na takon ta debatojmë ne si deputetë në këtë Kuvend, të kërkojmë nga organet kompetente që ta përcjellin këtë lëshim teknik, qoftë gabim apo i qëllimshëm, duke kërkuar hetimin profesional nga organet kompetente.

Mirëpo, ditëve të fundit kam vërejtur se ky revoltim social, i prezantuar me protestat, edhe u përdor për një agjende politike, ku në mesin e protestuesve u panë figura politike aktuale, por të një klase që dështoi të qëndrojë në skenën politike, siç është Ilir Deda me shokët e tij, dhe disa të tjerë.

Aspak e çuditshme që sukseseve të institucioneve tona dikush me çdo kusht dhe në çdo rrethanë po mundohet t'ua nxjerrë vetëm anën e zezë, duke mohuar çdo gjë, e në çdo kohë, duke harruar se në këtë vend ka edhe shtylla tjera që shtetit i duhen të funksionojnë, agjenci të pavarura e sektorë të tjerë, që jo me çdo kusht lidhen për Qeverinë në suksesin a mosesuksesin e tyre.

Befasia ime ishte kur në atë proteste e pashë aktoren e re e të talentuar, Arta Dobroshi, sukseset e se cilës me kanë gëzuar dhe personalisht këtë admirim e kam përmendur kur më është dhënë mundësia, në medie e shoqëri, por edhe në takimet spontane, ndërkaq aktivitetin e saj artistik e përcjella live me gjithë vajzën time.

Arta Dobroshi në protestën e fundit po “aktronte” në shesh kundër “hajrave”, por edhe duke aluduar në një revolucion që, sipas saj, do të duhej të ndodhte që të shpëtojë ky vend nga “hajnia” e gjithkundshme.

Ndoshta edhe Arta po e lë aktrimin e po ja mësyn politikës, apo edhe një herë po i tregonte këtij vendi se kjo Qeveri nuk është ajo që do ajo!

Unë jam që të hetohet çdo proces që u sjell dëm qytetarëve dhe çdo individ që mund të përfshihet në të tilla raste, sepse qytetarët janë ata që në fund nuk e përballojnë koston e lartë jetësore, por ne, politika nuk kemi pse i referojmë ta shohin shtetin e vet vetëm zi, pra e them shtetin se nuk është Qeveria i gjithë shteti, por edhe aktoren time të preferuar Arta Dobroshi, me admirim do të shkoj përsëri ta shoh në kino, kudo qoftë, sepse shkëlqimi i saj është aty, ndërsa Ilir Deda dhe shokët e tij kanë akoma shans të provojnë. Mund të ndodhë që herën tjetër edhe ta kalojnë pragun zgjedhor, shpresa vdes e fundit thonë, përndryshe do t'u mbetet t'i shohë publiku vetëm në protesta, edhe kjo kur KEK-u eventualisht mund të gabojë në faturime, gjë që nuk do të na i mbyllë sytë asnjërit nga ne këtu, kudo qofshim partiakisht.

Faleminderit!

Xhevahire Izmaku, d.v.

Diskutim i dorëzuar me shkrim

BAHRI THAÇI:

Besoj që kjo temë është pika për të cilën nuk do të duhej të kishte ndarje ndërmjet opozitës dhe pozitës. Këtu nuk flasim për politikë, por flasim për diçka, e cila është shumë jetike për secilin qytetar të Republikës së Kosovës.

Menaxhimi i ndërmarrjeve publike edhe me Ligjin mbi menaxhimin e ndërmarrjeve publike është i Qeverisë dhe i takon asaj të kujdeset dhe të sigurojë që ato menaxhohen në të mirën e qytetarëve të vendit. Këto obligim, si duket, kjo Qeveri as për së afërmi nuk është duke e realizuar, andaj ndodhin këso lloj situatash, për të cilat reagimi qytetar është më se i domosdoshëm.

Ky keqmenaxhim nga Qeveria ka rezultuar që KEK-ut t'i lejohet të manipulojë me shifra, të cilat e kanë ngarkuar konsumatorin në mënyrë të padrejtë.

Të gjithë jemi të informuar që kjo Qeveri e ka nënshkruar një kontratë për shitjen e aseteve të Distribucionit dhe Shpërndarjes kompanisë turke “Limak&Çalik”. Shitja që është bërë është më shumë se qesharake (26,3 milionë euro) për të gjitha ato asete dhe pajisje, të cilat vetëm si hekurishte do ta kishin një vlerë dyfish më të madhe. Të mos të flasim për tokën dhe patundshmëritë tjera, të cilat lirisht mund të thuhet se i janë falur.

Ky keqmenaxhim vazhdon edhe më tutje, ku raportet e bëra publike nga shumë institucione të pavarura flasin për një favorizim të kompanive të lidhura me këtë pushtet kur janë në pyetje projektet kapitale të realizuara nga KEK-u. Është shumë evidente që nga këto raporte del që këto kompani në shumë raste janë pronë e njerëzve të fuqishëm të partisë në pushtet ose njerëz të afërt të tyre, e nëse nuk janë nga këto dy të parat, ato janë domosdo financuesit kryesorë të fushatave politike të partisë në pushtet.

Të gjitha keqpërdorimet tash janë duke u munduar që nëpërmjet fryrjes së faturave ta transferojnë si obligim shtesë për xhepin e qytetarit të Kosovës.

Duke filluar nga prilli i kaluar, kjo Qeveri mori vendim për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për 8,9%, që rezultoi me atë që çmimi i energjisë elektrike të jetë më i larti në regjion.

Edhe përkundër kësaj rritjeje të çmimit, tash po i lejojnë vetes që edhe nëpërmjet fryrjes së faturave ta rëndojnë edhe më shumë qytetarin e dërrmuar nga keqqeverisja dhe korrupsioni që po vazhdon çdo ditë në vendin tonë. Kjo dukuri do të vazhdojë edhe më shumë përderisa qeverisjen e vendit e kanë në dorë njerëz sikur këta.

Por, ky nuk është fundi. Tanimë KEK-u ka bërë kërkesë për ngritje shtesë të çmimeve të energjisë, duke filluar nga muaji prill i këtij viti. Kjo do të bëjë që jeta e qytetarit të rëndohet edhe më shumë.

Krejt në fund, është shumë e palogjikshme dhe amatore arsyetimi që KEK-u bën për gjoja korrektësinë e tyre gjatë leximit dhe faturimit të energjisë. Edhe një nxënës i shkollës fillore, me njohuri elementare të matematikës, ka mundësi t’i vërejë defektet që kanë ndodhur. Është e thjeshtë që faturimi i 33 ose 34 ditëve në raport me 31 ditë, sa ka janari, reflekton në një fryrje të faturës prej 15 deri 20 euro, varësisht nga niveli i konsumit të energjisë.

Dhuratat e tilla që do ta dërrmojnë qytetarin do të vazhdojnë edhe më tutje, përderisa këta njerëz udhëheqin me vendin.

Bahri Thaçi, d.v.

KRYETARI: Hydajet Hyseni shkurt, pastaj ministri.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit!

Bile edhe për këtë shkurt kërkoj ndjesë, se s’e kisha ndërmend të diskutoj. Do të ndalem vetëm te ndonjë çështje, po para së gjithash më lejoni t’ju përshëndes, ta përshëndes edhe debatin. Kam pritur që të fokusohemi në çështjen që është theksuar dhe në nismë.

Problemi me faturat që doli, nuk më duket në rregull që ta nis e të gjejë një pretekst, një vegzë e pastaj të bisedojmë për të gjitha çështjet, KEK-un, Ministrinë, Qeverinë e të tjera, sepse po shkapërderdhet dhe po druaj që kjo pastaj edhe po e ulë efektivitetin e debatit tonë, sidomos kështu siç po i bëjmë debat pas debati.

Megjithatë, s'mund të mos jemi në anën e qytetarëve të shqetësuar në këtë rast, por mendoj që përgjegjësia do fokusuar atje ku është, pa e shkapërderdhur.

E mbështes edhe idenë për të futur këtë në binarë institucional të shqyrtimit. Kuvendi funksionon jo veç me debate, funksionon me plenare po edhe në komisione. Komisionet do të duhej të përgatisnin edhe konkluzione të tjera. Megjithatë, edhe ideja që të bëhet një komision hetimor është parlamentare dhe është dëm që nuk e kemi shfrytëzuar sa duhet. Po më bën përshtypje që në nismën, referenca është vetëm te Kushtetuta, po jo te Ligji për hetimin parlamentar.

Ky Kuvend, jo vetëm që e ka miratuar, po e ka draftuar dhe e ka hartuar vetë Ligjin për hetimin parlamentar. Komisioni për hetimin parlamentar do të duhej të kishte për bazë këtë ligj. Dhe, po ta kishte këtë ndoshta gjithë qasja do të ishte më racionale. Nëse bëjmë hetim parlamentar, atëherë pse duhet të humbim aq kohë në debat. Le ta bëjë hetimin dhe pastaj rezultatin e hetimit ne do ta diskutojmë. Nëse ne e shterojmë debatin, atëherë pse hetimi, sepse debati shpeshherë i prejudikon, i prezumon edhe konkluzionet. Nuk them se duhet ta përjashtojmë patjetër, por një racionalizim na duhet. Hetimi parlamentar, madje mund të bëhet edhe pa debat.

Prandaj, propozimi im është që t'i kemi këto parasysht në të ardhmen, të mos i përgjithësojmë të gjitha dhe të jetë referenca ajo që duhet, te Ligji për hetimin parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Beqaj e ka fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit shumë, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministër,

Unë edhe një herë dua të falënderoj secilin prej jush për kontributin e dhënë në një debat jashtëzakonisht substancial, i cili preku shumë tema me interes, të cilat kanë rrjedhur edhe nga shqetësimi i qytetarëve.

Qeveria me përgjegjësinë e plotë ka marrë të gjitha masat, të cilat janë në kompetencë të saj konform raporteve ligjore, institucionale, profesionale të cilat kanë ardhur. Prandaj, unë do të jem i gatshëm, që çdo nismë e cila mund të dalë nga Parlamenti dhe e cila ka për synim përmirësimin e gjendjes së funksionimit të institucioneve, qoftë ai rregullatori, qoftë ndërmarrje publike, sigurisht që ne mund të kontribuojmë bashkërisht në këtë koncept.

Sigurisht, që koncepti i përmirësimit të jetës së qytetarëve është interes i të gjithë neve. Debat i shëndoshë dhe debati bëhet për përmirësim dhe Qeveria, Ministria dhe të

gjitha institucionet ne i përfaqësojmë, janë të gatshëm çdo moment për të bashkëpunuar, për të dhënë maksimumin tonë për të përmirësuar jetën e qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Debati ishte me të vërtetë i gjerë dhe tregoi që në lëmin e energjetikës janë edhe shumë tema tjera, të cilat duhet të analizohen edhe të debatohet për ato.

Dëshiroj të sqaroj që ne nuk e kemi kërkuar Komisionin Hetimor, por kemi kërkuar Komisionin ad hoc. Komisioni ad hoc nuk është hera e parë që po formohet në këtë mandat, i kemi dy komisione tjera. Komisionet për reformën zgjedhore dhe për ndërrimin e Kushtetutës, janë gjithashtu komisione të cilat e kanë shfrytëzuar mundësinë, e cila jepet prej Kushtetutës dhe prej Rregullores së punës për formim.

Prandaj, po i lexoj edhe njëherë rekomandimet.

1. Të formohet Komisioni Parlamentar ad hoc i mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 77, pika 1. Dhe, sipas Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 71, pika 2 dhe pika 4.
2. Komisioni sipas kompetencave që i siguron Kushtetuta dhe Rregullorja të analizojë të gjitha zhvillimet dhe procedurat rreth zhvillimeve të lartpërmendura,
3. Komisioni të përgatisë raportin me të gjitha të gjeturat dhe t'i dorëzojë Kuvendit në diskutim, brenda afatit 3-javor nga data e formimit të tij.

Përsëri do të kthehem në komisionet ad hoc, të cilat janë formuar në fillim të këtij mandati lidhur me përbërjen e këtij komisioni paralel me këto dy komisione tjera. Janë nga dy anëtarë nga PDK-ja dhe LDK-ja, nga një anëtar nga “Vetëvendosja”, AAK, Koalicioni për Kosovë të Re, nga një anëtar dhe nga një anëtar nga komuniteti serb dhe një jo serb. Gjithsej 9 është përbërja e këtyre komisioneve, që janë krijuar më herët dhe komisionet, të cilat plotësisht mbështeten në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Prandaj, i nderuar kryetar i Kuvendit dhe deputetë,
Kërkoj prej jush, që t'i votoni këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Unë do të përpiqem shkurt t'i sqaroj realisht se mendoj që do një sqarim.

Komisionet ad hoc i kanë detyrat e komisioneve funksionale dhe nuk mund të marrin detyra tjera. Kjo puna e këtyre që ne diskutuam sot, që duhet ta zhvillojë punën jashtë, krejt jashtë Kuvendit, nuk është detyrë e Komisionit Funksional. Realisht, kjo do të duhej të ishte formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar. Dhe, formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar i kërkon do procedura tjera. Ne e kemi edhe një ligj, po edhe me një rregullore, debati që zhvillohet për Komisionin Parlamentar, duhet të bëhet një kërkesë nga së paku 40 deputetë të Kuvendit. Ndërsa, sipas Rregullores gjithnjë, votimi i atij komisioni kërkon 2/3-at e votave. Kjo është sipas Rregullores së Kuvendit.

Dhe, tash ndodhemi para një... s'e di a e kemi krejt të qartë, Komisioni ad hoc është më i lehtë. Urdhëro, Sabri se po e lëviz kokën, nëse s'është kështu siç po e them unë me Rregullore, atëherë tregona siç është. Jo, urdhëro! Tash unë po flas me Rregullore. Rregullorja është kështu siç po them unë. Kush e di që është ndryshe, unë e pranoj atë.

(Ndërhyrje - Sabri Hamiti, nuk dëgjohet qartë)

Mirë, atëherë unë po kërkoj falje, që pata gabim. Urdhëro Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Në vend të replikës, vetëm një sqarim, se edhe u tha që nuk ka Ligj për hetimin parlamentar.

(Nga salla: Ka, ka...)

Ka pra, dhe është ligji nr. 03/L-176 i miratuar më 4 qershor 2010. Mirë, veç le të sqarohet.

E dyta, referenca në Kushtetutë, pa dashur tash të kapem për formalitete, ka paraparë mundësinë e themelimit të komisioneve ad hoc, por paragrafi 2 thotë, që për një çështje të veçantë mund të formohet komision duke përfshirë edhe çështje hetimore. Komisioni ad hoc mund të bëhet edhe për një çështje të veçantë, po për çështje siç është kjo sot në temë, e faturimit, është çështje e veçantë dhe me që edhe në tekst në diapozitiv kërkohet që të analizojë të gjitha zhvillimet dhe rreth zhvillimeve të lartpërmendura të raportojë, kjo thuaj si t'i thuash, i bie që është një komision hetimor. Nëse është komision hetimor, do të duhej edhe të trajtohet si i tillë, se ndryshe edhe s'ka si trajtohet një çështje që është më shumë se e veçantë, është një rast, një rast që ka ndodhur. Nuk është, do të thotë, fenomen, nuk është dukuri. Ka ndodhur një rast që do sqaruar, prandaj edhe do të trajtohet. Mendova, vetëm që të saktësohet. Prandaj, mendoj që interpretimi që bëri kryetari është me bazë. Faleminderit!

KRYETARI: Kërkuesi edhe njëherë ta precizojë, çfarë komisioni po kërkon?

Komisioni Hetimor është sipas ligjit që e kemi neni 4, procedurat për ngritjen e Komisionit Hetimor janë më të qarta, se të Rregullores së Kuvendit.

1. Të drejtën për të iniciuar procedurën për themelimin e komisionit e kanë 6 deputetë, një komision i përhershëm parlamentar dhe 1/3-ta e anëtarëve të Kuvendit.

Do të thotë, kjo është sipas ligjit që e kemi miratuar.

2. Propozimi për themelimin e Komisionit i dorëzohet Kryesisë së Kuvendit me shkrim dhe duhet të përmbajë çështje, të cilat do të hetohen, arsyetimin, nënshkrimin e grupit nismëtar, propozimin dhe numrin e anëtarëve të Komisionit dhe afatin kohor, brenda të cilit duhet të mbarojë mandati i Komisionit, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 6 muaj.

3. Në rastet, kur kërkesa për themelimin e Komisionit parashtrohet nga 1/3-ta e deputetëve, Kuvendi detyrimisht në seancë plenare themelon Komisionin për çështjen e kërkuar.

Do të thotë kjo është. Në rastin kur kërkesa për themelimin e Komisionit parashtrohet nga 1/3-ta, do të thotë nga 40 deputetë, se kjo është edhe në Kushtetutë shkruan kështu, bile unë kam pas tentuar që të jetë kështu, Kuvendi detyrimisht në seancë plenare themelon Komisionin për Çështje Hetimore, dhe

4. Në rastin e iniciativës nga një komision i përhershëm parlamentar ose grup deputetësh, që përbëjnë më pak se 1/3-ën e anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi mund të vendosë me shumicën e thjeshtë të votave për ngritjen e Komisionit.
5. Komisioni nuk mund të themelohet gjatë 6 muajve të fundit të një mandati të Kuvendit.

Këto janë kërkesat.

(Debat nga salla)

Unë megjithatë e lexova. Në Rregullore ishte ashtu. Unë e lexova ligjin dhe në këtë rast vlen ligji.

(Debat nga salla)

Po, po, detyrimisht 40, e lexova. Në Rregullore ishte, po ishte keq, prandaj unë e lexova ligjin. Shiko, unë e lexova në Rregullore. Nuk kanë faj këta, në Rregullore ishte 2/3-ta për vendimmarrje, po unë e lexova ligjin dhe në këtë rast ligji është më i vlefshëm se Rregullorja.

Urdhëro, Sabri!

SABRI HAMITI: Unë e kisha ndërmend mbasi të qiten të dyja, se unë e di që ekziston, ne u ndalëm në këtë diskutimin e dytë se ishim direkt të lidhur, po e kem dhe një të parë, që e patëm që na kthehet. Dhe, mendoja që do të detyrohemi të bisedojmë për të dyja. Pse? Sepse, janë dy çështje të rëndësishme, që implikojnë Kuvendin, që Kuvendi e ka vendosur t'i qesë në agjendë në të njëjtën ditë dhe kujtoja që është mençuri e Kuvendit, që t'i mbledhë të gjitha idetë rreth këtyre dy çështjeve dhe ta krijojë një "rezonancë" të përbashkët. Ajo nuk mund të krijohet aty për aty, prandaj meqë e mora fjalën po e them çka do të thosha. Kam menduar, që meqë ka pasur shumë ide, ka pasur dhe kërkesa të veçanta, që të merren vesh, të gjendet konsensusi i Kuvendit për vendimet që do t'i marrë.

Nëse s'është i zoti Kuvendi t'i marrë këto vendime në mënyrë konsensuale ose me një shumicë të madhe, le t'i jepen dy ditë deri të hënën në orën 10:00 dhe të hënën në orën 10:00 të votohen në Kuvend. Ky ishte mendimi im paraparak. Tash unë nuk e di, po unë e thashë për ta krijuar, sepse nuk është punë e mirë nëse kur bisedojmë, bisedojmë gati me

të njëjtën logjikë e mbasandaj të pjesëtohem me parti, sepse ne e dimë që veç një parti këtu nuk do ta votojë, nuk ka mundësi t'i bëjë shumicën për asnjërin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë nuk po e lëmë, po e lëmë të hënën edhe një ditë pune që grupet parlamentare të konsultohen dhe të martën në orën 10:00 i vazhdojmë dy seancat e mbetura të djeshmen dhe të sotmen.

(Ndërhyrje: Të hënën)

Jo, jo, të hënën e kemi Kryesinë. Jo, jo s'mund. Të hënën le të punohet dhe të martën në orën 10:00 e vazhdojmë seancën. A jeni dakord? Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes më 19 mars 2013

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 15 mars 2013.

Konstatoj se në sallë janë 78 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

1. Debat parlamentar për rastin “Kiçina” sipas kërkesës së deputetit Ramiz Ldrovci, i mbështetur me deputetët nënshkrues

Debati ka përfunduar, prandaj fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne e kemi dëgjuar me vëmendje debatin, i cili është zhvilluar këtu. Është diskutuar dhe debatuar gjerë e gjatë për një çështje tepër të ndjeshme. Nga diskutimet rezulton se janë konstatuar apo janë ngrehur disa dyshime për rrjedhën e procesit gjyqësor, prandaj ne propozojmë që procesverbali i këtij debati t'u dërgohet institucioneve përkatëse, nga të cilat kërkojmë që ta bëjnë vlerësimin dhe ta sjellin përfundimin e duhur rreth këtij procesi gjyqësor. Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat propozimin e propozuesit, mendoj që është zgjidhja më e mirë e mundshme, po ekziston e drejta për fjalë. Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka thënë edhe herën e kaluar dhe e përsërit sot se diskutimi i rasteve individuale të vendimmarrjes së gjykatave është në kundërshtim

me Kushtetutën dhe me ndarjen e pushteteve. Prandaj, mendoj se nuk është dashur të merremi me këtë çështje dhe nuk duhet të merremi as sot. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ne qëndrojmë prapa nënshkrimeve që i kemi dhënë për këtë debat dhe mendojmë që propozimi origjinal, që është propozuar nga deputetët që e kanë kërkuar debatin, në krye të të cilëve ka qenë zoti Ramiz Lladrovci, të hidhet në votim, për shkak se ky propozim i ri që tash na doli nuk përkon as me debatin të cilin e kemi dëgjuar, këtu të premten e kaluar, e as me kërkesën e deputetëve për debat, e dorën në zemër as me peticionin e 52 mijë qytetarëve që e kanë kërkuar këtë debat dhe që kanë pritur prej këtij debati.

Konsiderojmë që komisioni që është kërkuar të krijohet, duhet të krijohej. Në asnjë mënyrë nuk është ndërhyrje në Gjyqësor dhe shumë qartë është e shpjeguar që komisioni do t’i vlerësonte shkeljet eventuale procedurale gjatë këtij procesi dhe po ashtu shkeljen eventuale të të drejtave të njeriut, të të drejtave civile dhe politike të këtyre personave që po mbahen në burg. Dhe, konsiderojmë që komisioni dhe mënyra se si është shpjeguar, ky komision në një rekomandim që e ka propozuar propozuesi i debatit, shumë mirë e reflekton debatin që e kemi dëgjuar këtu në sallë.

Pra, procesverbali dhe transkriptet e seancës le t’u dërgohen institucioneve, nuk kemi asgjë kundër, mirëpo kërkojmë që komisioni të votohet dhe të formohet komisioni, për shkak se sipas mendimit tonë është i domosdoshëm që ta përmbyllim këtë debat dhe këtë rast. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Por, ju e dini që tjera procedura janë për komision hetimor. Është ligji dhe procedurat duhen të zhvillohen mbi bazën e ligjit. Në emër të Aleancës, Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Ne fillimisht, kur i kemi dhënë nënshkrimet, kemi menduar në krijimin e Komisionit ad hoc, por meqenëse ftuesi i debatit, në këtë rast edhe shefi i Grupit Parlamentar e ka një ide tjetër, ne do ta mbështetim, por parimisht nuk ka qenë qëllimi dhe tendenca të ndërhyjmë në drejtësi, aq më tepër kur po dëgjojmë fjalë se ka pasur raste që janë përmendur shumë më flagrante, edhe nga niveli lokal, edhe ndërkombëtar, dhe nuk ka qenë ndërhyrje në drejtësi, ndërsa në qoftë se ne i mbrojmë të drejtat e njeriut qenka ndërhyrje në drejtësi. Sidoqoftë ne do t’i japim mbështetje ftuesit të seancës për cilindo propozim që e hedh në votim.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë që e kanë kërkuar fjalën. Shkojmë me votim. E procedojmë në votim propozimin e Grupit Parlamentar dhe të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovci. Të pranishëm 78 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 39 vota për, 8 kundër dhe 8 abstenime, miratohet propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

2. Debat parlamentar lidhur me faturimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për muajin janar 2013

Sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Debatin të cilin e patëm të premtën ka qenë mjaft i gjerë, nga i cili kanë dalë mjaft konstatime edhe mjaft rekomandime.

Jemi munduar t'i përmbledhim dhe t'i përshtatim këto rekomandime të debatit të zhvilluar atë ditë.

Prandaj, po e lexoj edhe një herë arsyetimin që u plotësua dhe rekomandimet të cilat u plotësuan nga debati.

Do të thotë faturat të cilët i morën qytetarët e Kosovës për shpenzimin e energjisë elektrike për muajin janar 2013, në shumicën e rasteve ishin shumë më të larta se në muajt paraprakë dhe si të tilla iniciuan një valë të pakënaqësive dhe protestave të qytetarëve.

Debati i së premtes ka nxjerrë këto konstatime:

Që duke pasur parasysh se faturat e fryra të janarit janë të ndikuara nga rritja e paralajmëruar e çmimit të energjisë elektrike, nga vendosja e njësorëve digjitalë edhe pas privatizimit të Distribucionit, privatizimi i cili në raporte ndërkombëtare konstatohet se nuk është bërë në përputhje me praktikën më të mira, as në përputhje me ligjet ndërkombëtare, nga kapacitetet e pamjaftueshme menaxhuese të KEK-ut dhe të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, nga mungesa e kapaciteteve të reja energjetike të Kosovës, nga mungesa e linjës së interkonjeksionit 400-kilovoltësh me Shqipërinë dhe nga mosimplementimi i duhur i strategjisë energjetike 2008-2018.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së, duke u bazuar në debatin e zhvilluar dhe në përkrahje të disa grupeve parlamentare, rekomandon si vijon:

1. Të formohet Komisioni parlamentar ad hoc, i mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 77.1, dhe sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 71.1,
2. Komisioni, sipas kompetencave që i siguron Kushtetuta dhe Rregullorja, t'i analizojë të gjitha zhvillimet dhe procedurat rreth çështjeve të lartpërmendura,

3. Komisioni në afat prej një muaj të sjellë në Kuvend për diskutim raportin me rekomandimet me të gjetura,

4. Komisioni, në bazë të Rregullores, të ketë përbërjen si vijon:

Grupet parlamentare PDK dhe LDK nga dy anëtarë, grupet parlamentare “Vetëvendosje”, AAK, KKR nga një, SLS dhe “6+” nga një. Do të thotë gjithsej 9 anëtarë, ashtu si janë edhe këto dy komisione për reformën zgjedhore dhe që të udhëhiqet nga opozita.

Prandaj, i ftojme deputetët që t’i votojnë këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë, i dëgjuat rekomandimet që i dha deputetja Teuta Sahatqija për çështjen e debatit të zhvilluar më 15 mars 2013.

Për ta formuar komisionin fillimisht kërkoj që kryetar të jetë dikush nga opozita, përkatësisht nga Lidhja Demokratike, prandaj ajo duhet ta japë kryetarin dhe një anëtar.

Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën. Ju lutem, unë jam duke e drejtuar seancën!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne për udhëheqës të këtij komisioni e propozojmë zonjën Teuta Sahatqija, kurse për anëtar e propozojmë zonjën Hykmete Bajrami. Kërkojmë falje! Me kërkesën e zonjës, ne propozojmë që anëtar të jetë zoti Ali Sadriu. Faleminderit!

KRYETARI: Partia Demokratike, 1 zëvendëskryetar dhe 1 anëtar. Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Paraprakisht, zoti kryetar, ne para se ta japim propozimin për anëtar po për formimin e komisionit, është rregull që ne, seanca, përkatësisht deputetët të deklarojnë - jemi apo nuk jemi për formimin e këtij komisioni, e pastaj të procedojmë me propozimin e kandidatëve, e jo para se kjo të vendoset.

Ne e kemi dëgjuar debatin, i kemi dëgjuar arsyetimet edhe nga deputetët, edhe nga Qeveria, që rezultojnë me shpërputhje. Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka qëndrimin e vet dhe kërkojmë të ndiqen procedurat e rregullta. Prandaj, së pari kërkoj, qartë po e precizoj, kërkojmë të hidhet në votim - jemi apo nuk jemi për formimin e komisionit. Ka apo nuk ka nevojë!? Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet,

Ke të drejtë, por realisht ne na është thënë që është arritur konsensusi, por nëse nuk është arritur konsensusi, atëherë e hedhim në votim.

(Ndërhyrje nga salla)

Jo, jo, nuk ka nevojë, ju lutem!... Nuk kemi debat më! Debati ka përfunduar. Tash i votojmë rekomandimet. Deklarimi i shefave të grupeve lidhur me rekomandimin. Partia Demokratike u deklarua.? Urdhëro Adem, e ke fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne e kemi dëgjuar debatin, është ngrehur me të vërtetë një shqetësim shumë i madh, që është preokupim i të gjithë qytetarëve të Kosovës, por njëkohësisht e kemi dëgjuar edhe fjalën e Qeverisë, i kemi dëgjuar raportet e organeve përkatëse rreth kësaj çështjeje të vlerësimit që e kanë bërë, kemi dëgjuar, po ashtu pas këtyre raporteve, për masat që ka ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet ministrin, përkatësisht Qeverinë e Republikës së Kosovës, e inkurajon që të vazhdojë me marrjen e masave adekuate aty ku konstatohen shkelje.

Ne në kuadër të Parlamentit e kemi një komision, i cili mund ta luajë këtë rol dhe nuk e shohim të nevojshme që të formojmë komision shtesë, i cili do të vijë në përfundimin e njëjtë që kemi ardhur sot.

Prandaj, ne jemi kundër formimit të komisionit, për të cilin u rekomandua dhe nuk është konsultuar fare Grupi ynë Parlamentar rreth kësaj çështjeje. Dhe, unë u bëj thirrje të gjithë deputetëve të votojnë kundër formimit të këtij komisioni, sepse është i panevojshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Nga Grupi Parlamentar i PDK-së pak më parë e patëm një propozim, i cili kërkoi që seanca të votojë për një dokument publik, siç është procesverbali - transkripti, t’i dërgohet gjykatës. Dokument, i cili edhe ashtu është publik, ne votuam që t’ia dërgojmë gjykatës, që është absurd i llojit të vet. Çështja e dytë është që ministri këtu ka thënë, kur e kemi pasur debatin për faturat e rrymës, të premten, që Qeveria nuk ka kurrfarë ndikimi në çmimin e energjisë elektrike dhe na ka sugjeruar të gjithë deputetëve që të shkojmë e të flasim me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Ndërkohë, i njëjti ministër dje doli në konferencë për shtyp dhe tha që Qeveria garanton se nuk do të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike.

Pra, mendoj që është vështirë, jo vështirë por e pamundshme, që t’i marrim seriozisht këta persona, të cilët i ndryshojnë qëndrimet dhe bëjnë propozime absurde të llojit të vet.

Pra, në këtë drejtim ne konsiderojmë që një komision i tillë, i cili është propozuar, është më se i nevojshëm, për shkak se Kuvendi duhet ta bëjë një lloj shqyrtimi të këtyre çështjeve, që janë ngrehur këtu dhe që u ngrehën edhe në debat, në mënyrë që të dalë me një raport të mirinformuar, pasi të ketë biseduar me të gjitha institucionet relevante, përfshirë Qeverinë, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe të tjerët, në mënyrë që ta informojë edhe deputetin, por veçanërisht opinionin publik për atë se çfarë po ndodh dhe që t’u ndihmojë institucioneve, në mënyrë që shkeljet e mundshme, që mund të vërehen, ose që mund të konstatohen nëpërmjet këtij komisioni, të mos përsëriten në të ardhmen.

Por, është e qartë që dështimet në sektorin e energjisë janë të përditshme dhe situata në sektorin e energjisë nuk është duke u përmirësuar, por është duke u keqësuar, dhe rrjedhimisht konsiderojmë që është obligim i Kuvendit që të merret me këtë çështje.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Burim Ramadani e ka fjalën, në emër të Aleancës.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Është e qartë se edhe gjatë debatit parlamentar, Aleanca i ka mbështetur rekomandimet që kanë dalë si pjesë e tij. Dhe, besojmë se një komision i tillë është i nevojshëm, respektivisht është i domosdoshëm, kryesisht për dy arsye më të mëdha.

E para, që njerëzit në Kosovë janë në hall me këto fatura që kanë ardhur të energjisë elektrike, dhe e dyta, ç'është e vërteta, se Qeveria po mundohet ta fshehë ndikimin e vet. Është tepër e qartë kush është kompetent e kush jo, por besoj që krejt jetojmë këtu dhe fare qartë e dimë se cili është ndikimi i Qeverisë. Prandaj, në këtë situatë, Kuvendi nuk duhet të heshtë. Kuvendi duhet ta ndërtojë këtë komision dhe ta vazhdojë punën e vet. Do të thotë, votojmë pro këtij rekomandimi për ndërtimin e këtij komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se debatin, të cilin e ngriti Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahëm atë ditë në seancën plenare, thuajse të gjitha subjektet politike, mirëpo arsyetimi i cili ka dalë nga debati që është zhvilluar atë ditë, mund të lexojmë pikë e për pe: “Duke pasur parasysh se faturat e fryra të janarit janë ndikuar nga rritja e paralajmërimit të çmimit të energjisë elektrike, vendosja e njehsorëve digjitalë edhe pas privatizimit të Distribucionit, që janë komplet çështje e Zyrës së Rregullatorit, privatizimi i cili në raport me ndërkombëtarët konstatohet se nuk është bërë në përputhje me praktikën më të mira, as në përputhje me ligjet ndërkombëtare”, është çështje e cila duhet t’i drejtohet ministrit të Zhvillimit Ekonomik.

“Kapacitetet e pamjaftueshme menaxhuese në KEK dhe më gjerë, në mungesën e kapaciteteve të reja energjetike”, - këto janë politikat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, me të cilën mund t’i drejtohem.

“Mungesa e linjës së interkonjeksionit 400-kilovoltësh me Shqipërinë”, - edhe kjo është kompetence e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

“Implementimi i strategjisë së energjisë 2008-2018”, - jam në pajtim që debati ka pasur frymë shumë të mirë atë ditë gjatë diskutimit, mirëpo rekomandimet e një Komisioni ad hoc nuk çojnë askund, se ne jemi Kuvendi i Kosovës. Dhe, dëshiroj të theksoj që Grupi Parlamentar për Kosovë të Re jep këto rekomandime:

- Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik të kërkojë raport nga Zyra e Rregullatorit, agjencia e cila i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe është e pavarur.

- Të kërkohet një raport nga njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike, në bazë të Ligjit të ndërmarrjeve publike, dhe njëkohësisht
- Ministri, së bashku me këta dy përfaqësues në komision parlamentar, të raportojë për parregullsitë, që i janë bërë qytetarëve gjatë janarit 2013, 2012 dhe 2011.

Kjo është çështja në bazë të ligjeve, të cilat i diskuton Kuvendi i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: SLS, nuk ka të lajmëruar. Grupi “6+”, jo. Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotëri kryetar!

Propozimet, përkatësisht rekomandimet u dhanë. Sigurisht, që në fund do të votohet për to.

Ajo që unë po e them, në emër të LDK-së, është se ne nuk kemi dëshiruar të shkohet, sepse dikush e ka frikë këtë punën e komisionit hetimor, edhe pse janë shumë të paarsyeshme arsyetimet që po thuhën këtu, sepse të njëjtit deputetë, ose shumica prej atyre që janë në atë komisionin që e kemi përkatës, do të jenë edhe anëtarë të këtij komisioni dhe do ta kenë vetëm këtë punë, e nuk do të kenë edhe punë të tjera shtesë. Është shqetësim i qytetarëve dhe unë dëshiroj të besoj se të gjithë këtu pajtohem se është shqetësim i qytetarëve dhe institucioni më i lartë i vendit ligjdhënës - Kuvendi është kompetent të merret me këtë punë dhe të veprojmë në mënyrë institucionale. Por, është çështje e përcaktimeve të grupeve parlamentare. Ajo që po e them është - nëse kjo nuk kalon, unë paralajmëroj që ne do ta shfrytëzojmë të drejtën tonë që me 40 nënshkrime të formojmë komision hetimor.

Kjo është një e drejtë jona që na lejohet dhe këtë do ta bëjmë. Prandaj, janë rekomandimet, i votojnë grupet që janë përcaktuar t'i votojnë, apo deputetët, e nëse s'kalon, ne si Grup Parlamentar, me të gjithë ata që i ndajnë shqetësimet me ne, do të formojmë, me nënshkrime, ashtu siç është procedura, komision hetimor. Atë nuk do të ketë mundësi, sigurisht, të na ndalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju kisha lutur që ata që e kanë marrë fjalën një herë, të mos e kërkojnë më. Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Më herët e shtypa botonin për ta propozuar kandidatin, por si do që të jetë pajtohem me kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së që ky komision nuk duhet ta frikojë askënd, përpos ata cilët kanë abuzuar me ligjin dhe me fryrjen e faturave.

KRYETARI: Kryetari i Grupit të Partisë Demokratike, por shkurt, Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Shumë shkurt! Grupi Parlamentar nuk e shantazhon askënd, e respekton shprehjen e lirë apo votën e lirë të çdo deputeti të Kuvendit të Kosovës. Në mënyrë absolute, asnjëherë nuk jemi frikësuar dhe nuk i frikësohemi asnjë komisioni, por ne e vlerësojmë të tepërt të

formohen komisione mbi komisione dhe kur njeriu nuk do të zgjidhë probleme, ta konstatojë shkallën e fajësisë, atëherë formon komisione, të cilat do ta humbin kohën kot.

Ne i kemi raportet edhe të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, e cila është organ kompetent për ta vlerësuar dhe për ta konstatuar situatën. E kemi raportin e Avokatit të Popullit, për ata që s'ë kanë parë se e ka dhënë një raport, një vlerësim. E kemi po ashtu kërkesën e deputetëve të Parlamentit të Kosovës për të kontaktuar me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe asgjë më tepër nuk do të bënte edhe ky komision.

Prandaj, ne jemi për rrugën më të shkurtër për të ardhur deri te konstatimi i së vërtetës dhe kurrësi nuk lejojmë të manipulojmë me pakënaqësinë e qytetarëve dhe të bëjmë përpjekje të fitojmë poenë politike në emër të asaj pakënaqësie, apo fatkeqësisë së qytetarit tonë.

Ne jemi për zgjidhjen e problemeve, të cilat i preokupojnë qytetarët tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Këtu nuk duhet pasur ndonjë mençuri të madhe që ai aludoi në diskutimin tim. Nëse LDK-ja si Grup Parlamentar ka qëndrim korrekt, e kjo është më se e qartë, dhe jemi ne që më së paku dimë të shantazhojmë dhe bëjmë shantazhe. Ne nuk po shantazhojmë, por po e themi një të drejtë tonën elementare që na e garanton Rregullorja e Kuvendit, e nuk dëshirojmë të manipulojmë me qytetarët. Kjo është një e pavërtetë, sepse qytetarët kanë dalë në rrugë, e kanë shprehur pakënaqësinë, kanë kërkuar nga ky Kuvend, nga ne, nga secili prej nesh, që të bisedojmë dhe të kërkojmë rrugëzgjdhje dhe këtë rrugëzgjdhje mund ta kërkojë ai komision që do të formohet.

Prandaj, këtu janë dy mundësi, hedhet në votim, e nëse nuk votohet është rruga tjetër që ne kemi këtë të drejtë dhe do ta shfrytëzojmë sigurisht. Faleminderit!

KRYETARI: Për këtë çështje mendoj se është mbyllur debati. Unë vetëm e kam një vërejtje në rekomandime. Është dashur të jenë edhe dy çështje, ndërprerja e kategorizimit A,B,C dhe thjeshtëzimi i tarifave. Këto dy gjëra është dashur të dalin si rekomandime, sepse vërtet janë shkelje e të drejtave dhe lirive të qytetarit dhe të konsumatorëve. Fjalën e ka ministri, zoti Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Është më se e vërtetë se Parlamenti ka të drejtë të formojë komisione ad hoc, aso komisionesh ka, por duhet të ju them se tendenca e zgjatjes së kësaj çështjeje është më shumë politike se sa funksionale.

Unë desha të ndërlidhem me rekomandimet, sepse në rekomandime ka konstatime dhe e ftoj Parlamentin që të mos vihet në lajthitje me dokumente të shkruara, sepse kjo ka pastaj konotacione të tendencës për lajthitje të së vërtetës.

Nën një, asnjë dokument deri më tani nuk flet për rritje të paralajmëruar dhe mendoj që në hipotezë, një Parlament të thotë për rritje të paralajmëruar të formohet komision, është diçka e jashtëzakonshme. Pra, po flasim për komision, i cili do të merret me hipoteza.

Nën sy, flet për privatizimin, i cili në raporte ndërkombëtare konstatohet se nuk është bërë në përputhje me praktikën më të mira dhe me ligjet e Kosovës, unë kisha dashur të më jepet shpjegim kush i ka thënë këto dhe cilat janë këto praktika. Unë po ju njoftoj që rekomandimet dhe ato gjërat të cilat kanë dalë në shtyp, janë të pavërteta dhe ju si deputetë mund t'i dini.

... që ka qenë pjesë, këshilltar i transaksionit, e konfirmon që ai promovim i cili është bërë nëpër mediet tona është jo i saktë dhe çdo procedurë është bërë në bazë me ligjin, por po ju them do të ishte keq që Parlamenti të vijë në këso konstatimesh, të cilat nuk kanë qëndrueshmëri.

Kur flasim për mungesën e linjës së interkonjeksionit, këtë mund ta bëni edhe për dy vjetet e ardhshme, sa herë doni ta vini në debat në Parlament për shkak se procedurat janë në vijim e sipër, e ajo është në proces e sipër, e kjo i merr ndoshta një dy vjet për t'u ndërtuar, prandaj mungesa ka me qenë edhe për dy vjet të tjera dhe mendoj që është gabim trashanik i profesionalizmit të diskutohet një çështje e tillë. Dhe, të nderuar deputetë, unë kam raportuar në baza të rregullta para Komisionit për Zhvillim Ekonomik për implementimin e strategjisë.

Sido që të jetë, po ju them që nuk është mirë të vihem në lajthitje, por sa për përgjegjësitë, sa për obligimet të cilat i ka Ministria, sa për shkeljet të cilat janë bërë nga ministria, mendoj që nuk është mirë të përjashtohet as ad hoc-u, as komisionet tjera, por është një tendencë e përdorimit politik të Parlamentit, e cila do të tenton ta mbajë gjendjen në situatë më tendencioze.

Prandaj, në këtë kontekst, gatishmëria jonë është e plotë. Ju vazhdoni sipas orientimeve tua që i keni. Por, po e them edhe një herë, nuk duhet të bëhet konstatim, sepse nuk është i saktë, nuk është i vërtetë, që nuk është bërë në harmoni me praktikën, me standardet dhe me ligjet e Kosovës.

Ky është konstatim goxha i rëndë, prandaj deputeti duhet të ketë kujdes për një proces të tillë.

KRYETARI: Deputetët janë të lirë ta thonë mendimin e tyre, prandaj mos u shqetësoni nga mendimet e lira. Fjalën e ka propozuesja, Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Patëm mundësi t'i dëgjojmë disa ligjërata, të cilat aspak nuk janë kompetencë e ministrit. Ministri nuk ka të drejtë të na tregojë duhet apo nuk duhet të formohet ndonjë komision, prandaj atë mund të mbajnë në bisedat atje në 'holl', e jo këtu. Kjo nuk është kompetencë juaja.

Tjetra? Konstatimet çfarë janë, çfarë nuk janë - ato konstatime do të dalin në qoftë se formohet komisioni dhe ju thërrasim juve, ju thërrasim prapë, sa herë të doni ju thërrasin dhe e keni obligim të përgjigjeni, dhe të na treguar krejt çfarë kërkojmë prej jush.

Prandaj, nuk ka pasur nevojë të vini këtu e të na mbani ligjërata për detyrat tona. Detyrat tona, ne i dimë. Nuk jeni ju përgjegjës për detyrat tona.

I ftojme deputetët që t'i votojnë rekomandimet.

KRYETARI: Po i hedhim në votim rekomandimet, edhe pse unë kisha vërejtje për t'i shtuar edhe dy rekomandime. Të pranishëm i kemi 81 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Ndërhyrje)

Po, rekomandimet! 35 me 35...

(Ndërprerje e incizimit)

Kërkoj nga regjia ta sjellë rezultatin e votimit me shkrim. E shikojmë një herë me kartela, pastaj pa kartela.

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar deputetë,
Dua ta them dhe ta saktësoj një gjë. Ne nuk është hera e parë që votuam tash me elektronikë dhe votuam edhe çështje tjera, dhe askush nuk tha që s'kemi kartela.

(Ndërhyrje)

Jo, për më herët e kam fjalën. Herën tjetër, nëse s'keni kartela, lajmërohuni përpara.

(Ndërprerje e incizimit)

Jo, por është dashur të lajmërohesh më herët.

(Ndërhyrje)

E ke ngritur dorën me vonesë! Jo, jo, nuk po lexojmë. Ju e dini, rezultati baras do të thotë nuk kalon. 35 me 35, me elektronikë e kemi.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*